

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

BESIMI PUBLIK - SFIDË PËR POLICINË

5

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

BESIMI PUBLIK SFIDË PËR POLICINË

5

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2007

Mbështetur nga National Endowment for Democracy,
NED Washington DC”



Botues: Fatmir Toçi

Përgatiti: Altin Kaso

Korrektore letrare: Dorina Talo

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Lavdie Cenmurati

ISBN 978 99943 - 1 - 218 - 4

© IDN

BOTIMET TOENA

Rr. "Muhamet Gjollesha", K.Postare 1420, Tiranë

Tel.: (4) 240116; 258893

Tel./Fax: (4) 240117

E-mail: toena@toena.com.al; info@toena.com.al;
toena@icc.al.eu.org

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

PËRMBAJTJA

Hyrje	7
Konferenca V Kombëtare: “ <i>Besimi Publik - Sfidë për Policinë</i> ”	11
Fjala e z. Sotiraq Hroni - Drejtëor ekzekutiv i IDN-së	14
Fjala e z. Gjergj Lezhja - Zëvendësministër i Brendshëm	17
Fjala e z. Bajram Ibraj - Drejtëor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit	23
Fjala e z. Ruzhdi Keçi - Prefekt i Qarkut Tiranë: <i>Përvoja e Qarkut Tirana</i>	
<i>Tiranë në krijimin e Bordeve të Parandalimit të Krimtit</i>	26
Fjala e z. Bardh Rica - Kryetar i Këshillit të Qarkut Lezhë : <i>Strategjia vendore e Parandalimit të Krimtit</i>	30
Fjala e z. Ahmet Prençi - Drejtëor i Policisë, Qarku Shkodër: <i>Rreth bashkëpunimit me komunitetin në parandalimin e veprave penale dhe forcimin e sigurisë në Qarkun e Shkodrës</i>	39
Fjala e Prof. dr. Gjergj Sinani: <i>Policia në sfidën e besimit dhe të sigurisë</i>	45
Fjala e Prof. asoc. dr. Erlehta MATO- <i>Drejtoreshë në Institutin e Kurrikulës dhe Standardeve: Edukimi për policinë në shkollën tonë ..</i>	50
Fjala e z. Artur Zoto - <i>Ekspert: Parandalimi i Krimtit nis në Institucionet Arsimore</i>	57
Fjala e z. Hasan Shkëmbi: <i>Policimi në komunitet: Arritje dhe Sfida</i>	62

Rezultatet e pyetësorit: “Perceptimi i komunitetit mbi disa shërbime të Policisë së Shtetit”. Analizë dhe komente nga kryekomisar Albert Dervishi.	81
Seminari Kombëtar: <i>Parandalimi i Krimtit – Sfidë e Shoqërisë</i>	85
Fjala e z. Sotiraq Hroni	87
Fjala e z. Gjergj Lezhja	90
Fjala e z. Bajram Ibraj	93
Joseph Hauer: <i>Statistikat e Krimtit në Shqipëri, Strategji për Menaxhimin e Burimeve dhe zhvillimin e Strategjive Parandaluese</i>	104
Fjala e z. Nasip Naço – <i>Prokuror i rrëthit Durrës: Prokuroria dhe detyrimi ligjor për parandalimin e krimtit</i>	107
Prof. dr. Elfrida ZEFI - <i>Prefekte e Qarkut Korçë: Parandalimi i Krimtit - Plani i Punës për tremujorin prill – qershor 2006</i>	110
Takimet e Komiteteve Vendore për Parandalimin e Krimtit të organizuara nga IDN-ja në bashkëpunim me prefektët e qarqeve	117
Ecuria e punës për përgatitjen dhe miratimin e projektligjit: “Për krijimin e Komiteteve për Parandalimin e Krimtit”	126
Bordet e Parandalimit të Krimtit	128
Llogaridhënia Publike e Policisë së Shtetit	132
Takime të llogaridhënieς publike të organizuara nga drejtues të strukturave vendore të Policisë së Shtetit.....	135
Llogaridhënia e Policisë së Shtetit	139
Bordet e Avokatisë Qytetare ndaj Policisë	144

Hyrje

Botimi i pestë “Besimi Publik - Sfidë për Policinë” vjen pas Konferencës Kombëtare me të njëjtin titull që synonte përbledhjen e aktivitetit njëvjeçar të realizuar në bashkëpunim me Policinë e Shtetit në nivel kombëtar e njëkohësisht me shumë institucione të tjera në nivel vendor. Çështjet kryesore të kësaj sipërmarrjeje përcillen edhe nëpërmjet botimit, por, si drejtues i këtij programi, në këtë prezantim do të desha të ndalesha në disa nga çështjet më kryesore të aktivitetit dhe të objektivave e koncepteve bazë të tij.

Së pari, realizimi i nismës për krijimin e Komiteteve të Parandalimit të Krimit në nivel vendor në koordinimin e prefektëve ishte, do të thosha, spektakolare. E pikërisht, funksionimi i tyre nuk ishte rrjedhojë e një urdhri të ardhur nga lart, por një mekanizëm i gjetur dhe funksional, sepse të gjithë aktorët e pranishëm në këto komitete vendore e gjeten veten dhe vlerësuan maksimalisht nismën. Kështu, kryetarët e njësive vendore (bashki, komuna) në të gjithë vendin, sikundër edhe përfaqësues të institucioneve të tjera vendore, si: të arsimit, mbështetjes sociale, agjencitë e zhvillimit vendor, biznesi, OJF-të e vlerësuan dhe kërkuan institucionalizimin e nismës. Është për t'u theksuar se nisma pati mbështetjen e plotë të institucioneve të zbatimit të ligjit dhe drejtësisë. Policia vendore, prokuroria, por edhe gjykatat e nivelit të parë e panë

veten integralisht të përfshirë në këto komitete vendore, të cilat njëherazi krahas punës edukuese, parandaluese apo bashkërenduese me institucionet e tjera vendore, vlerësuan se këto nisma mund t'u shërbejnë edhe vetë institucioneve në kuadër të imazhit të tyre publik. Krahas policisë, kam parasysh prokuroritë vendore në të gjithë vendin, e në ndonjë rast edhe gjykatat.

Seminari kombëtar në fakt arriti të përbledhi përvojën dhe të inkurajojë kërret e Ministrisë së Brendshme e Policisë pér të premtuar rinasjen e procedurave të miratimit të Projektligjit. Kjo nismë në fakt në njëfarë mënyre u mbivendos me një nismë të komiteteve të parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në kuadër të një komiteti ndërministror, që koordinohet nga zëvendësministrja e Brendshme. Për mendimin tim, kjo nismë është sa e përkohshme, sa e imponuar nga faktorë të jashtëm (për rrjedhojë deri diku formale), aq edhe e përfshirë si një nga komponentët e nismës së IDN-së pér Komitetet Vendore të Parandalimit të Krimtit. Pra, Shqipëria nuk mund të ketë luksin e të paturit nga një komitetet krimi pér çdo figurë krimi. Nuk mund tē ketë një komitet pér drogën, një pér kanabis sativa, një pér dhunën në familje, një pér gjakmarrien, një pér dhunën ndaj fëmijëve, një pér dhunën ndaj grave, një pér vetëvrasjet e të tjera e të tjera. Për më tepër, shifrat tregojnë se dukuria e trafikimit të qenieve njerëzore nuk shtrihet në të gjithë vendin me të njëtin intensitet, dhe aq me tepër që nuk ka një studim mirëfilli pér të mësuar shkaqet e kësaj dukurie. Vendi, institucionet dhe shoqëria duhet tē investohet te parandalimi i krimtit në përgjithësi me dinamikën dhe prioritetet që ka çdo zonë duke eleminuar gradualisht burimet e dukurive kriminale.

Komititetet vendore të parandalimit të krimtit, nën përgjegjësinë dhe koordinimin e prefektit, do tē ishin shumë

më dinamike dhe të justifikuara nëse ato do të vepronin në kuadër të një strategjje kombëtare për parandalimin e krimit që do të realizohej nga Komiteti Kombëtar i kryesuar nga kryeministri. Kjo do të vendoste drejt një stabiliteti institucional dhe shoqëror vetë institucionet e gjithë shoqërinë për t'u investuar e gjitha për kufizimin dhe eleminimin e dukurive kriminale.

Krijimi dhe funksionimi në inkurajimin dhe monitorimin e Prefektit të Bordeve të Parandalimit të Krimit në bazë komisariati në kryeqytet me një popullsi që po arrin 1 milion banorë mendoj se është për të gjithë institucionalizimi i diçkaje që mungon, i një strukture që duhet, për të mos thënë që është i domosdoshëm. Përfytyroni ç'do të thoshte për qytetarët e Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë si dhe për vetë institucionet që në mbledhjen vjetore të analizës apo ndërtimit të strategjisë së Qarkut Tiranë të Komitetit Vendor të Parandalimit të Krimit të asistonin edhe vetë autoritetet e larta të vendit, pse jo edhe kryeministri, jo për “show”, por të investuar institucionet te parandalimi si investimi më dobiprurës, me kosto më të ulët dhe impaktin më të madh.

Pikërisht, në këtë hyrje dëshiroj të evidentoj edhe mbledhjen e këtij Komiteti në Qarkun e Lezhës. Në fakt, kur mbledhja filloj e u duk pak si formale, me citate, vlerësimë, e premtive. Ndoshta edhe për t'u mbyllur shpejt, për arsy se vapa e shtatorit po i shtrydhët djersën të pranishmëve. U desh pak ngacmim për të prekur problemet dhe debati nuk mund të mbollej. U kapën të gjitha problemet apo dukuritë që kishin çuar dhe çonin në krim, që nga çështjet e pronësisë e të tokave deri tek integrimi i familjeve të ardhurave rishtazi në atë qark, që nga përgjegjësia e shkollës, te zyrat e përmbarimit e deri te zyra e regjistrimit të pronave. Pikërisht në mes të këtij debati, kryetari i Qarkut të Lezhës, zoti Bardh Rica, premtoi hartimin

për herë të parë për Qarkun e Lezhës (por edhe për të gjithë qarqet e vendit) të Strategjisë për Parandalimin e Krimit për Qarkun e Lezhës. Dhe kjo tashmë është botuar në libër si një model për t'u konsultuar nga të interesuarit në rang vendi. Tashmë, përderisa institucionet nuk po e vendosin në agjendë këtë nismë të gjithëpranuar me vullnet të plotë të aktorëve, i mbetet qytetarëve për të plotësuar të drejtën kushtetuese për nisma ligjore.

Së dyti, do të desha të përmendja një nga arritjet e realizuara gjatë këtij projekti: është bashkëpunimi dhe shfrytëzimi i rezultateve të anketimit për të vlerësuar dhe orientuar punën e policisë mbështetur mbi kënaqësinë dhe vlerësimet e publikut. Kjo nismë e shoqëruar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Drejtues Bajram Ibraj për realizimin e një anketimi të tillë nga vetë policië vendore në çdo fund viti do të ndikojë pozitivisht në ndryshimin e mentalitetit të policimit, duke u orientuar gjithmonë e më tepër nga nevojat e publikut dhe shqetësimet e tij.

Lidhur me këtë tematikë, IDN-ja apo ka nisur iniciimin e një praktike të re për vendin tonë atë të Bordeve të Avokatisë Qytetare ndaj Policisë.

Së fundi, do të desha të falënderoja drejtuesit e Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vendosur në realizimin e këtij projekti, të gjithë prefektët e qarqeve për mbështetjen e dhënë, si dhe bashkëpunëtorët e tjerë.

IDN

Konferenca V Kombëtare “Besimi Publik - Sfidë për Policinë”

Kjo konferencë erdhi si aktivitet i përvitshëm i Institutit të Demokracisë Ndërmjetësim në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me qëllim prezantimin e eksperiencave të krijuara gjatë një viti në kuadër të nxitjes dhe zbatimit të reformave të shërbimeve policore. Si çdo vit në këtë aktivitet morën pjesë drejtues të lartë të Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit si z. Gjergj Lezhja, zëvendësministër i Brendshëm, Bajram Ibraj, drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, prefektë dhe kryetarë qarqesh, drejtues të arsimit dhe drejtues të strukturave vendore të policisë në të gjitha qarqet e vendit, përfaqësues të medias, shoqërisë civile, etj.

Për herë të parë në plan kombëtar u prezantua nisma e Këshillit të Qarkut Lezhë për hartimin e *Strategjisë vendore për parandalimin e krimit* e hartuar me bashkëpunimin e institucioneve në nivel vendor të këtij qarku dhe paraqitur nga kryetar zoti Bardh Rica.

Një përvojë e veçantë e prezantuar në këtë aktivitet ishte edhe nisma e drejtuesve të komisariateve të Tiranës, të cilët me nxitjen dhe mbështetjen e prefektit të qarkut zotit Ruzhdi Keçi kanë iniciuar institucionalizimin e organizimit të takimeve të *Bordeve për parandalimin e krimit*. Këto borde janë konceptuar të funksionojnë në bazë komisariati si struktura

konsultative të shefave të komisariateve me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të pushtetit vendor, arsimit, shoqërisë civile, biznesit, grupeve të ndryshme të interesit, etj.

Një nga synimet dhe drejtimet kryesore të punës të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim gjatë vitit 2006 ka qenë nxitja e institucionalizimit të punës parandaluese si filozofi bashkërenduese e institucioneve në nivel qendror dhe vendor. Në aktivitet u vlerësua mbështetja absolute e të gjithë prefektëve, kryetarëve të bashkive dhe njësive të tjera të qeverisjes vendore, drejtuesve të arsimit, prokurorive vendore, institucioneve të tjera të zbatimit të ligjit në nivel vendor përfshire Policinë e Shtetit, me fjalë të tjera të gjithë grupit të interesit në nivel vendor për *praktikën e funksionimit dhe domosdoshmërisë së institucionalizimit të nismës për Komitetet e Parandalimit të Krimtit* në nivel kombëtar dhe vendor. Investimi shoqëror drejt parandalimit si një sipërmarrje për të eleminuar shkaqet e dukurive kriminale mbetet në themel të stabilizimit të shoqërisë duke eleminuar gradualisht shkaqet që mund të jenë me natyrë ekonomike, arsimore, sociale të së shkuarës dhe të tranzicionit.

Në seancë të veçantë u diskutua edhe një nga temat mjaft të rëndësishme siç është ajo e bashkëpunimit polici-institucionale arsimore. Ky bashkëpunim duhet konceptuar jo më thjesht dhe vetëm në kuadër të sigurisë fizike nëpër shkolla, por gjithmonë e më tepër si një bashkëpunim konkret për edukimin e brezit të ri si dhe parandalimin e krimtit. Pjesëmarrja e punonjësit të policisë në procesin arsimor është një pikë që sipas një anketimi të bërë nga IDN-ja, mbështetet nga *mbi 80% e qytetarëve të anketuar në të gjithë vendin*.

Përvoja e Shkodrës në policimin në komunitet dhe sfidat e saj për të ardhmen ishin çështjet e diskutuara nga drejtori i Policisë së Qarkut Ahmet Prençi. Shifrat pozitive të anketimit të realizuar nga IDN-ja në të gjithë *vendin e bëjnë Shkodrën një*

nga qytetet ku policimi në komunitet po jep frytet e veta. Ndërsa, drejtori i analizës në Ministrinë e Brendshme, Albert Dervishi bëri një paraqitje dhe analizë të plotë të pyetësorit, duke evidentuar edhe detyrat për problemet e evidentuara nga qytetarët.

Përmirësimi i imazhit publik dhe rritja e besimit te policia është një proces i vazhdueshëm që përveç përpjekjeve të policisë për të rritur efektivitetin e punës së vet, kërkon bashkëpunimin dhe koordinimin e të gjitha institucioneve si dhe të komunitetit. Për këtë qëllim pjesë e diskutimeve në këtë konferencë ishin edhe çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e policisë me pushtetin vendor, arsimin, median dhe komunitetin.

Sotiraq Hroni Drejtëor ekzekutiv i IDN-së

Jo sepse kështu është e udhës në hyrje të çdo konference, por më lejoni të shpreh falënderimet e mia të sinqerta për Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, prefektëve të qarqeve dhe shumë aktorëve të tjerë publikë dhe jo publikë për bashkëpunimin që kemi vendosur edhe gjatë këtij viti.

Në fakt, unë nuk jam duke bërë analizën vjetore të IDN-së, aq më pak të institucioneve të tjera. Por, do të ndihesha mirë të evidentoja disa momente të rëndësishme të këtij bashkëpunimi dhe partneriteti të ndërsjelltë. Në këtë kuadër do të veçoja mbështetjen e plotë dhe të vetëdijshme të të gjithë prefektëve, kryetarëve të bashkive dhe njësive të tjera të qeverisjes vendore, drejtuesve të arsimit, prokurorive vendore, institucioneve të tjera të zbatimit të ligjit në nivel vendor, përfshirë policinë e shtetit, me fjalë të tjera të gjithë grupit të interesit në nivel vendor për praktikën e funksionimit dhe domosdoshmërisë së institucionalizimit të nismës për Komitetet e Parandalimit të Krimtit në nivel kombëtar dhe vendor. Në këtë kuadër dëshiroj të vë në dukje edhe një herë se në hapësirën e vendeve që synojmë të integrohem, evropiane dhe transatlantike, në çdo vend apo shtet të veçantë të tij ekzistojnë struktura të tilla kombëtare, si institucione publike, mjaft të klikojmë në internet “Crime Prevention Associations”.

Prandaj, siç u vlerësua edhe në seminarin kombëtar të 30 qershorit të këtij viti nga të dyja nivelet e qeverisjes, atë vendore, por edhe nga drejtuesit e shumë ministritëve u mbështet ideja për një nismë ligjore në këtë drejtim.

Investimi shoqërор drejt parandalimit si një sipërmarrje për të eleminuar shkaqet e dukurive kriminale mbetet në themel të stabilizimit të shoqërisë duke eleminuar gradualisht shkaqet që mund të jenë me natyrë ekonomike, arsimore, sociale, të së shkuarës dhe të tranzicionit.

Së dyti, do të çmoja bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme edhe në bashkërendimin për të orientuar punën mbështetur në kënaqësinë dhe vlerësimin nga qytetarët për shërbimet publike që ofron policia. Anketimi i qytetarëve për cilësinë e performancës së këtyre shërbimeve e zhvilluar këtë vit dhe që do të diskutohet edhe sot, do të pasohet për vit si komponent i rëndësishëm për influencimin e politikave publike për përmirësime të vazhdueshme në këtë drejtim. Kjo do të jetë edhe si mbështetje apo monitorim i Strategjisë së Policimit në Komunitet, po ashtu edhe i efektivitetit të Strategjisë 10-vjeçare të Policisë së Shtetit që pritet të miratojë së shpejti ekzekutivi shqiptar.

Policimi në komunitet falë edhe kontributeve të aktorëve të tjera si PAMECA, ICITAP, UNDP e të tjera, po bëhet gradualisht një praktikë pune që po zë vend jo vetëm në mendësinë, por edhe në praktikën e policimit.

Konferenca e pestë kombëtare me të njëjtin titull “Besimi Publik - Sfidë për Policinë” tashmë besoj se po bind të gjithë se me gjithë arritjet, besueshmëria publike është një proces pa fund dhe jo vetëm për policinë. Është një proces i tillë që me një goditje, me një gabim, mund të shkatërrohet lehtë puna e një apo disa vjetëve, e ndërtuar me mund dhe djersë dhe me kosto financiare.

Zgjedhjet e ardhshme vendore besoj do të jenë një tjeterë gur i rëndësishëm në praktikën pozitive të viteve të fundit të këtij institucioni.

Së fundi, më lejoni të shpreh vlerësimin tim për lidershipin e zotit Olldashi në përgjithësi të punëve, por në mënyrë të veçantë për një praktikë të re pune. Kohët e fundit me urdhër të tij u ngrit edhe Grupi Këshillimor i shoqërisë civile për të asistuar në përpilimin dhe përditësimin e Strategjisë 10-vjeçare të Policisë së Shtetit.

Mendoj se kjo nismë mbetet një praktikë e mirë (best practice) në atë që zhvillimin e institucioneve të vendit e shikon duke vlerësuar kapacitetet vendore jashtëinstitucionale, duke ndikuar njëkohësisht në përthithjen efektive të përvojës dhe asistencës ndërkombëtare. Bile kjo është një çështje që duhet parë edhe më gjerë, është një çështje që kap të gjithë shoqërinë shqiptare në kuadër të fuqizimit të pronësisë vendore (local ownership) të reformave. Ndiarma e ndërkombëtareve mund të bëhet edhe më efektive mbështetur në përpunimin që i bëjnë kapacitetet kombëtare, së pari të vetë institucioneve, por edhe ato jo publike të shoqërisë civile. Kjo është demokracia, kjo është në agjendën edhe të NATO-s edhe të Bashkimit Evropian dhe të gjithë institucioneve ndërkombëtare që asistojnë Shqipërinë, dhe të gjithë vendet e rajonit.

Gjergj LEZHJA

Zëvendësministër i Brendshëm

Që në fillim, dëshiroj të shpreh kënaqësinë për zhvillimin e Konferencës V Kombëtare “Besimi Publik - Sfidë për Policinë”, organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, në bashkëpunim me Drejtoren e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe të falënderoj organizatorët për iniciativën e ndërmarrë.

Theksoj se kjo konferencë, nuk është një aktivitet i radhës, por përqendrim i vëmendjes në aktivitetet e Policisë së Shtetit, me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe forcimin e vizioneve tona bashkëkohore. Ajo, synon të identifikojë perceptimin e komunitetit, mbi disa shërbime që i ofrojnë strukturat e policisë dhe mbi këtë bazë, ndërtimin e prioriteteve dhe praktikave më të mira të punës së saj.

Policia e Shtetit, si pjesë e administratës publike, gjithmonë e më tepër po përpinqet të zërë vendin e saj në një shoqëri të hapur e demokratike. Roli i saj në shoqërinë shqiptare, e cila ende karakterizohet nga probleme të shumta, mbetet i rëndësishëm, prandaj, për të përmbrushur misionin dhe detyrat institucionale të saj, ajo përpinqet të zhvillohet me të njëjtat ritme të zhvillimit të shoqërisë, duke u vënë në shërbim të saj dhe të ligjit. Vetëm kështu, ajo bëhet faktor për integrimin e shoqërisë dhe institucion që mbështet progresin e saj.

Mbrojtja e rendit dhe garantimi i sigurisë publike, është misioni parësor i policisë. Por a do të mundej ajo vallë, që e vetme të kryente këtë mision të vështirë, kur aktorët dhe faktorët që ndikojnë në parametrat e rendit e sigurisë publike janë të shumtë?

Zhvillimet e shpejta të jetës dhe kërkesat gjithnjë në rritje të shoqërisë, kanë sjellë filozofi të reja në botën moderne për sa i përket koncepteve të rendit e sigurisë publike si dhe rrugëve për standardizimin e tyre. Besoj se jemi të një mendjeje, se siguria nuk është më atribut vetëm i njeriut të sigurisë, apo e thënë më thjesht, e punonjësit të policisë. Sfidat e jetës dhe të zhvillimit shoqëror, kërkojnë angazhimin e të gjithë strukturave të shoqërisë e të shtetit për të arritur standarde të larta edhe në këtë fushë. Jo vetëm angazhimi i drejtpërdrejtë i shoqërisë në fushën e sigurisë, por edhe gjithë veprimtaria tjetër e saj ndikon në këto arritje, sepse të gjithë ne jemi njëherësh prodhues dhe konsumatorë të rendit e të sigurisë publike. Në referim të kësaj, çdokush nga ne e kuption që rritje e mirëqenies, do të thotë në radhë të parë dhe arritje, në fushën e rendit e të sigurisë publike.

Nisur nga sa më sipër, ne kemi vlerësuar se filozofia e policimit komunitar, përbën një ndër risitë e mendësive dhe praktikave që Policia e Shtetit, në kuadër të reformimit të saj, po përpinqet të adaptojë dhe implementojë, nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm ndryshimesh të thella e të gjithanshme brenda saj, si dhe në veprimtarinë ligjzbatuese në raport me të tretët, ku primare janë marrëdhëniet e saj me komunitetin. Kjo filozofi dhe proceset e diktuarë prej saj, synojnë ta shndërrojnë policinë shqiptare, në një model me profil bashkëkohor dhe sa më afër standardeve të vendeve euroatlantike.

Në imazhin e publikut, Policia e Shtetit, përfaqësohet me cilësinë e shërbimeve që i ofron komunitetit, me praninë e

saj numerike, me shpërndarjen e saj në territor, me uniformën e saj, etj. Po të analizojmë dy shërbime të saj, Policinë e Rendit dhe Policinë Rrugore, shohim se ato janë lehtësish të identifikueshme nga të gjithë, sepse janë struktura që ndërhyjnë të parat, qoftë për probleme të rendit dhe sigurisë publike, qoftë për incidentet dhe aksidentet rrugore, por edhe kur ndodh një krim. Nisur nga misioni dhe detyrat funksionale të tyre, ato janë në kontakt të përditshëm dhe për arsyen të ndryshme, me të gjitha kategoritë shoqërore e profesionale të shoqërisë sonë.

Ndaj, në përputhje me objektivin tonë dhe për të orientuar në mënyrë strategjike policinë, drejt një policimi të bazuar në komunitet, si dhe në përputhje me rekomandimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, të nënshkruar me Bashkimin Evropian, duke përfituar nga rasti që në këtë konferencë, kemi të ftuar, nga të gjitha nivelet, do të doja të reflektonim bashkërisht në çështje të tilla si, eficencia e strukturës së re e polisë, domosdoshmëria e vendosjes së një raporti të tillë, ku polici të shkojë te publiku dhe jo e kundërta, orientimi drejt patrullave në këmbë, duke favorizuar kontaktin e drejtpërdrejtë me publikun, përzgjedhjen e inspektorit profesionist, që të gëzojë besimin e publikut, të jetë banor i asaj zone dhe të jetë memoria e polisë kriminale dhe së fundi, komunikimin dhe bashkëpunimin midis tre komponentëve: Polici e Shtetit, komunitet dhe njësitet e qeverisjes vendore.

Mendoj se, vetëm duke debatuar dhe zgjidhur këto çështje, ne duhet të pretendojmë të fitojmë besimin e publikut, kur dihet që çdo institucion, aq më tepër policia, nuk mund të bëjë pa besimin e tij. Policimi në komunitet, është një proces që do të vazhdojë me zbatimin e tij në praktikë, por profesionalizmi, njohja dhe respektimi maksimal i ligjeve dhe i të drejtave të njeriut, kultura dhe humanizmi, janë faktorët

që do të na ndihmojnë në realizimin me sukses të këtij procesi.

Në bazë të programeve të hartuar me Ministrinë e Arsimit, apo Drejtoreti e Policisë së Qarqeve me Drejtoreti Arsimore, ne kemi kohë që bashkëpunojmë për rritjen e sigurisë në shkolla. Domosdoshmëri del, që ne duhet të jemi më prezent në to, për probleme të tilla si, për njohjen dhe respektimin e rregullave të qarkullimit nga nxënësit, për garantimin e aktivitetit normal të tyre, etj. Nëpërmjet medias, ne duhet të vazhdojmë të realizojmë publicitetet në funksion të njohjes dhe respektimit të rregullave të qarkullimit, nga të gjithë përdoruesit e rrugës, për marrjen e masave mbrojtëse, për parandalimin e çdo veprimtarie kriminale në shkolla, dhe sidomos tendencën për përdorimin e drogave në afërsi të shkollave, universiteteve apo vende publike.

Lufta kundër krimtit të organizuar, është aktualisht një prioritet qeverisës dhe njëherësh objektiv i rëndësishëm i Policisë së Shtetit. Pa dyshim, që kjo luftë, përbën një nga sfidat e mëdha me të cilat po ndeshet sot shoqëria shqiptare. Rezultatet e arritura gjatë këtij viti në këtë drejtim, e sidomos në bashkëpunimin e vendosur midis Policisë dhe Pushtetit Vendor, për luftën kundër kultivimit të bimës narkotike “Cannabis Sativa”, për të cilën dëshiroj që të shpreh falenderimin tim, më bëjnë të besoj dhe njëherësh të inkurajoj, strukturat dhe gjithë shoqërinë shqiptare, për rezultate edhe më të mëdha në të ardhmen.

Krimtit të organizuar do t'i përgjigjemi në mënyrë të organizuar. Aktualisht kemi ngritur struktura efikase të luftës kundër këtij fenomeni, janë miratuar dhe aplikohen metodat speciale të hetimit, kemi krijuar të gjithë kuadrin ligjor, në mënyrë që askush të mos abuzojë me të drejtat ligjore dhe njëkohësisht, askujt të mos i cenohen të drejtat nga raste të këtij fenomeni.

Lufta kundër krimit të organizuar është sfida jonë e përbashkët, sfidë të cilën nuk mund ta përballojmë vetëm pa pjesëmarrjen aktive të të gjithë aktorëve institucionalë të shtetit, të politikës së vendit, partnerëve evropianë, shoqërisë civile, etj. Do të theksoja këtu veçanërisht bashkëpunimin rajonal edhe më gjerë, duke konsideruar edhe njëherë se, vetëm me këtë mënyrë i bëhet një parapritë e mirë krimit të organizuar, i cili nuk njeh kombësi dhe as kufij.

Të nderuar pjesëmarrës!

Një lidhje më e plotë, më e afërt dhe me rezultate shumë më të drejtpërdrejta në fushën e sigurisë, do të ishte bashkëpunimi ndërmjet strukturave policore dhe publikut, afërsia e tyre me njëra-tjetrën. Është fakt i pakundërshtueshëm se angazhimi i punonjësve të policisë dhe në mënyrë të veçantë i drejtuesve, të të gjitha niveleve për të bërë të vërtetë dhe të dobishëm këtë bashkëpunim, do të sillte më shumë transparencë dhe besim reciprok në përpjekjet e përbashkëta polici – komunitet, për të rritur standartet dhe parametrat e sigurisë.

Jemi të bindur, se pa këtë bashkëpunim, nuk mund të ketë policim bashkëkohor, nuk mund të ketë rezultate të larta në sigurimin e rendit e të qetësisë publike dhe aq më tepër, rezultate të larta për parandalimin dhe zbulimin e krimit, prandaj policimi në komunitet sot nuk është vetëm një tendencë e kohës, por një realitet i prekshëm.

Në këtë proces ndryshimesh të thella të orientuara drejt komunitetit, policia shqiptare ka patur dhe ka ndihmën e pakursyer të Misionit Policor PAMECA, të Programit ICITAP, të PNUD-it, si dhe të mjaft Organizatave Jo Fitimprurëse shqiptare. Gjej rastin t'i falënderoj dhe t'i siguroj përgatishmërinë e Ministrisë së Brendshme, për vazhdimin e këtij

procesi bashkëpunimi në të gjitha fushat në interes të forcimit e fuqizimit të Policisë së Shtetit si dhe sigurimit të rendit dhe sigurisë publike.

Duke përfunduar, më lejoni që t'ju informoj se kemi hartuar Strategjinë 10-vjeçare të zhvillimit të Policisë së Shtetit, e cila aktualisht është në proces konsultimi me grupet e interesit, OJF-të, partnerë ndërkombëtare, Strategjinë e Policimit në Komunitet, e cila edhe kjo është në proces miratimi, etj., dhe njëherësh t'ju siguroj se Ministria e Brendshme, është e gatshme të bashkëpunojë me të gjithë partnerët e mundshëm, të cilët kanë vullnetin të kontribuojnë në zbatimin e filozofisë së policimit në komunitet. Ne vlerësojmë bashkëpunimin e deritanishëm dhe përvojat pozitive të arritura duke synuar krijimin e bindjes te qytetarët se Policia e Shtetit është një shërbim, dhe se ajo në çdo rrethanë do zbatojë vetëm ligjin duke respektuar të drejtat e qytetarëve.

Suksesë në zhvillimin e kësaj konference!

Faleminderit!

Bajram IBRAJ

Drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit

Është kënaqësi e veçantë edhe për mua që në këtë auditor të përshëndes në emër të të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit dhe t'u uroj të gjithë pjesëmarrësve suksese gjatë zhvillimit të punimeve të Konferencës së Pestë Kombëtare “Besimi publik – Sfidë për Policinë.

Sic dihet tashmë, në institucionet dhe shoqërinë shqiptare, të përfshira në një tërësi reformash dhe ndryshimesh të rëndësishme, sipas standardeve të vendeve të zhvilluara perëndimore, po përdoren mjaft nocione, parime, institute, rregulla e norma të reja morale e juridike. Krahas tyre, po zënë vend gjithnjë e më shumë edhe problemet e bashkëpunimit me qytetarët, apo thënë ndryshe problemet e policimit në komunitet.

Duke trajtuar çështje të ruajtjes së rendit, të shkeljeve të ligjit apo aspekte të caktuara të kriminalitetit si p.sh. përvrasjen, trafikun e qenieve njerëzore, krime në fushën e drogës, për kriminalitetin e organizuar, etj., të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi sigurinë e përgjithshme të shoqërisë dhe të individit, janë hedhur edhe bazat për një mendim të përpunuar teorik, por edhe praktik, të çështjeve që lidhen bashkëpunimin ndërinstitucional dhe me komunitetin.

Në tërësinë e tyre problemet e kriminalitetit dhe sidomos problemet e parandalimit të tij dhe çështjet që lidhen me rolin e policisë në këtë veprimtari nuk mund të vlerësohen dhe të zgjidhen në mënyrë efektive e cilësore pa u fokusuar në konceptin bashkëkohor të policimit në komunitet, i cili natyrisht që ka në themel të tij besimin e ndërsjelltë midis qytetarit dhe punonjësit të policisë.

Parandalimi i krimít nuk mund të shihet më vetëm si çështje e politikave kriminale ose si problem që mund të zgjidhet vetëm nga sistemi ligjor e shtypës, për vetë faktin e thjeshtë se parandalimi i krimít mbalon një gamë të gjërë të aktiviteteve të një shoqërie. Të tilla mund të përmendim politikat e zhvillimit ekonomik e të mirëqenies sociale, të arsimimit, strehimit, të çështjeve kulturore e kështu me radhë.

Për këtë arsy, në këtë veprimtari ne mund dhe duhet të përfshijmë të gjithë aktorët, faktorët dhe subjektet e interesuara. Për të gjithë është mëse e qartë se ne nuk mund të jemi vetëm konsumatorë të rendit e sigurisë publike, por duhet të jemi edhe krijues apo të paktën kontribues të rendit e sigurisë.

Në funksion të realizimit të këtyre objektivave e qëllimeve ne tashmë kemi krijuar një traditë mjaft të mirë dhe efektive, duke filluar nga forcimi i bashkëpunimit me institucionet e administratës publike dhe me shoqërinë civile, dhënia llogari para organeve të zgjedhura dhe komunitetit, krijimi i strukturave të posaçme me përfshirjen e shumë aktorëve për parandalimin e kriminalitetit e të shkeljeve të ligjit, etj.

Në këtë kuadër si dhe në funksion të përpjekjeve për të gjetur forma dhe rrugë të reja bashkëpunimi me publikun, kohët e fundit Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka vendosur që në çdo fund viti të organizojë anketime të komunitetit mbi punën e strukturave vendore të saj si dhe për cilësinë e shërbimeve të ofruara prej tyre.

Me fjalë të tjera, ky anketim do të synojë në drejtim të térheqjes së mendimeve të komunitetit mbi punën e bërë nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara për komunitetin. Nëpërmjet anketimit do të térhiqen opinionet dhe mendimet e grup-moshave të ndryshme dhe në raport me problematikën e çdo njësie administrative vendore, duke përfshirë gjithashtu edhe të gjitha shtresat shoqërore, pjesëtarë të minoriteteve, të grupeve të ndryshme të interesit, etj.

Bazuar në këto anketime ne do të realizojmë studime të hollësishme jo vetëm për të përcaktuar mënyrën e perceptimit prej qytetarëve të sasisë dhe cilësisë së shërbimeve tona, por edhe për të përcaktuar hapat që duhet të ndërmarrim dhe ndërhyrjet që duhen realizuar për përmirësimin e punës dhe të shërbimeve tona.

Në përfundim të fjalës time, dëshiroj të nënvisojoj edhe një herë angazhimin e të gjithë strukturave dhe të punonjësve të Policisë së Shtetit se fitimi i besimit të publikut prej nesh do të përbëjë kurdoherë një detyrim permanent si dhe kushtin pa të cilin ne nuk mund të realizojmë me sukses të gjitha detyrimet që kemi para komunitetit për përmirësimin e vazhdueshëm të parametrave të rendit e sigurisë publike dhe të luftës kundër krimtit.

Faleminderit!

Ruzhdi Keç
Prefekt i Qarkut Tiranë

Përvoja e Qarkut Tiranë në krijimin e Bordeve të Parandalimit të Krimit

Duke qenë se rritja e parametrave të rendit, sigurisë publike dhe lufta kundër krimit në përgjithësi dhe atij të organizuar në veçanti janë prioritetë të qeverisë, është krejt e natyrshme që ato të përbëjnë prioritet edhe për veprimtarinë e institucionit të prefektit.

Në këtë këndvështrim jemi përpjekur të ngulitim konceptin se rendi publik dhe lufta kundër krimit përbëjnë obligim për të gjithë qytetarët, por në radhë të parë për drejtuesit e organeve të pushtetit (qendror e vendor), për drejtuesit e institucioneve arsimore, shëndetësore e sociale si dhe për shoqërinë civile. Në vijim të kësaj logjike, me nxitjen e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim në muajin mars të këtij viti organizuam një takim me të gjithë aktorët e interesuar dhe të angazhuar në luftën kundër krimit dhe parandalimin e tij në nivel qarku. Përmes këndvështrimeve të ndryshme pjesëmarrësit trajtuan nga njëra anë shkaqet dhe tendencat e krimit dhe nga ana tjetër dhanë mendime rreth goditjes dhe parandalimit të tij. Të gjithë ishin në emërues të përbashkët në mendimin se krimi pengon seriozisht zhvillimin ekonomiko-social të vendit dhe se lufta apo parandalimi i tij kërkon institucionalizimin e një bashkëpunimi mes aktorëve të përfshirë në këtë fushë. U vlerësuan së tepërmë përvojat

dhe idetë e IDN-së, PNUD-it veçanërisht modelet e policimit në komunitet. Në fakt ky takim shërbeu si zanafillë e Bordeve të Parandalimit të Krimit, të cilat u krijuan më pas pranë komisariateve në përputhje me planin e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë.

Sikurse për çdo nismë apo ide të re në drejtëm të luftës ndaj krimit apo përpjekjeve të përbashkëta për parandalimin e tij, edhe për bordet e krijuara institucioni i prefektit dha mbështetje të plotë duke i konsideruar dhe vlerësuar si hapa mjaft pozitivë e të rëndësishëm.

Bordet e Parandalimit të Krimit janë konceptuar si organizma konsultative pranë shefit të komisariatit të policisë. Përveç shefit të komisariatit në përbërje të tij janë kryetarët e njësive të pushtetit vendor (minibashki, komuna), përfaqësues të prokurorisë së rrethit, arsimit, shëndetësisë, si dhe përfaqësues të biznesit, komunitetit, grupeve të interesit, organizatat rinore dhe OJF-të.

Bordet kanë për qëllim:

- diskutimin e problemeve të krimit në zonën që mbulon komisariati përkatës;
- përcaktimin e problematikave specifike të zonës dhe konsultimi i mënyrave të zgjidhjes së tyre;
- organizimin e bashkëpunimit, ndarja dhe marrja e përgjegjësive në kuadër të parandalimit të krimit;
- sensibilizimin e komunitetit për bashkëpunim dhe pjesëmarrje në veprimtari parandalues;
- hartimin e planeve konkrete të parandalimit të krimit.

Pas ngritjes së këtyre bordeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë dhe IDN-në kemi zhvilluar takime të zgjeruara me një pjesë të këtyre bordeve. Kështu, në periudhën maj-qershor këto lloj takimesh janë realizuar në komisariatet nr. 1, 2, 4, 5 dhe 6. Me kënaqësi kemi konstatuar se në këto

takime përgjithësisht komunitetit dhe aktorët e tjerë të pranishëm, shprehen më konsiderata pozitive rreth punës së policisë dhe marrëdhënieve reciproke bashkëpunuese. Autoritetet e mbrojtjes së ligjit pasi kanë prezantuar punën e tyre, kompetencat që iu jep ligji vakuumet ligjore për çështje të caktuara si dhe vështirësitet e hasura, kanë kërkuar bashkëpunimin konkret me organet e qeverisjes vendore, drejtuesit e shkollave të të gjitha niveleve apo me ndërlidhësit e komunitetit (kryepleqtë) për të siguruar informacionin e nevojshëm si çelësi i suksesit të punës së policisë. Nga ana e tyre përfaqësuesit e arsimit në zonat respektive kanë çmuar bashkëpunimin me komisariatet e policisë dhe kanë shprehur interesimin për thellimin e këtij bashkëpunimi sidomos për nxënësit problematikë që për shkak edhe të kushteve ekonomike e sociale në familjet e tyre, bëhen shpesh viktima të mundshëm të krimtit. Evidentimi i plotë i nxënësve që braktisin shkollen ka rezultuar si një aspekt tjetër ku mund të ndikojë bashkëpunimi i policisë me drejtoritë e shkollave.

Lidhja e aktorëve të ndryshëm në këto borde në ndonjë njësi vendore na ka rezultuar mjaft interesante; kështu p.sh. në Vorë e Kashar (Komisariati i Policisë nr. 2), Njësinë Bashkiake 2 (Komisariati 1) dhe gjetkë, punonjësit e policisë konsiderohen si pjesë e administratës vendore, sikurse dhe kryepleqtë/ndërlidhësit e komunitetit të këtyre njësive dhe kanë marrëdhënë mjaft të ngushta e të mira me komisariatet e policisë. Është tepër domethënës fakti që Këshilli i Komunës në Kashar merr vendim të shpërblejë në fundvit bashkë me punonjësit e komunës edhe punonjësit e policisë. Po kështu akordimi i fondeve për mjete ndërlidhjeje për policinë është një tjetër shembull bashkëpunimi e solidariteti mes organeve të qeverisjes vendore dhe strukturave vendore të Policisë së Shtetit.

Të njëjtën gjë mund të pohojmë edhe përfaqësuesit e biznesit në Bordet e Parandalimit të Krimtit. Ata jo vetëm kanë

paraqitur shqetësimet e tyre në këto takime, por në funksion të mbarëvajtjes së luftës kundër krimit dhe parandalimit të tij, kanë dhënë mbështetje financiare për fuqizimin logistik të komisariateve.

Jo pa rezultat ka qenë edhe prania e shoqërisë civile në këto Borde. Informacioni i saktë dhe i detajuar që OJF-të kanë për probleme specifike të krimit, kanë ofruar në Borde shërbime mjtaft cilësore.

Mendoj se është me interes të përmend këtu edhe idenë e Shefit të Komisariatit të Policisë nr. 6, zotit Ilo Këçka, për një hartë sociale të zonës së policimit. Në këtë hartë, veç të dhënavë për rendin dhe kriminalitetin, të paraqiten edhe të dhëna rreth karakteristikave sociale, ekonomike, të punësimit, arsimimit, etj. Një hartë e tillë krijon një përvojë të re e të vlefshme në punën parandaluese të strukturave të policisë. Ajo gjithashtu krijon mundësi për rezultate më të larta në menaxhimin e territorit dhe parandalimin e kriminalitetit.

Në përfundim, besoj se përvuja e krijuar deri tanë me Bordet e Parandalimit të Krimtit është një kontribut që jo vetëm pasuron punën parandaluese të kriminalitetit në përgjithësi, por është gjithashtu mjtaft i vlefshëm për t'u shfrytëzuar në veprimtarinë e strukturave të ngritura në nivel qarku për luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike, për Grupin e Ekspertëve për Sigurinë Rrugore, apo komitetet rajonale antitrafik.

Bardh Rica
Kryetar i Këshillit të Qarkut Lezhë

Strategjia vendore e Parandalimit të Krimtit

Qarku i Lezhës ka një sipërfaqe prej 1600 km² dhe përfshin rrethet Lezhë, Kurbin dhe Mirditë me 9 qytete, 168 fshatra, 5 bashki, dhe 16 komuna. Popullsia e qarkut numëron 208 041 banorë nga të cilët 39.4% janë në qytet dhe 60.6% në fshat.

Këshilli i Qarkut Lezhë gjatë këtyre tre viteve ka hartuar dhe ka bashkëpunuar për:

- Përgatitjen e Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut Lezhë në bashkëpunim me PNUD-in;
- Hartimin e Planit Rajonal të Kujdesit Komunitar për Qarkun në bashkëpunim me Këshillin Britanik;
- Përfundimin e studimit të rregullimit të tërësisë ujore të Lezhës për eleminimin e përmbytjeve - bashkëpunim me Akademinë e Shkencave;
- Përgatitjen e hartës së nevojave për ndërtime të Qendrave Shëndetësore dhe Institucioneve Arsimore në shkallë qarku në bashkëpunim me DRA-në dhe DSHP-në;
- Përfshirjen me sukses në projektin Eptises “Studimi Rajonal Lezhë-Shkodër”;
- Përfshirjen me sukses në projektin ELPA-S për hartimin e Planit të Veprimit në Mjedis;
- Përfundimin e studimit urbanistik në të dy akset e superstradës në kufijtë Krujë-Shkodër;

- Pasqyrimin në dokumentarë televizivë të burimeve natyrore, potencialeve turistike dhe vlerave të tre rretheve të qarkut.

Gjendja e rendit dhe sigurisë publike në momentin e hartimit të kësaj strategjje

Duke parë se strategjia e rendit dhe sigurisë është shumë specifike si problematikë, dikush mund të shprehet skeptik dhe të thotë që këto janë detyra të policisë dhe organeve të prokurorisë, gjykatave ose organeve të specializuara të kësaj fushe.

Drejtoria e Programim-Zhvillimit, në bashkëpunimin serioz dhe me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim, ka bërë moto të sajën, gjithnjë e më tepër se siguria dhe parandalimi i krimit në komunitet është një çështje shqetësuese dhe përgjegjësi e të gjithë neve, pavarësisht nëse jemi apo jo oficerë policie, apo punonjës të autoritetet vendore, punonjës shëndeti, arsimi, apo banorë të një fshati, lagjeje, apo qyteti.

Mendojmë se gjatë hartimit të këtij dokumenti të rëndësishëm mes të tjera shi do të zhvillohet bashkëpunimi në një nivel më të lartë dhe në vazhdimësi mes policisë, organeve të pushtetit vendor, organeve qendrore në nivel vendor, komunitetit të biznesit, organizatave civile dhe fetare si dhe komunitetit.

Mbështetur në të dhënat e prokurorisë së rrëthit gjyqësor Lezhë rezulton se kriminaliteti vitet e fundit me gjithëse është rritur numri i popullsisë dhe zgjerimi: territorit nga lëvizjet demografike dhe lëvizja e lirë e popullsisë dhe zhvillimit ekonomik të zonës tonë, është konstant parë në këndvështrimin e numrit të veprave penale “të ndodhura dhe të regjistruesi” si dhe mbahet nën kontroll të organeve shtetërore të.-ngarkuara për zbatimin e ligjës sipas përkatësive.


Numri i çështjeve penale të regjistruara në pesë vitet e fundit është rreth 350 çështje penale në një vit. Vërehet një tendencë në ulje e veprave penale të kryera si vrasje, vjedhje me dhunë e me armë e banesave, trafiku njerëzor dhe i mallrave, etj. Kjo edhe si pasojë e rritjes së forcës goditëse të organeve të zbatimit të ligjit, por dhe e punës së bërë nga institucionet dhe organizata të ndryshme qeveritare dhe organizatave jo fitimprurëse.

Është konstatuar se numrin më të madh të veprave penale e kanë kryer persona të papunë me arsim fillor e banim në fshat.

Në çështjet e regjistruara këtë 9-mujor ka çështje për vepra penale që drejtohen kundër jetës së personit si rrahje, kanosje, plagosje e lehtë dhe e rëndë, deri në vrasje; vepra penale të drejtuara kundër pasurisë si vjedhje, mashtrim, vjedhje të energjisë elektrike, vepra penale kundër mjedisit si peshkim i paligjshëm me mjete plasëse ose dëmtim e prerje pyjesh, vepra penale që drejtohen kundër autoritetit të shtetit si mbajtje armësh pa leje, shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor duke bërë që superstrada që kalon në territorin e qarkut tonë të marrë emrin autostrada e vdekjes, mosbindje ndaj urdhavrave të policisë, prishje e rendit dhe qetësisë publike, vepra penale që drejtohen kundër drejtësisë.

Nga sa cilësuam më sipër është vërejtur që nga viti në vit është rritur numri i çështjeve penale të regjistruara për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, që fatkeqësisht është shoqëruar dhe me një numër relativisht të madh viktimash ose të dëmtuarish.

**Të dhëna statistikore për kriminalitetin
dhe puna e bërë për goditjen e tij,
në Qarkun Lezhë**



Pavarësisht se autorët e këtyre veprave penale janë arrestuar e i janë dërguar gjyqit kur kanë sjellë pasoja serioze, mendojmë se ka vend për një bashkëpunim më të mirë ndërmjet strukturave të ndryshme duke filluar nga sektori i qarkullimit rrugor, nga pushteti vendor, strukturat e arsimit duke bërë të mundur marrjen e masave parandaluese në shtimin e kontrollit ndaj drejtuesve të papërgjegjshëm të automjeteve. Pushteti vendor ka detyrimin të marrë të gjitha masat për mirëmbajtjen e sinjalistikës rrugore dhe deri te shembulli pozitiv i qytetit të Lezhës që konsiston në vendosjen e “oficerëve civilë” në çdo kryqëzim rruge me shkollat.

**Kjo strategji do të ketë pjesët e saj përbërëse,
të cilat do të mbështeten në këto pikat:**

- Plan i detaujar masash i strukturave vendore të Policisë së Shtetit;

- Plan i bashkive, komunave për administrimin e territorit dhe identifikimin e problemeve që mund të gjenerojnë krimi (sidomos problemet e pronësisë);
- Hartimi i hartës sociale për çdo njësi të qeverisjes vendore;
- Plane të Drejtorisë Arsimore dhe shkollave;
- Plane për mbrojtjen e fëmijëve;
- Plani i Përmirësimit të Shërbimit Shëndetësor;
- Plane konkrete të përbashkëta kundër varfërisë (duke u përqendruar në rastet emergjente);
- Planet në bashkëpunim me bizneset vendore;
- Strehimi;
- Plane të organizatave rimore;
- Mbështetja në Strategjitet, planet e zhvillimit dhe ekonomik kombëtar;
- Plane të ndryshme të organizatave të ndryshme që kanë aktivitet në Qarkun Lezhës.

Të gjithë aktorët pjesëmarrës duhet të adresojnë dhe të ndërhyjnë në çështje që konsiderohen si faktorë me rrezik në shkaktimin e krimeve, si dhe duhet të kontribuojnë në mbështetjen e viktimave ose reduktimin e frikës nga krimet.

Zhvillimet e kësaj strategjie


- Ekzaminimi i gjendjes së kriminalitetit dhe shkaqeve;
- Informacion statistikor;
- Progresi i bërë deri në momentin aktual në lidhje me priorititetet ekzistuese;
- Kosto e krimeve;
- Krahasime me zona të tjera si rajonale ashtu edhe kombëtare;
- Niveli krimeve dhe i çrregullimeve;
- Të dhënrat socio-demografike.

Një analizë e detajuar e informacionit do të përdoret për të identifikuar veprime që nevojiten të ndërmerren në mënyrë që të adresohen prioritetet e identikuara dhe për të monitar progresin e bërë.

Këshillimi me grupet e interesit dhe komunitetin

Këshillimi si mënyrë për mbledhjen e informacionit real mbi gjendjen e kriminalitetit dhe perceptimin e komunitetit mbi rendin publik dhe sigurinë në përgjithësi duhet përdorur në masë të gjërë. Ky këshillim mund të bëhet nëpërmjet anketimeve (pyetësorëve) të ndryshme. Informacioni i nevojshëm mund të mblidhet edhe nga raportimet e punonjësve të organeve dhe institucioneve të ndryshme, të cilët kanë kontakte direkte me komunitetin si p.sh: inspektorët e polisë së rendit në zona, punonjësit socialë, etj.

MEMORANDUM MIREKUPTIMI



Pyetësorët si dhe gjithë raportet mblidhen në një dokument së bashku me prezantime dhe vlerësimë nga organet e pushtetit vendor, organizatat civile, forumet e qytetarëve, drejtuesit e shkollave, grupet e interesit, etj. Ky dokument në formën e një raporti hartohet periodikisht (çdo 6 muaj për shembull) dhe do të identifikojë problemet më shqetësuese. Mbështetur në këto të dhëna Komiteti Vendor i Parandalimit të Krimit do të mund të përcaktojë prioritete në fushën e sigurisë.

Problemet më shqetësuese të identikuara si shkaqe të krimit dhe që cenojnë sigurinë e komunitetit:

- Pronat;
- Vjedhja e banesave;
- Sjelljet antisociale;
- Qarkullimi dhe aksidentet rrugore;
- Vjedhja e automjeteve;
- Dhuna në familje;
- Krimi në rrugë (ku përfshihen vjedhjet me dhunë në rrugë sidomos në ambiente të errëta dhe të veçuara, vjedhjet në mjetet e transportit publik ose vende të tjera publike si tregje, etj.);
- Frika nga krimi e shprehur në mosdenoncimin nga ana e viktimave apo dhe e dëshmitarëve. (Kjo “frikë” ka një ndikim serioz në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe shkak mund të jetë mungesa e besimit tek organet dhe strukturat shtetërore: policia, sistemi gjyqësor, etj.);
- Strategjia do të parashikojë edhe masa specifike përkthimin dhe rritjen e besimit në këto organe.

Në këtë strategji do të përzgjidhen prioritetet rast pas rasti dhe do të përcaktohen masa për të luftuar dhe sidomos parandaluar këto fenomene. Në takimet periodike të të gjithë

aktorëve vendorë do të vendoset lidhur me përcaktimin e prioriteteve në planet përbërëse të strategjisë, si dhe do të monitorohet progresi duke siguruar përkushtim nga organet dhe aktorët e përfaqësuar për shpërndarjen e sigurinë në komunitetin e qarkut.

Prioritetet

Seleksionimi i çështjeve të identifikuara si prioritet për të cilat strategjia parashikon ndërhyrje të menjëhershme nuk do të thotë se asnjë veprim apo ndërhyrje nuk do të ndërmerrët ndaj çështjeve jo prioritare. Nëpërmjet seleksionimit si prioritet, sigurohet që një çështje (problem) të jetë subjekt i aksioneve të koordinuara dhe prioritari në kërkim për masa të menjëhershme dhe akordim fondesh dhe vëmendje të mëtejshme.

STRATEGJIA E SIGURISE DHE E PARA STRATEGJIA E SIGURISË DHE E PARANDALIMIT TË KRIMIT NË QARKUN LEZHË



Në **Strategji** do të parashikohen edhe një sërë marrëveshjesh mes institucioneve dhe shoqërisë civile, përfshirë grupet e interesit, OJF-të, etj. Këto marrëveshje do të mund të bëhen jo vetëm në kuadër të bashkëpunimit në hartimin dhe zbatimin e planeve konkrete në zbatim të strategjisë, por edhe elementë të vlerësimit dhe monitorimit.

Objektiva

Strategja përcakton objektiva konkrete duke përcaktuar masat që do të merren si dhe personat (organet, institucionet) përgjegjës.

Rezultatet e pritura

Specifikohen rezultatet e pritura për çdo periudhë (6 mujore për shembull)

Kryekomisar Ahmet Prençi
Drejtor i Policisë, Qarku Shkodër

Rreth bashkëpunimit me Komunitetin në parandalimin e veprave penale dhe forcimin e sigurisë në Qarkun e Shkodrës

Në një shoqëri të hapur e demokratike, parandalimi i krimit dhe i çdo veprimtarie të kundërligjshme mbetet gjithmonë një përparësi themelore për strukturat e Policisë së Shtetit, institucionet shtetërore dhe mbarë shoqërinë civile.

Të parandalosh fenomenin e kriminalitetit, duhet të jesh në gjendje të grumbullosh informacion të plotë, të saktë dhe nga burime të kualifikuara, për çfarë po ndodh ose pritet që të ndodhë. Kërkohet aftësi dhe dije të qëndrueshme e të gjithanshme, që një strukturë e vetme, siç është Policia e Shtetit, sado perfekte dhe efektive që të jetë nuk mund t'i përbushë pa mbështetjen e të gjithë aktorëve të tjera të shoqërisë.

Këtu lind domosdoshmërisht nevoja e planifikimit dhe e bashkëveprimit të masave dhe veprimeve me pjesëmarrjen e të gjithë shoqërisë duke i aplikuar ato në kohën dhe vendin e duhur.

Disa drejtime kryesore të bashkëpunimit në Qarkun e Shkodrës:

Nën drejtimin dhe kujdesin e prefektit të Qarkut Shkodër, zotit Gjovalin Kolombi, në mënyrë permanente janë

organizuar takime të të gjithë institucioneve shtetërore që veprojnë në qark si: policia, prokuroria, dhoma e tregtisë, komuniteti i biznesit, arsimi, shëndetësia, njësitë e qeverisjes vendore, etj., me qëllim rritjen e bashkëpunimit për parandalimin e krimit dhe rritjen e sigurisë e të rendit në Qarkun Shkodër.

Mund të themi me bindje se policia e Shkodrës tashmë nuk është më e vetme në kryerjen e misionit të saj fisnik, por ka përkrahjen dhe mbështetjen e pothuajse të gjithë aktorëve.

Dëshiroj të ndalem në drejtimet kryesore ku është përqendruar vëmendja e veprimtarisë së Drejtorisë së Policisë të Qarkut Shkodër:

Së pari: Shërbimi policor profesionist, zbulimi dokumentimi dhe goditja në kohë e veprimtarisë kriminale, përveç ndikimit të drejtpërdrejtë në uljen e nivelit të kriminalitetit në tëresi, rrit dukshëm besimin dhe ndjenjën e sigurisë në komunitet. Këtu mund të përmendim se në Qarkun Shkodër në saje të profesionalizmit të policisë dhe rritjen e besueshmërisë së komunitetit te policia është ulur ndjeshëm numri i krimeve të rënda, **9 vrasje** të ndodhura në këtë vit që të gjitha të zbuluara ku janë proceduar autorët, është numri më i vogël i vrasjeve i regjistruar këto 15 vitet e fundit.

Ajo që është më e rëndësishme është se në saje të këtij besimi dhe bashkëpunimi janë parandaluar ndodhja e **4 vrasjeve** dhe **1 vjedhje** me armë ku para se të ndodhni veprat e rënda penale në saje të informacioneve të marra janë arrestuar autorët dhe ndodhen para drejtësisë. Këto janë sinjale mjaft pozitive për të rritur besueshmërinë e policisë në komunitet. Ky besim ka rritur bashkëpunimin e komunitetit me polisinë nëpërmjet sallës operative në **4 herë** më shumë në krahasim me vitin 2005. Janë **2481** telefonata të bëra në

sallën operative këtë vit ku qytetaret raportojnë dhe shprehin shqetësimin e tyre. Nga këto telefonata është bërë i mundur zbulimi i **51** rasteve që bëjnë fjalë për vepra penale, kapje të personave në kërkim dhe me armëmbajtje pa leje. Në asnjë rast nuk është dekonspiruar burimi duke rritur kështu garancinë dhe sigurinë e këtij komunikimi.

Duhet theksuar se si rezultat i bashkëpunimit me komunitetin, tashmë i vënë në themel të punës sonë është rritur besimi reciprok, është përmirësuar dukshëm shërbimi i policisë ndaj qytetarëve dhe kjo ka sjellë fryte konkrete dhe të dukshme.

Së dyti: Nxitja dhe rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit me pushtetin vendor në të gjitha nivelet ka rol të pazëvendësueshëm. Duke realizuar një bashkëpunim të frytshëm me të gjitha nivelet e qeverisjes lokale është arritur të vendosim një bashkëpunim të ngushtë dhe të frytshëm të policisë me komunitetin dhe edukimin e publikut me nevojën e parandalimit të krimtit. Në këtë kuadër, në Shkodër janë zhvilluar aktivitete me temë të përcaktuar dhe takime periodike me kryetarët e Komunave, kryetarët e fshatrave kryesisht për fenomenet që kanë shqetësuar më së shumti komunitetin dhe që kërkojnë ndërhyrjen e policisë.

Nga pushtetarët lokalë pothuajse në të gjitha zonat në qytet dhe fshat janë krijuar ambiente për inspektorët e policisë në zona, pika këto të rëndësishme kontakti mes policisë, pushtetit vendor dhe komunitetit. Këtu gjej rastin të përshëndes kontributin e Institutit për Demokraci e Ndërmjetësim për ndihmën e dhënë në krijimin e këtyre urave të domosdoshme. Kjo punë e nisur ka dhënë rezultate të dukshme për strukturat e policisë në ndërgjegjësimin e publikut me ndjenjën për të kontribuar efektivisht së bashku me policinë për parandalimin e goditjen e aktiviteteve të kundërligjshme.

Së treti: Një bashkëpunim i ngushtë është aplikuar me institucionet arsimore. Në Shkodër, në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorenë Arsimore dhe Rektoratin e Universitetit dhe Zyrën e OSBE-së Shkodër, janë zhvilluar takime dhe aktivitete të shumta që i janë kushtuar luftës kundër trafikut të paligjshëm, trafikut dhe përdorimit të lëndëve narkotike. Për këtë qëllim në bashkëpunim me drejtorenë arsimore janë zhvilluar takime me nxënës të shkollave për të prezantuar rrezikun që përbën përdorimi i drogave në moshat e reja.

Është bashkëpunuar gjithashtu me OJF-të për të bërë prezente dhe përcaktuar masat parandaluese të trafikut të qenieve njerëzore. Është punuar dhe po punohet pandërprerë në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit përritjen e sigurisë në rrugë.

Në këto kushte, kërkohet që policia të prezantohet në publik kompetente dhe profesionale, duke paraqitur një sjellje të kulturuar dhe shumë dinjitoze. Në praktikën tonë konstatojmë me kënaqësi se është arritur të kemi shumë punonjës policie me tregues të mirë, që kanë integritetin e duhur moral, arsimor e profesional, të aftë për të përballuar sfidën dhe për të fituar besimin dhe mbështetjen e publikut.

Korrektësia, gatishmëria, profesionalizmi, garancia dhe besueshmëria janë shtyllat bazë ku shërbehet nëpërmjet prezantimit dinjitoz dhe etik në publik i punonjësve të policisë, nga ku reflektohet në përmirësimin e performancës së tyre. Aty ku inspektori është korrekt e bashkëpunues me komunitetin edhe ky komunitet është mbështetës dhe bashkëpunues. Duhet pranuar fakti se jo rrallëherë qytetarët kërkojnë me emër punonjësin e policisë për të dhënë një informacion për një ngjarje ose për të kërkuar ndihmë e i dëgjojmë të thonë: “*Dua të flas me X punonjës të policisë*” Numri i punonjësve të tillë që gjëzojnë mbështetje në komunitet është gjithnjë në rritje.

Bashkëpunimi me komunitetin duhet të vlerësohet si një çelës i artë që hap derën e suksesit. Garancia dhe mbrojtja që i afrojn policia qytetarit është një faktor vendimtar në ruajtjen dhe qëndrueshmërinë e marrëdhënieve me komunitetin.

Një rëndësi të veçantë i është kushtuar në punën tonë komunikimit të vazhdueshëm me mediat, të cilat në Shkodër i kemi konsideruar si partnerë të rëndësishëm në punën tonë. Media ka ndihmuar shumë në hapjen e policisë ndaj qytetarëve dhe ka “çbunkerizuar” institucionin e policisë në sytë e komunitetit. Gjithashtu, komunikimi çdo ditë me publikun mbi dinamikën e punës së policisë së Qarkut Shkodër është një hap tjetër i rëndësishëm i komunikimit të policisë me komunitetin. Duhet nënvizuar se policia sot i kushton vëmendjen e duhur respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Përveçse një detyrim ligjor kjo është dhe një nevojë imediate e policisë. Bashkëpunimi me qytetarët ka ndikuar edhe në pastrimin e radhëve të policisë nga elemente abuzive me detyrën. Reagimi në këto raste ka qenë i menjëhershëm i ashpër dhe ligjor.

Vlen të theksohet si shenjë e rritjes së besimit ndaj policisë edhe mbështetja e ofruar nga komuniteti i biznesit të Shkodrës me ndihmën e dhënë me pajisje kompjuterike. Gjej rastin të përshëndes këtu edhe prezencën e OSBE-së në Shqipëri dhe Ambasadën Britanike për mbështetjen e dhënë për pajisjen me kompjutera të të gjithë zyrave të Drejtorisë dhe Komisariatit të Policisë Shkodër.

Sfidë e re e jona në të ardhmen është rritja e këtij bashkëpunimi, gatishmëria e pandërprerë për t'ju përgjigjur kërkesave të qytetarëve që lidhen me policinë, rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj tyre, prezantimin në çdo moment të sukseseve dhe të prioriteteve që ka policia e shtetit. Kjo në të ardhmen do të jetë në qendër të punës tonë. Përmbrushja me sukses e misionit që ne kemi do të bëhet pjesë e të gjithë shoqërisë.

Së fundmi, duke ju falënderuar për mundësinë që m'u dha për të folur para këtij auditori të nderuar, ju siguroj se policia e Shkodrës tashmë nuk është “ajo delja e zezë” e disa viteve të mëparshme. Ajo nuk është më shënjestër e plumbave, por e falënderimeve të qytetarëve shkodranë. Gjej rastin të shpreh kënaqësinë, pasi u njoha me sondazhin e realizuar nga IDN ku vlerësimi i qytetarëve shkodranë për policinë ishte në tregues shumë të mirë.

Të nderuar zotërinj!

Besueshmëria në organin, strukturën ose në një individ të caktuar nuk është monopol e as çështje fati. Ajo si ndjenjë fitohet dhe kultivohet në procesin e njohjes dhe të bashkëpunimit në mes të palëve.

Faleminderit!

Prof. dr. Gjergj Sinani

Policia në sfidën e besimit dhe të sigurisë

Demokracia tranzicionale shqiptare, e mbërthyer në problemet e mëdha të ndërtimit të shtetit të së drejtës, ka treguar se ende nuk po i përcakton qartë prioritetet e saj. Mirëpo, aktorët politikë në një gjë duhet të bien në një emërues të përbashkët, dhe kjo ka të bëjë me vendin dhe rolin e policisë në një sistem demokratik.

Dikur Monteskjë shkruante se shteti, në mos sigurinë e plotë, duhet t'u krijojë qytetarëve ndjenjën e sigurisë. Në kuadrin e institucioneve të shtetit që lidhen me këtë çështje, policia zë një vend të veçantë. Institucioni më i drejtpërdrejtë që qytetari i drejtohet për sigurinë e vet është policia. Tek ajo qytetari kërkon sigurinë e jetës, të pronës, të shtëpisë, të lirisë së lëvizjes, etj. Kjo është arsyja pse reaksiuni qytetar është më i drejtpërdrejtë ndaj policisë.

Duhet theksuar se gjatë kësaj periudhe policisë i është dashur që të ndryshojë thelbin e konceptimit të rolit të saj. Nga një armë në duart e diktaturës së proletariatit, ajo duhej të kthehej në një institucion të qytetarëve. Në këtë drejtim depolitizimi i saj mbetet një detyrë e përhershme. E themi këtë për një arsyë të thjeshtë se ky proces ende nuk ka mbaruar.

Kur flasim për procesin e depolitizimit të saj duhet të mbajmë parasysh pozicionin shumë delikat të policisë në këtë

periudhë tranzicioni. Policia ndodhet në mes të një presioni të dyfishtë. Asaj i duhet të përballet me pasigurinë politike të demokracisë shqiptare, e cila ka prodhuar dhe prodhon vazhdimisht probleme jo vetëm për qytetarët, por veçanërisht për policinë. Paqëndrueshmëria politike e ka vënë, jo rrallë, policinë përballë problemesh të vështira duke i kushtuar edhe jetë policësh. Nga ana tjeter, policia ndodhet nën presionin qytetar që kërkon siguri. I ndodhur nën këtë presion, policia ka ditur që të qëndrojë korrekte. I duhet të jemi mirënjojës policisë për detyrën e saj nën kushtet e përmendura më sipër.

Prandaj, dalja nga ky presion i dyfishtë kërkon dy gjëra shumë të rëndësishme: profesionalizëm dhe integritet. Duken si dy fjalë të thjeshta, por kanë një rëndësi shumë të madhe për policinë. Profesionalizmi është faktori kryesor për punonjësin e policisë që të përballë paqëndrueshmërinë politike të funksionimit të demokracisë, tëshmangë presionin politik dhe mbushjen e radhëve të saj me njerëz të paaftë, apo militantë partiakë.

Integriteti është problem i vështirë. Integriteti është i lidhur me profesionalizmin, por kërkon edhe faktorë të tjera. Ai kërkon që policia të vendoset në një pozitë dinjitoze materiale dhe morale. Aspekti material nuk lidhet vetëm me pagën, por edhe me tërë infrastrukturën e domosdoshme për efikasitetin e punës së saj. Të mos harrojmë edhe një veçori tjeter. Krimi i organizuar gjen terren dhe zhvillohet në vende ku shteti i së drejtës është i dobët. Kështu, ai vendos lidhje më të shpejta dhe bëhet më i modernizuar se strukturat e luftës ndaj tij.

Për sa i përket aspektit moral, ai kërkon një angazhim të të gjitha strukturave si dhe të një komunikimi më të mirë të policisë me shoqërinë, shkollën, mediat dhe sjelljen ndaj individëve, qofshin këta edhe në proces të vuajtjes së dënitimit. Policia duhet të ketë si imperativ se ligjet dhe institucionet ndëshkimore janë bërë për të ndëshkuar, por kurrë për të poshtëruar.

Policia duhet të ketë parasysh Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut që kërkon respektimin e ligjshmërisë dhe të epërsisë së ligjit. Kjo do të thotë se veprimitaria për ruajtjen e rendit duhet të rregullohet në mënyrën e duhur me ligj, i cili duhet t'i bëhet i njohur publikut në masën e duhur. Qytetarit duhet t'i krijohen mundësítë për të pasur një informacion të mjaftueshëm mbi rregullat ligjore që zbatohen në një rast të caktuar. Nga ana tjeter, një normë nuk mund të konsiderohet “ligj”, në qoftë se nuk është formuluar në saktësinë e mjaftueshme për t'i lejuar qytetarit të përshtasë sjelljen e tij.

Duke theksuar Konventën Evropiane, qëllimi është që aktorët politikë duhet ta përshtasin legjislacionin dhe statusin e policisë me kërkesat e kësaj konverte për ta vënë në rolin që i takon. Kuptohet se Konventa ka shumë kërkesa, por mënyra e zbatimit të tyre ndryshon në varësi të rrethanave. Për shembull, Konventa nuk parashikon që individët të paralajmërohen për veprimet e mbikëqyrjes apo kontrollit. Megjithatë, ligjet që lejojnë një gjë të tillë duhet të jenë të njohura publikisht, ata duhet t'i parashikojnë këto masa me qartësinë më të madhe dhe, natyrisht, këto kushte ligjore duhen respektuar në praktikë.

Një moment delikat për policinë është edhe fakti se Konventa u njeh autoriteteve shtetërore, konkretisht policisë, disa kompetenca për të kufizuar, kur është e nevojshme, të drejtat individuale, me qëllim që të mbrohen të drejtat e shumicës ose për një interes të ligjshëm publik. Dikur Veberi shkruante se shteti ka të drejtën e “dhunës legjitime”, prandaj ka rëndësi qartësimi i kësaj të drejtë.

Konventa është një sistem ndërkombëtar i ruajtjes së të drejtave të njeriut, e cila shërben për të verifikuar nëse autoritetet shtetërore veprojnë në përputhje me kërkesat e saj. Komisioni dhe Gjykata respektojnë kompetencat e autoriteteve shtetërore dhe shpesh pranojnë se ata janë instancat më kompetente për të

gjykuar mbi nevojën e kufizimit të të drejtave individuale. Në këto raste, Konventa u jep autoritetet e shtetërore një “liri veprimi” të konsiderueshme, e cila, shpesh, kufizon verifikimin e drejtësisë së masave të marra dhe aftësisë së shtetit për të vlerësuar nëse këto masa ishin të nevojshme në rrethanat e dhëna. Pikërisht, për këtë arsy, aktorët politikë dhe ligjorë, dhe vetë policia duhet të jenë të interesuar për qartësinë ligjore të pozicionit të tyre në lidhje me qytetarët, për të mos u ndodhur përpëra situatash të pakëndshme, që mund të shkojnë deri në Gjykatën e Strasburgut.

Në raport me qytetarët, policia duhet të jetë e qartë në lidhje me garancitë e përshtatshme dhe efektive kundër abuzimit të kompetencave që kufizojnë të drejtat individuale. E rëndësishme është që të drejtat dhe liritë e parashikuara nga Konventa duhet të gëzohen pa asnjë diskriminim.

Nisur nga të tilla parametra policia është në proces të konsolidimit ligjor, por rëndësi ka zbatimi i ligjit. Në funksion të saj janë edhe strategjitë që po përpunon ajo për t'u përputhur me standardet moderne.

Çasti më i rëndësishëm i rolit dhe suksesit të policisë është fitimi i besimit të qytetarëve, përmes rritjes së ndjenjës së sigurisë, në mos sigurinë e plotë. Cilat janë drejtimet kryesore të fitimit të besimit?

Ndërgjegjësimi i qytetarëve për të qenë në një komunikim permanent me policinë, i cili ka një rëndësi të dyfishtë, do ta bëjë punën e policisë më efektive dhe do të shkojë në favor të rritjes së nivelit të sigurisë. Nga rezultatet e anketimit të kryer nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, vihet re se 36% e të gjithë të anketuarve përgjigjen se nuk kanë patur asnjëherë kontakte me policinë e shtetit; 46% përgjigjen se kontaktet e tyre me policinë janë të rralla, kurse vetëm 18% përgjigjen se kontaktojnë shpesh me Policinë e Shtetit. Këto shifra duhet ta shqetësojnë institucionin e policisë, sepse lidhen direkt me efikasitetin e punës së saj, ndryshimit të

koncepcioni të punës së saj dhe të ndryshimit të koncepcionit të publikut për policinë.

Po të shikojmë rezultatet e anketimit të kryer nga IDN-ja vihet re edhe një fakt tjetër shqetësues. Edhe pas komunikimit me policinë, 17% deklarojnë se besimi është zvogëluar dhe 80% deklarojnë se besimi ka mbetur i njëjtë ose është rritur (40% është rritur dhe 41% ka mbetur i njëjtë). Një faktor i rëndësishëm në ndryshimin e këtij perceptimi është edhe shpejtësia e përgjigjes nga ana e policisë.

Ndryshimi i imazhit të policisë dhe fitimi i besimit lidhet me dy nga figurat më të shëmtuara dhe më shqetësuese të krimeve që hasen në shoqërinë tonë; këto janë vjedhjet dhe krimi i organizuar. Fakti se 45% e të anketuarve konsiderojnë si prioritet “arrestimin e kriminelëve” kjo tregon pritshmërinë e qytetarëve ndaj policisë, por kjo përputhet edhe me vetë objektivat e policisë. Pikërisht, një përputhje e tillë mund të ndikojë në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj policisë.

Duke u ndalur vetëm në disa përfundime të studimit, qëllimi ishte që të tregonim se cilat janë prioritetet e punës së policisë në raport me qytetarët. Në këtë kontekst, media mbetet një mjet i fuqishëm që policia duhet ta shfrytëzojë në favor të fitimit të besimit të qytetarëve. Pavarësisht nga ekseset e mundshme nga ana e medias, që janë të kuptueshme në kushtet e paqëndrueshmërisë politike dhe dobësisë së shtetit të së drejtës, media mbetet një mjet shumë i rëndësishëm në komunikimin e policisë me qytetarët.

Në përfundim, do të theksonim se policia nuk duhet të harrojë, ose ajo që mbetet e pandryshuar, është respektimi i dinjitetit të personit njerëzor. Duke qëndruar në këtë konstante ajo do të dijë të fitojë besimin e qytetarëve dhe të shmangë, sa më shumë që të jetë e mundur, paqëndrueshmërinë politike dhe presionin e mundshëm të aktorëve politikë që aspirojnë pushtetin.

Prof. asoc. dr. Erlehta MATO

Drejtoreshë në Institutin e Kurrikulës dhe Standardeve

Edukimi për policinë në shkollën tonë

Lëvizjet me karakter arsimor të lidhura me jetën e përditshme po vijnë si rezultat dhe në përgjigje të ekzistencës së një boshllëku të madh që kanë këto tema në përbajtjen e kurrikulës tradicionale të edukimit qytetar dhe të studimeve të fushës sociale.

Pranimi populor i parimit “sundimi i ligjit” pa dyshim është vital për vazhdimësinë dhe prosperitetin e demokracisë sonë. Qytetarët duhet t'i kuptojnë në mënyrë të përpiktë proceset demokratike dhe të kenë dëshirën e mirë t'i përbushin ato në proceset e vendimmarrjes dhe të menaxhimit të konfliktave. Duke u fiksuar në kontratat sociale bazë të shoqërisë sonë dhe në koncepte të tillë si drejtësia, liria dhe proceset përkatëse, edukimi në përgjithësi, dhe edukimi qytetar, në veçanti, mund të kontribuojnë në mënyrë thelbësore në zhvillimin e qëndrimeve sociale dhe të dhunitive të të menduarit analistik dhe kritik, aq të nevojshme për një qytetari të përgjegjshme.

Lënda e edukimit qytetar

Edukimi fillon që në moshë të hershme; kontakti me ligjin është pjesë e tij. Kurrikula e re e edukimit qytetar përfshin si pjesë të saj në një masë të konsiderueshme edhe policinë,

ndikimin e saj në jetën e përditshme të qytetarëve. Që nga klasa e parë e deri në të nëntën do të gjemë në kurrikul tema të tilla si ligji, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e njeriut, përgjegjësitë e qytetarëve, krimi, shkelja e ligjeve dhe rregullave, qarkullimi rrugor, etj. ku roli i punonjësit të policisë apo i "xaxhi polict" zërthehet në mënyrë të përshtatshme për moshën e fëmijëve dhe realitetin ku jetojmë. Njohuritë janë njëri aspekt. Mësuesit mund të përdorin foto të veprimit të policisë në jetën e komunitetit dhe nxënësit të krijojnë në mendjen e tyre figurën virtuale të punonjësit të policisë. Ajo që ka munguar deri tani është kontakti i gjallë me njeriun e ruajtjes së rendit në komunitet; xaxhi polici që nuk është vetëm ai që del në foto me uniformë, por njeriu që mund të na mësojë shumë gjëra nga profesioni dhe përvaja e vet, që nesër të mos na duket si ai që përcjell frikën në jetën e komunitetit, por si dikush që njeh dhe ndihmon që kjo jetë të bëhet më e sigurt, më e qetë dhe më e bukur.

Instituti i Kurrikulës dhe Standardeve ka punuar që ky vizion të bëhet pjesë e kurrikulës së edukimit qytetar; në programe janë parashikuar aftësi që krijohen nëpërmjet takimeve me polici, vizita në rajonet e saj, deri te lojërat me role për situata dhe ngjarje të veçanta. Ne dëshirojmë të formojmë një qytetar aktiv, që di të komunikojë me polici, që di numrin e telefonit të saj në rast emergjence, që di të bëjë kallëzimin për një krim kundër publikut dhe që ky kallëzim të mos quhet më si spiunim apo diçka tjetër e rëndomtë, sepse shpëton jetën dhe sigurinë e komunitetit lokal, të vendit e më gjerë.

Fenomenet e reja si trafikimi i qenieve njerëzore apo i drogave janë pjesë e rrezikut me të cilin fëmijët duhet të njihen që në adoleshencën e hershme; ata duhet të njihen gjithashtu me shpëtuesit prej tyre. A do të ishte më efektiv një mësim përshkrues i mësuesit apo ardhja e një punonjësi policie në

klasë që flet për përvojën e tij në këtë drejtim, për problemet që shqetësojnë komunitetin në këto momente? Natyrisht që kjo metodë e dytë do të vepronë më qartë dhe më emocionalisht në krijimin e një tabloje reale mbi trafikimin, luftën që bëhet kundër tij dhe arsyeve pse. Një punonjës policie do të ishte më i besueshëm për nxënësit që ta shihnin fenomenin si pjesë të jetës reale dhe jo të botës virtuale që krijohet jo rrallë nën fluksin e mediave (pa iu mohuar këtyre të fundit rolin emancipues dhe ndërgjegjësues në shumë drejtime).

Duket sikur deri tanë folëm gjatë për rolin e polisë në mbështetje të shkollës dhe mbase duhet të kthehemë në tablonë ndryshe. Sa mund të mbështesë shkolla policinë? Nëse policia bëhet pjesë e procesit të edukimit, hap dyert për komunitetin jo vetëm në rast nevoje të tyre, por edhe kur ata duan të dinë më shumë për diçka që për njëqind arsyе nuk përcillet në media apo në publik, pra bëhet më transparente për veprimtarinë e saj, atëherë do të mund të krijohet besimi reciprok aq i nevojshëm për bashkëpunimin real polici-komunitet.

Sot arsimi është i hapur, gjë që nënkupton se dhe kurrikula është e hapur. Kjo pjesë e shkollës, tradicionalisht e mbyllur dhe e lënë në duart e akademikëve, sot po nis mesazhe të reja në drejtim të mësuesve dhe komunitetit. Janë me qindra materialet ndërgjegjësuese që futen në shkolla në ndihmë të nxënësve, ka më shumë liri që prindërit, komuniteti lokal, pse jo dhe institucionet e ndryshme ku përfshihet dhe policia të mund të propozojnë dhe të zgjedhin pjesë të kurrikulës si në edukimin qytetar, ashtu dhe në fusha të tjera. Një prej shembujve të këtij bashkëpunimi dhe mirëkuptimi ka qenë ai i institucionit tonë me dhjetëra organizata vendore dhe ndërkombëtare për tematika të tillë si të drejtat e njeriut,

mjedisi, edukimi mbi qarkullimin rrugor, siguria dhe mbrojtja, probleme këto që sot kanë shtrirje globale dhe ku mund të përfitojmë nga bashkëpunimi mes nesh. Parë në një këndvështrim të ri, kurrikulat e sotme janë rezultat i këtij bashkëpunimi dhe vizioni integral.

Veprimtaritë ekstrakurrikulare

Megjithatë të mësuarit për rolin e policisë, duhet të jetë pjesë integrale e se cilës kurrikul të edukimit dhe më gjërë të bëhet tematikë e rëndësishme e veprimtarive ekstrakurrikulare. Zakonisht në mes ekspertëve të kurrikulës diskutohet mjaft se kurrikula nuk mund të jetë një thes ku futet gjithçka. Vetëm 25% e dijeve që njeriu ka në moshë madhore fitohet nëpërmjet shkollimit. Pjesa tjeter fitohet nëpërmjet kanaleve të tjera të informimit dhe jetës, në veçanti.

Për këtë arsy, në planin e ri mësimor të arsimit 9-vjeçar, duke filluar nga klasa e parë deri në klasë të nëntë, janë parashikuar dy orë akademike në javë për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme jashtëmësimore, gjë që do thotë prani më e shumtë e nxënësve në komunitet dhe prani më e madhe e institucioneve në shkollë. Të drejtat e njeriut, edukimi qytetar, mjedisor, shëndetësor, rrugor, aftësimi për jetën; të gjitha tematika ku Policia e Shtetit mund të japë kontributin e saj më shumë se deri më sot. Policia e nënkuptuar jo si një rojë që qëndron te dera e shkollës, por si një pjesë e rëndësishme që kontribuojn për ruajtjen e rendit në komunitet, dhe, para së gjithash, që ndërgjegjëson nxënësit për rolin e saj dhe bashkëpunimin që duhet të ekzistojë midis vetes dhe qytetarëve pa dallim moshe, feje dhe gjinie.

Konkretnisht, do të dëshiroja të zbërtheja në detaje temat ekstrakurrikulare të rekomanduara nga IKS-ja ku ka hapësirë

për të pasur një bashkëpunim sistematik me policinë që është e shumëlojshme në shërbimet e saj. Ja disa prej tyre:

1. Edukata qytetare
2. Edukimi për të drejtat e njeriut
3. Puna e fëmijëve
4. Siguria dhe mbrojtja
5. Edukimi rrugor
6. Mbrojtja e nxënësve nga rreziqet e ndryshme dhe parandalimi i tyre
7. Edukimi për paqe dhe çarmatim
8. Trafikimi i qenieve njerëzore dhe roli i shkollës në parandalimin e tij
9. Konfliktet dhe trajtimi i tyre në mjeshteritë shkollore
10. Edukimi mjeshteror

Po të bëjmë një analizë të përqindjes që zë tematika ekstrakurrikulare që e përfshin policinë si aktor, do të pohojë se ajo shkon deri në masën 80%. Ka ardhur koha që edukimi për policinë të bëhet pjesë e edukimit ekstrakurrikular në klasa dhe semestra të caktuar, sikurse është bërë deri tanë me shembullin e edukimit mjeshteror apo edukimit rrugor. Hapësira ka, duhet më shumë planifikim dhe bashkërendim pune dhe ekspertësh.

Përgatitja dhe trajnimi i mësuesve

Materialet e shpërndara sot në shkolla në funksion të përmirësimit të cilësisë së realizimit të veprimtarive ekstrakurrikulare janë të shumta. Disa të kaluara nga filtri i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, disa nga Drejtoritë Arsimore rajonale, disa nga veta shkollat. Çfarë rezulton? Një pjesë e këtyre materialeve janë skarco, pra nuk kanë ndonjë

vlerë të veçantë, disa të tjera nuk përdoren me efektivitet nga mësuesit, të cilëve u mungon përgatitja dhe trajnimi në këto fusha. Si mund të përgatisë nxënësit për shoqërinë ku jetojmë dhe për ndryshimet që na presin një mësues, i cili nuk ka për vete njohuritë dhe aftësitë e duhura për tematika të veçanta? Deri tani është punuar me projekte të izoluara me qëllimin që në një moment të caktuar grupet e vogla të përgatitura të ekspertëve dhe të mësuesve të shërbenin për trajnime të gjera kombëtare. Një gjë e tillë nuk është realizuar në praktikën e punës. Si gjithnjë jo vetëm për faj të fondeve të dhëna për arsimin, por dhe për faj të mentalitetit të vjetruar që edukimi është vetëm pjesë e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, dhe jo e ministrive apo institucioneve të tjera. Natyrisht ky mentalitet funksionon në Shqipëri, por jo në vende të tjera, ku një pjesë e madhe e ministrive japin fonde të caktuara për programe ndërgjegjësimi dhe trajnimi të mësuesve apo komuniteteve. Urojmë që kjo të ndodhë së shpejti edhe te ne.

Edukimi qytetar, kultivimi i virtuteve, i njohurive dhe i aftësive të nevojshme për pjesëmarrje politike, ka shumë parësi morale ndaj qëllimeve të tjera të edukimit ligjor në një shoqëri demokratike. Edukimi qytetar brenda dhe jashtë mureve të shkollës përgatit qytetarë për të marrë pjesë në mënyrë të ndërgjegjshme në riprodhimin e shoqërisë sonë, dhe riprodhimi i vetëdijshëm social është ideal i jo vetëm i edukimit demokratik, por dhe i politikës demokratike. Kritika më e ashpër që ne mund t'u bëjmë shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, nuk ka të bëjë me faktin se shkollat dështojnë në misionin e tyre për t'u dhënë fëmijëve me talente të njëjtë mundësi të barabarta, për të nxjerrë të njëjtat fitime, apo për të ndjekur zanatet profesionale. Ato dështojnë në sigurimin e një arsimi të mjaftueshëm, në mënyrë që fëmijët të përfitojnë nga statusi i tyre si qytetarë.

Vendit tonë i duhen qytetarë në një masë prej 100%. Është e rëndësishme që kjo të kuptohet nga të gjithë ne dhe të na shërbejë për gjithë veprimtarinë tonë të ardhshme. Në këtë mision të ndërtimit të qytetarisë, bën pjesë dhe edukimi për policinë në shkollë.

Duke falënderuar Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim për kontributin e dhënë në mënyrë sistematike në shkolla gjatë këtyre viteve, ftoj të gjitha institucionet e tjera për hartimin e një plani të përbashkët edukimi qytetar ku policia të bëhet pjesë e ndryshimeve të jetës së shkollave, gjithnjë në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Artur Zoto
Ekspert

Parandalimi i Krimit nis në Institucionet Arsimore

Më lejoni, para së gjithash, që të shpreh falënderime të veçanta për organizuesit e këtij aktiviteti mjaft të rëndësishëm dhe të prekshëm për momentin në të cilën gjendemi. Por para se të vazhdoj referatin tim në lidhje me çështjen e parandalimit të krimit do të desha të theksoja se është fakt që besimi publik ndaj policisë është gjithnjë e më shumë duke u përmirësuar dhe mund të them me bindje se, tashmë i ka kaluar kufijtë e sfidës.

Kështu që mendoj, do të ishte më mirë të preknim çështjen e kësaj marrëdhënie brenda kontekstit të partneritetit duke dhënë dhe ndarë në këtë mënyrë përgjegjësitë midis aktorëve të përfshire në partneritet. E thënë ndryshe besimi komuniteti-polici duhet parë në një aspekt më të gjerë nga sa është partneriteti dhe më pas ta konsideronim besimin si element të marrëdhënieve ndëraktive në partneritet midis aktoreve të ndryshëm, për çështjet që kanë të bëjnë me parandalimin dhe policimin.

Megjithatë parandalimi në vetvete është një çështje shumë e gjerë. E parë jo vetëm nga konteksti policor, por më tepër nga aspekti social, them me bindje se partneriteti është element shumë i rëndësishëm i policimit bashkëkohor. Vlerësoj dhe mendoj që është shumë e rëndësishme që brenda afatit kohor

të këtij aktiviteti, është mundësuar koha e mjaftueshme për të diskutuar për rolin dhe efektivitetin e shkollave në parandalimin e krimit.

I pranishëm këtu me cilësinë e ekspertit në fushën e policisë, por edhe të një eksperience personale të përjetuar në marrëdhëni shkollë - polici do të desha të theksoja që ta shikonim këtë raport si një investim reciprok me interes për gjithë shoqërinë tonë.

Duhet të pranojmë dhe theksojmë se tashmë ka disa vite që janë vendosur raporte të ndërsjellta midis shkollave dhe policisë jo vetëm thjesht në drejtim të parandalimit, por edhe të dhënes së informacionit nxënësve për çështje që kanë të bëjnë jo vetëm me sigurinë individuale, por dhe të komunitetit. Nuk ka dyshim dhe pranohet nga të gjithë që këto marrëdhënie pa dyshim kanë impaktin e tyre në drejtim të arritjes së rezultateve në luftë kundër kriminalitetit dhe parandalimit të kimeve.

Pse është shumë e rëndësishme ekzistенca e vazhdimesisë së forcimit të këtyre marrëdhënieve? Nga pikëpamja policore do të përmendja disa arsyë që e bëjnë të domosdoshme vazhdimesinë e kësaj lidhje.

E para, është se po të shikohen të dhënat statistikore do të vihet re një numër i madh i personave që i përkasin grup-moshave 16-20 vjeç të përfshirë në aktivitete kriminale dhe shumica prej tyre nuk e kanë përfunduar arsimin e mesëm. E dyta, është që këto lloj grup-moshash dhe më gjërë duhet të kenë informacionin e nevojshëm për të identifikuar risqet dhe pasojat që do të kenë në rast përfshirje në këto risqe ose aktivitete të paligjshme.

E treta, është se policia duhet të identifikojë më mirë problemet dhe shqetësimet që shfaqen në këto grup-mosha duke mos i trajtuar ato thjesht dhe vetëm nga aspekti policor, por të kërkojë pjesëmarjen e institucioneve dhe aktorëve të

tjerë në trajtimin e tyre. Është shumë e rëndësishme që trajtimi i tyre në mënyrë të njëanshme vetëm nga policia, do të krijonte premisa për shkelje të të drejtave të këtyre të rinjve dhe do të sillte moszgjidhjen e probleme dhe imazh shumë të keq për policinë. Ka dhe shumë e shumë arsyë të tjera, por unë do të desha të ndalesha te këto tre më kryesoret.

E përmenda më lart që vij në këtë takim edhe me një eksperiencë personale të fituar në drejtim të forcimit të marrëdhënieve shkolla - polici gjatë kohës që mbaja funksionin e shefit të Komisariatit nr. 3 në Tiranë dhe them me bindje se në çdo aktivitet që patëm me të gjitha shkollat e të gjitha ciklevet gjetëm një interes nga të gjithë nxënësit për të marrë informacion në lidhje me veprimtarinë e policisë. Ky interes vinte me shumë ngaqë ishte krijuar perceptimi i gjerë se policia është një strukturë "e myllur", që të dhunon, që përdor forcën, përbush interesat e një grupi, etj.

Por aktivitetet në fjalë ju dhanë atyre jo vetëm informacionin e nevojshëm në lidhje me policinë, por krijuan dhe një imazh ndryshe në sytë e tyre për policinë. Dhe rezultati erdhi; që do të thoshte, më shumë kontakte, më shumë shkëmbim informacioni, më shumë telefonata në drejtim të komisariatit të gjitha këto të përbledhura me një fjalë më shumë, parandalim.

Pra, shembuj të tillë nga praktika mund të gjesh anembanë vendit, por ajo që kërkohet është jo vetëm përgjithësim i këtyre eksperiencave pozitive, por edhe futja e tyre si forma dhe metoda të punës së policisë.

Është shumë e rëndësishme të theksojmë dhe të kërkojmë nëpërmjet këtij takimi vazhdimësinë e forcimit të marrëdhënieve shkollë - polici duke e vlerësuar si çelësin e suksesit në drejtim të parandalimit të krimít.

Duke përfituar nga rasti se në këtë aktivitet marrin pjesë dhe përfaqësues të institucioneve arsimore do të doja që, të

dy palët të merrnin iniciativa të përbashkëta për forcimin e këtyre lidhjeve. Është shumë e rëndësishme të theksojmë se këto lloj marrëdhëniesh duhet të institucionalizohen dhe të futen në treguesit e performancës policore të çdo strukture si në nivel lokal ashtu dhe në nivel rajonal.

Tashmë kuptohet, se roli i shkollës në parandalimin e krimit është shumë i çmueshëm dhe i nevojshëm. Këtë nevojë e bëjnë të domosdoshme edhe përpjekjet e brendshme dhe të vazhdueshme që po bën policia për të arritur standardet e organizatave homologe të vendeve të BE-së.

Do të doja të përmendja se rolin e institucioneve arsimore në drejtim të parandalimit nuk duhet ta shikojmë të shkëputur nga përqafimi i filozofisë së policimit në komunitet, e cila është përcaktuar dhe në strategjinë afatgjatë të Policisë së Shtetit për vitet e ardhshme.

Pjesë e këtij kontributi është pa dyshim edhe IDN-ja së bashku me drejtuesin e saj z. Hroni.

E përmenda policimin në komunitet pasi kjo filozofi e shikon si të domosdoshëm bashkëpunimin midis aktorëve të ndryshëm dhe në veçanti me shkollat. Në fund pa u zgjatur do të doja të theksoja se shkolla është institucioni që modelon dhe projekton të ardhmen dhe nëse duam që të kemi një shoqëri me standardet më bashkëkohore duhet që të gjithë t'i kthejmë sytë nga shkolla.

Reagimi pro-aktiv ndaj problemeve dhe fenomeneve është gjithmonë më pak i kushtueshëm se ai aktiv. Do të doja që të fokusonim vëmendjen edhe në këtë aspekt, pasi jo pa qëllim organizatat më të zhvilluara policore i japin një rëndësi të veçantë parandalimit të krimeve dhe partneritetit në zgjidhjen e problemeve që në fund të fundit do të thotë më pak shpenzime dhe më shumë efektivitet në drejtim të luftës kundër fenomeneve kriminale, etj.

Më mbetet të theksoj dhe të përmend se eksperientat e suksesshme të rolit të shkollave në procesin e parandalimit, kërkojnë domosdoshmërisht jo thjesht vazhdimësinë e krijimit të këtyre eksperiencave, por institucionalizimin e tyre. Pra, jemi në fazën kur të dy palët të kërkojnë jo vetëm përfshirje, por edhe ndarje përgjegjësish dhe e konkretizuar kjo me dhënien më shumë akses shkollave në drejtim të kontrollit qytetar të veprimitarisë policore.

Ju faleminderit!

Hasan Shkëmbi

Policimi në komunitet: Arritje dhe Sfida

Në radhë të parë dua të përshëndes dhe vlerësoj organizatorët dhe mbështetësit e kësaj Konference të rëndësishme me përfaqësues të shoqërisë civile, drejtues të Ministrisë së Brendshme, autoritete të pushtetit vendor, ekspertë të misioneve të huaja policore dhe specialistë të policisë për të shkëmbyer disa pikëpamje dhe arritje konkrete rrëth këtij problemi të rëndësishëm dhe shumëdimensional të polisë.

Jam tepër i impresionuar që në diskutimet e përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe autoriteteve lokale (veçanërisht të Qarqeve Lezhë, Shkodër, etj.) të artikulohen konceptet shkencore moderne të autorëve më të dëgjuar në fushën e policimit komunitar (amerikani Radele dhe kanadezi Trojanovic etj.). Për këtë arritje mendoj se është merita e shoqërisë civile e veçanërisht e IDN-së dhe PNUD-it, të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar në drejtim të futjes së kësaj kulture dhe filozofie të re të parandalimit edhe në pikat më largëta të bashkësive vendore të vendit (Dibër, Kukës, Sarandë).

Tendencat dhe sfidat e policimit në komunitet

Dihet se policimi modern ka në themel të tij, Policimin në Komunitet, si një filozofi dhe një strategji organizative e policisë për realizimin e misionit të saj në partneritet të ngushtë me komunitetin. Është fakt se kjo filozofi policimi është bërë sot një *Sine Qua Non* e policimit demokratik në të gjitha vendet e zhvilluara, përfshirë edhe vendin tonë gjatë viteve të fundit.

Duke iu referuar përvojave botërore të policimit të vendeve euroatlantike dhe atyre të tjera me sistem demokratik vërehet se kjo filozofi është në themel të çdo plani strategjik të zhvillimit të policive qoftë afatshkurtër apo afatgjatë. Policimi në komunitet sot është jo vetëm një trend i zhvillimit, por edhe një katalizator kryesor i performancës së shërbimit policor në garantimin e parametrave optimale të sigurisë publike dhe kontrollin e territorit. Ai ka rritur së tepërmë kapacitetet e policisë dhe është bërë pjesë vitale e kësaj organizate.

Tendenca kryesore e zhvillimit të policimit modern sot (duke nënkuptuar dhe atë demokratik) është zhvendosja e qendrës së gravitacionit nga nivelet e drejtimit qendror policor drejt niveleve komanduese vendore nëpërmjet procesit të decentralizimit të organeve dhe pushtetit lokal, dhe nga ky i fundit drejt komunitetit apo publikut. Pra, vektori i policimit komunitar shkon drejt një orientimi dhe përqendrimi më të madh të përgjegjësive në rrafshin hapësinor gjeografik, d.m.th. drejt policimit të zonës apo lagjes për zgjidhjen e problemeve, parandalimin e kimeve, përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit, etj.

Nëse i referohemi praktikave moderne të policimit komunitar të vendeve euroatlantike vërejmë se ato e kanë startimin në vitet '70 - '80 të shek. XX. Në SHBA, policimi në komunitet, pas viteve 1980 ka bërë një progres

jashtëzakonisht të madh, saqë shumë studiues e quajnë “shkolla amerikane e policimit në komunitet”, por që origjinën e kanë nga përvoja e policimit britanik të shek. XIX. Sipas të dhënavë të vitit 2006, në SHBA janë rrëth 100 mijë punonjës policie (ose 10% e totalit të saj) që shërbejnë në komunitet. Megjithatë përvojat e policimit në komunitet në këto vende janë pak a shumë të ndryshme.

Megjithëse policimi komunitar është shfaqur si një zgjidhje e përshtatshme për Britaninë e Madhe për parandalimin e krimit (komitetet permanente të lidhjeve me publikun, patrullat në këmbë, etj.) për Spanjën, Holandën, Greqinë, etj., duhet thënë se në praktikat e përditshme të këtij modeli ka patur sfida dhe dështime. Kështu nëse i referohemi modelit të policisë së afërsisë ose lagjes së Francës (la police proximite) “pas krizës së periferisë” nëntor 2005 dhe mars-prillit 2006, duhet thënë se ajo ka qenë në qendër të debateve e kritikave lidhur me organizimin dhe eficencën e kësaj policie. Jo se ky lloj modeli policimi dështoi, por sipas deklaratave të autoriteteve të larta të Ministrisë së Brendshme franceze, ai kishte nevojë të ridimensionohej (duhej që policia të rritej në numër, të jetonte e punonte në gjirin e komunitetit ku do të shërbente, të forconte urat e bashkëpunimit me publikun, etj.).

Policimi komunitar dhe realiteti shqiptar

Nëse i referohemi ndryshimeve që kanë ndodhur në fushën e policisë gjatë dekadës së parë të përbysjes së sistemit totalitar (pas vitit 1990) shohim se ky koncept ishte jo shumë i përhapur dhe praktikuar nga policia që shërbente në terren. Ishte mjaftuar vetëm me ngritjen e strukturave të marrëdhënieve të policisë me publikun në strukturat qendrore të policisë dhe në Drejtoren e Policisë Tiranë.

Me ardhjen e misioneve të huaja policore në Shqipëri pas vitit 1997, filluan trajnimet e personelit të policisë programet e të cilave kishin dhe module të policimit komunitar. Këto module u futën edhe në kurrikulat e Akademisë dhe Institutit të Policisë. Megjithatë, kjo përpjekje ishte vetëm në planin teorik dhe jo në atë praktik të policimit. Ka pasur edhe përpjekje për studime e botime socio-policore të marrëdhënieve të policisë me publikun (1996), por që kanë ngelur jashtë vëmendjes së autoriteteve policore për disa vite.

Në kuadrin e reformimit të Policisë Shqiptare, me asistencën e partnereve tanë perëndimorë edhe te ne u hartua dhe filloi implementimi i Strategjisë së Policimit në Komunitet. Krahas kësaj, kurrikulat e reja të Shkollës së Policisë trajtojnë module të standardeve euroatlantike për filozofinë e policimit në komunitet. Modeli i ri i policimit që do të zbatohet në Shqipëri “Patrullë e Përgjithshme e Policisë” nëpërmjet Shkollës së Policisë, ka në themel të vet filozofinë e policimit në komunitet. Ai do të mundësojë zbatimin konkret të kësaj strategjie.

Në kuptimin metaforik do të thoshim se policimi në komunitet përbën “kapilarët e policimit në lagje”, pra është baza e sigurisë së komunitetit, parandalimit të krimít dhe zgjidhjes së problemeve të publikut në partneritet të ngushtë me të. Që të realizohet kjo strategji kërkohet që struktura e re e Policisë së Shtetit në nivel vendor t'i përshtatet filozofisë së policimit në komunitet. Kërkohet investim i fuqishëm për ngritjen e infrastrukturës policore në lagje (zyrat e policisë, teknologjia, etj.) dhe sidomos trajnim i personelit të policisë së terrenit.

Duke iu referuar përvojave perëndimore, policimi në komunitet orientohet në tre akse kryesore:

- parandalimi i krimít;

- zgjidhja e problemeve të komunitetit;
- përgjigjja ndaj telefonatave emergjente.

Në këtë trinom përgjegjësish, aksi i parë (parandalimi i krimít) është krucial në aktivitetin e policisë së komunitetit. Por veprimi parandalues vetëm i policisë nuk është i mjaftueshëm. Sot, kriminologët anojnë më shumë në aplikimin e një strategjie të re, të asaj ku shoqëria ose vetë komuniteti do të japë ndihmesën e saj në parandalimin e krimít. Në praktikë është provuar katërcipërisht se kompetencat që i jepen policisë, pajisjet, burimet dhe profesionalizmi i saj, mbeten pa efektivitet në qoftë se nuk realizohet bashkëpunimi konkret midis policisë dhe pushtetit vendor, publikut, të zgjedhurve lokalë, shkollave, të rindjeve, medias, etj. Bordet e parandalimit janë hallkat kryesore të parandalimit të krimít në nivel vendor.

Në praktikën tonë policore ndodh që policia i jep më shumë prioritet përgjigjes ndaj telefonatave të qytetarëve sesa zgjidhjes së problemeve të komunitetit. Kjo ndodh jo vetëm se përgjigjja ndaj telefonatave të qytetarëve kërkon më pak energji, kohë dhe investim, por sepse është më komode në raport me zgjidhjen e konflikteve ose incidenteve kriminale. Nuk mund të bëhet fjalë për policim në komunitet nëse nuk zgjidhen problemet që ka lagjja ose zona. Shpesh qytetaret ngelen të zhgënjer nga policia për faktin se asaj kur i kërkohet ndërhyrje nga qytetarët për zhurmat që shkaktohen nga lokalet e natës, PUB-et, buritë e makinave apo parkimet e parregullta në blloqe banimi, etj., ajo ose nuk ndërhyjn ose përgjigjet që këtë përgjegjësi e ka policia bashkiake. Qysh në këtë moment filozofia e policimit në komunitet ka dështuar. Ajo është vetëm një fasadë dhe jo realitet.

Së fundi, dua të theksoj rolin e shoqërisë civile (IDN) për implementimin e projekteve pilot të policimit në komunitet

në rrethe të ndryshme të vendit. Po ashtu, rolin që ajo ka luajtur me sugjerimet e vlefshme për ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme në projektligjin e ri të Policisë së Shtetit. Këta aktorë dhe partnerë të fuqishëm të policisë duhet të mbështeten fuqimisht për realizimin e strategjisë së policimit në komunitet.

PYETËSOR

Perceptimi i komunitetit mbi disa shërbime që ofron policia e shtetit

Ky pyetësor është përgatitur nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në kuadrin e projektit “Përmirësimi i zbatimit të ligjit në nivel vendor” financuar nga National Endowment for Democracy (NED Washington DC) dhe u realizua nga studentë të Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari” dhe të Fakultetit të Shkencave Sociale.

Ky pyetësor pati si **qëllim** matjen e perceptimit të publikut ndaj shërbimeve që ofron Policia e Shtetit, çështjeve që kanë të bëjnë me rendin, krimin e organizuar dhe parandalimin e krimtit si dhe të vlerësonë nga këndvështrimi qytetar çështjet më të rëndësishme si prioritete të pritshme të punës së policisë.

Metodologja: Për realizimin e këtij studimi janë shpërndarë rreth 900 pyetësorë ndërmjet qytetarëve të ndryshëm të qyteteve më të mëdha të Shqipërisë, ndër të cilat 270 vetëm në Tiranë. Pjesa tjeter është shpërndarë në qytetet Berat, Elbasan, Lushnjë, Durrës, Vlorë, Gjirokastër, Korçë, Shkodër dhe Lezhë ku janë plotësuar rreth 70 pyetësorë për çdo rreth. Pyetësori u realizua në periudhën korrik – gusht 2006.


Gjatë shpërndarjes së pyetësorit janë mbajtur parasysh rregullat e përzgjedhjes rastësore dhe është bërë një kategorizim demografik me tre komponentë: gjinia, mosha, arsimi me qëllim që pyetësori të ishte sa më gjithëpërfshirës dhe që rezultatet të jenë sa më përgjithësuesë. Pra, ky pyetësor u plotësua nga 52% meshkuj dhe 48% femra me qëllim që të ruhej barazia gjinore. Të anketuarit janë përzgjedhur në mënyrë të tillë që t'i përkasin në përpjesëtim të drejtë grup-moshave të ndryshme bazuar kryesisht në tre kategori:

- I. deri në 20 vjeç – **35%**
- II. 20 - 40 vjeç – **33%**
- III. mbi 40 vjeç – **32%**

Gjithashtu edhe arsimi ishte një tjetër element që ka gjetur përpjestim në numrin e të intervistuarve. Dhe konkretisht ata kanë qenë të arsimit:

- I. Tetëvjeçar dhe të mesëm – **56%**
- II. Universitar – **44%**

Pyetja 1. A keni patur kontakte me Policinë e Shtetit?



Nëpërmjet kësaj pyetje synohet njohja e gjendjes në lidhje me prezencën e policisë në komunitet si dhe një vlerësim i punës së policisë për të qenë e pranishme dhe lehtësishët e kontaktueshme nga komuniteti.


Nga rezultatet del se rreth **36%** e **totalit** të të anketuarve përgjigjen se nuk kanë pasur asnjëherë kontakte me policinë e shtetit.

Rreth **46%**, shprehen se kontaktet e tyre me policinë janë të rralla, kurse vetëm **18%** përgjigjen se kontaktojnë shpesht me Policinë e Shtetit.

Kontaktet më të pakta me policinë duket se janë në **Lushnje** ku mbi **60%** e të anketuarve shprehen se nuk kanë pasur asnjëherë kontakte me policinë, po ashtu edhe **Durrësi** me **58%**.

68% e të anketuarve në **Elbasan** dhe **58%** e të anketuarve të **Beratit** shprehen se kontaktojnë rrallë, ndërkoq që kontaktet më të shpeshta me policinë rezulton të jenë në **Shkodër** me **56.5%**. Tirana qëndron në vlerat mesatare pothuaj të barabarta me totalin.

Pyetja 2. Pas këtij kontakti besimi juaj te Policia e Shtetit është:



Vetëm **17%** e të anketuarve në **total** janë përgjigjur se besimi i tyre te policia është zvogëluar pas kontakteve me policinë. Ndërkoq kur mbi **80%** përgjigjen se besimi i tyre ka mbetur i njëjtë ose është rritur (**40%** është rritur – **41%** ka mbetur i njëjtë).


Gjetjet në total favorizojnë nevojen e rritjes së kontakteve të policisë me qytetarët për rritjen e besueshmërisë dhe bashkëpunimit. Gjithsesi problematika duhet parë edhe sipas

qyteteve, dallon **Shkodra** ku **63%** shprehen se besimi i tyre te policia është rritur dhe **Elbasani** me **57%** në raport me **Korçën** dhe **Gjirokastrën** ku vetëm **18%** kanë këtë mendim (kur **34%** në Korçë dhe **47%** në Gjirokastër shprehen se besimi te policia është zvogëluar). Ulja e besimit pas kontakteve të qytetarëve me policinë në këto dy vende, duhet parë nga këndvështrimi i etikës, profesionalizmit në shërbim, gatishmërisë për të shërbyer apo për t'iu gjendur qytetarëve për zgjidhjen e problemeve, si dhe çështje të korruptionit.

Ulja e shkallës së besimit duhet parë edhe në këndvështrimin se rezultatet e larta të një strukture, (drejtori apo komisariat policie) në luftën kundër krimit të organizuar, etj., janë më pak të rëndësishme për qytetarët, sesa kontaktet e thjeshta me punonjësin e policisë gjatë marrjes së një pasaporte ose sjellja e punonjësit të policisë rrugore gjatë një kontrolli, etj.

Pra, kontaktet e përditshme me komunitetin duket se kanë një rëndësi të veçantë dhe ndikojnë drejtpërdrejt në besimin e publikut te policia.

Pyetja 3. Cfarë duhet të bëjë policia më shumë për të përmirësuar besimin në publik?



Nga përgjigjet e kësaj pyetje vihet re se shqetësimi më i madh i komunitetit është *arrestimi i kriminelëve* (me **45%** të

totalit), më pas me një vlerë të konsiderueshme (**mbi 35%**) kërkojnë nga policia të punojë më shumë me komunitetin.

Të anketuarit i shqetëson fakti që një numër i madh kriminelësh, të identifikuar si të tillë apo edhe të dënuar nga organet e gjyqësorit, vazhdojnë të jenë të lirë madje shpesh shihen edhe në ambiente publike. Sipas të anketuarve *arrestimi i kriminelëve* është një nga shqetësimet kryesore në **Shkodër** me **80%**, **Korçë** me **73%** dhe **Lushnjë** me **62%**, ndërsa duket më pak shqetësues në **Gjirokastër** me **22%**, **Lezhë** me **24%** apo edhe **Elbasan** me **29%**.

Shifra prej rreth **36%** e **totalit** të të anketuarve që kërkojnë punë më të madhe të policisë me *komunitetin* është tregues i rritjes së interesit dhe ndërgjegjësimit të komunitetit për të qenë jo vetëm një përfitues pasiv i shërbimeve të policisë, por edhe kontribues direkt në ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike dhe sidomos në parandalimin e krimtit. Komuniteti është pozitiv për kontaktet me policinë.

Vihet re se **32%** e të anketuarve kërkojnë nga Policia e Shtetit të luftojë korruptionin. Përqindjet ndryshojnë nga rrathi në rreth; kështu p.sh. nëse në **Gjirokastër** vetëm **14%** e të anketuarve i shqetëson ky fenomen, në **Shkodër** kjo shifër është **56,5%**.

26.5% e të anketuarve janë të mendimit se duhet përmirësuar puna e punonjësve të policisë në zonë, PPZ (inspektorët e rendit). Vihen re diferencat në përgjigjet e kësaj pyetje mes **Korçës** dhe **Shkodrës** me rreth **55%**, dhe **Vlorës** me vetëm **2.9%**, **Lezhës** me **12%** apo dhe **Elbasanit** me **13.7%**.


Sektori i policisë së rendit dhe sigurisë publike është struktura që ka më shumë kontakte me komunitetin sidomos nëpërmjet inspektorëve në zona (shpesh i quajtur “i plotfuqishmi” sipas emrit në strukturën e policisë të para viteve ’90). Fakti që pothuaj 1/3 e totalit të të anketuarve mendojnë

se puna në këtë sektor duhet përmirësuar tregon se kjo hallkë e policisë perceptohet si e rëndësishme nga komuniteti pikërisht sepse PPZ janë ata punonjës që janë në kontakt të përditshëm me banorët.

Krahasuar me rezultatet e një anketimi të vitit të kaluar ku vetëm **28%** e të anketuarve e njihnin punonjësin e policisë të zonës, duket qartë nevoja për një rikonceptim të punës së inspektorëve të rendit për të rritur iniciativën e tyre në kontaktet e drejtpërdrejta me qytetarët e zonës së policimit.

Vetëm **17%** e totalit të të anketuarve janë të mendimit se policia duhet të jetë *më e shpejtë* në përgjigje. Vlerat nuk janë të njëjtë në të gjitha rrethet. Përashtim bëjnë rrethet e **Elbasanit** me **1.9%**, **Lushnjës** me **4.2%** apo **Beratit** me **10%**. Ndërkoçi që **63%** e të anketuarve në Shkodër, janë të mendimit se policia duhet të jetë më e shpejtë në përgjigje. Megjithatë nëse flasim për rritje të besimit të publikut te policia, është më e rëndësishme ajo çfarë bën policia pasi arrin në vendin e ngjarjes, shpejtësia dhe mënyra e zgjidhjes së çështjeve të ndryshme.

Pyetja 4. A mendoni se punonjësi i policisë mund të aktivizohet në programin edukativo-mësimor në shkolla?




Në përgjigjet e kësaj pyetjeje rezultatet e pyetësorit tregojnë se rreth **80%** e totalit të të anketuarve janë të mendimit se punonjësit e policisë duhet të aktivizohen në programin edukativ në shkolla. Pra, kemi të bëjmë me një mendim pothuajse unanim në lidhje me mënyrën e bashkëpunimit polici - shkollë, i cili nuk shikohet vetëm dhe thjesht në aspektin e sigurisë fizike në shkolla, por i jepet rëndësi përfshirjes së policisë edhe në procesin mësimor-edukativ. Megjithatë, vihen re diferencat mes qytetarëve të **Elbasanit**, ku **90%** janë pro pjesëmarrjes së policisë në programin mësimor dhe **Gjirokastër** me **38.8%** dhe **Lushnjës** me **35.4%**, që kanë mendim të kundërt.

Pyetja 5. A mendoni se policia dhe institucione të tjera të zbatimit të ligjit duhet të përfshijnë në veprimtari parandaluese nxënësit e shkollave?

PYETJA 5

A mendoni se Policia dhe institucione të tjera të zbatimit të ligjit duhet të përfshijnë në veprimtari parandaluese nxënësit e shkollave?



Kur flitet për veprimtari parandaluese në institucionet arsimore duhen pasur parasysh dy aspekte:


1. Veprimtari që synojnë parandalimin e dukurive dhe kimeve specifike të moshës në ambientet e shkollave dhe ambientet e tjera që frekuenton kjo moshë.

2. Veprimtari të fokusuar në edukimin ligjor si dhe me rregullat e bashkëjetesës në komunitet të këtyre grup-moshave

me qëllim rritjen e një brezi të përgjegjshëm dhe që ndikon në parandalimin afatgjatë të krimit.

Nga rezultatet e pyetësorit del se mbi **83%** e të anketuarve e vlerëson si të domosdoshëm përfshirjen e policisë dhe institucioneve të tjera të zbatimit të ligjit, si prokuroria, gjykatat, etj. në organizimin e veprimtarive parandaluese. **Durrësi** me **94.3%**, **Shkodra** dhe **Vlora** me **93%** dhe **Korça** me **91%** kanë përqindjen më të madhe të të anketuarve që i përgjigjen pozitivisht kësaj pyetjeje. Ndërkokë që vihet re se **39.6%** e të anketuarve në **Lushnjë** dhe **34.7%** në **Gjirokastër** mendojnë se policia nuk duhet të përfshihet në veprimtari parandaluese.

Pyetja 6. Sa i kënaqur jeni me përpjekjet e policisë në lidhje me krimet në rrugë?




Vetëm **9%** e totalit të të anketuarve shprehen se janë *të kënaqur* me punën e policisë në këtë drejtim, dallohet **Lushnja** me **18.8%**.

Ndërkokë **46%** janë *disi të kënaqur*, vlerat më të larta janë në **Shkodër** me **78.3%**, **Durrësi** me **70%** dhe **Elbasani** me **62.8%**.

30.3% e totalit të të anketuarve shprehen se janë *të pakënaqur*. Kjo shifër arrin në **48.6%** për **Vlorën** dhe **44.9%** për **Gjirokastrën**.


Vihet re se **14.5% e totalit** shprehen se nuk kanë *asnje mendim* në lidhje me këtë çështje ku dallohen përgjigjet e dhëna nga të anketuarit në **Lezhë** me **30%**, **Vlorë** me **22.8%** dhe **Gjirokastër** me **22.4%**.

Pyetja 7. Sa i kënaqur jeni me përpjekjet e policisë në lidhje me kapjen e autorëve të vjedhjeve?



Vihet re se edhe përgjigjet e kësaj pyetjeje kanë pothuaj të njëjtat vlera në përqindje si dhe pyetja paraardhëse. Vetëm **10%** e të anketuarve shprehen se janë të kënaqur me punën e policisë për ndalimin dhe arrestimin e autorëve të vjedhjeve të ndryshme. Ndërkohë që **47%** janë disi të kënaqur dhe **30%** janë të pakënaqur.

Pyetja 8. Sa i kënaqur jeni me përpjekjet e policisë në lidhje me luftën ndaj krimít të organizuar?



Vetëm **10%** e të anketuarve përgjigjen se janë *të kënaqur* nga përpjekjet e policisë në lidhje me luftën ndaj krimit të organizuar, bën përjashtim **Elbasani** ku **47%** shprehen se janë *të kënaqur*.


Ndërkojë që **39%** janë *disi të kënaqur*. Dallon **Durrësi** me **70%** dhe **Shkodra** me **63%**

27% e të anketuarve shprehen se janë *të pakënaqur* nga lufta e policisë ndaj krimit të organizuar. Rreth **50%** e të anketuarve në **Korçë**, **Vlorë** dhe **Gjirokastër** janë shprehur se janë *të pakënaqur*.

Edhe në këtë pyetje vihet re se **23.4%** e totalit nuk shprehin *asnjë mendim*.

Megjithëse krimi i organizuar në dukje nuk prek direkt qetësinë, rendin dhe sigurinë publike, ai perceptohet nga komuniteti po aq i dëmshëm sa dhe krimi ordiner që prek direkt interesat e çdo qytetari. Kështu edhe në këtë rast të anketuarit shprehen vlerësues për përpjekjet që po bëhen për të luftuar krimin e organizuar duke u cilësuar në masën **39%** si *disi të pakënaqur* nga puna e policisë kundër krimit të organizuar.

Pyetja 9. Sa i kënaqur jeni me përpjekjet e policisë në lidhje me parandalimin e krimit në lagjen tuaj?




Nga rezultatet e pyetësorit del se vetëm **11%** e të anketuarve janë *të kënaqur* nga puna e policisë në drejtim të parandalimit të krimtit, dallohet **Elbasani** me **39%** të kënaqur, ndërkokës që në **Vlorë**asnë i anketuar nuk shprehet se është i kënaqur, po ashtu dhe në **Lushnjë** e **Shkodër** me **2 - 4%**.


45% e **totalit** të të anketuarve shprehen se janë *disi* të kënaqur me përqindje të përafërtë në të gjitha rrethet me përjashtim të **Shkodrës** ku shifra është **71.7%**.

31.6% shprehen *të pakënaqur* nga puna e policisë për parandalimin e krimtit. Kjo shifër arrin në **51%** në **Gjirokastër**.

Pyetja 10. Sa i kënaqur jeni me punën që bën policia për zbatimin e ligjit në lagjen tuaj?



Pyetja 11. Sa i kënaqur jeni ju me punën që bën Policia për të njohur dhe zgjidhur shqetësimet në lidhje me rendin dhe sigurinë në lagjen tuaj?



Përgjigjet ndaj këtyre dy pyetjeve janë pothuajse të njëjtë, prandaj po i përgjithësojmë në shifra.

Megjithëse në pamje të parë pyetjet mund të vlerësohen si të njëjta, ato ndryshojnë në filozofinë e policimit. Pyetja e parë ka të bëjë me një qëndrim ndaj detyrimit ligjor të policisë për zbatimin e ligjit, ndërsa e dyta lidhet drejtpërsëdrejti me filozofinë e policimit në komunitet si praktikë policore.

Te përgjigjet e të dyja këtyre pyetjeve vihet re se më pak se **10%** e të anketuarve shprehen se janë *të kënaqur*.

Rreth **45% disi të kënaqur**. Mbi **30% të pakënaqur** ku Lushnja, Vlora, Gjirokastra dhe Korça kanë përqindjen mes **45-55%**.

Në rezultatet e përgjigjeve të pyetjeve 10 dhe 11 vihet re se kemi një rritje të numrit të të anketuarve që refuzojnë të japid një përgjigje të qartë (që shprehen se nuk kanë *asnje mendim*), rreth **15% të totalit** deri në **40% të anketuarit në Vlorë**. Kjo mund të jetë shprehje e një besimi të ulët në punën e policisë, e reflektuar në mungesën e interesit nga komuniteti. Shpesh ndeshim komente që shprehin një interes të vogël të qytetarëve ndaj çështjeve të punës së policisë në lidhje me rendin dhe qetësinë publike. Qytetarët kanë prirjen të mos konsiderohën pjesë e punës dhe e përpjekjeve pér zbatimin e ligjit në komunitetet/lagjet ku banojnë, mjafton të mos kenë “punë” me policinë ose të mos jenë vetë subjekte/viktima të një ngjarje. Ky fakt, përvèç mungesës së një fryme komunitare nga ana e popullatës, mund të jetë edhe shprehje e një pune të dobët e policisë jo vetëm pér të rritur rezultatet konkrete dhe pozitive të punës së vet, por edhe në drejtim të sensibilizimit të komunitetit pér të dhënë kontribut si dhe pér të marrë përgjegjësitë e veta në drejtim të luftës ndaj krimít, por sidomos parandalimin e tij.

Problematika e përgjithësuar e pyetësorit:

Anketimi në thelb synonte të vlerësonte nga këndvështrimi qytetar çështjet më të rëndësishme si prioritete të pritshme të punës së policisë. Në analizë të përgjithshme të rezultateve të pyetësorit vlen të vihet në dukje kjo problematikë:

- Kontakti i policisë me qytetarët është rastësor; nuk ekziston një formë e institucionalizuar për të rritur takimet e drejtpërdrejta të policisë me qytetarët, të cilat sipas pyetjes së dytë ndikojnë ndjeshëm pozitivisht në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj policisë, dhe rrjedhimisht edhe bashkëpunimit midis tyre. Duhet shënuar me kujdes se në disa rrethe ka probleme thelbësore në komunikimin polici-qytetar. Për shembull 47% e të anketuarve në Gjirokastër dhe 34% në Korçë shprehen se pas kontakteve të tyre, besimi i tyre te policia është ulur.
- Në përgjigje të pyetjes së tretë se “Çfarë duhet të bëjë më mirë policia për të fituar besimin e publikut”, nga një analizë e hollësishme e përgjigjeve duket qartë se qytetarët janë në gjendje të vlerësojnë më drejt prioritetet e punës së policisë sesa drejtuesit e institucioneve policore. Për shembull, 45% e të anketuarve në rang vendi quajnë prioritet “arrestimin e kriminelëve” dhe kjo përputhet me objektivin e policisë. Ndërsa, në vend të dytë, 35% e qytetarëve vlerësojnë se policia duhet “të punojë më shumë me komunitetin” dhe ky është një prioritet që flet për nevojën e punës parandaluese. Ky objektiv qytetar është shumë më i avancuar, por edhe larg punës reale të institucionit të Policisë së Shtetit për të parandaluar.
- Pyetjet 4 dhe 5 evidentojnë ndjeshëm mbështetjen e qytetarëve (në masën mbi 80%) të një bashkëpunimi të institucioneve të zbatimit të ligjit, në këtë rast të policisë, me institucionet arsimore. Mbështetja spektakolare e

- publikut për bashkëpunimin mes shkollës me policinë në procesin mësimor dhe edukativ, kurrikular dhe ekstrakurrikular, është një motivim i mjaftueshëm për Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të nënshkruajnë një memorandum bashkëpunimi për t'u shtrirë në mënyrë të decentralizuar në çdo rreth të vendit, duke institucionalizuar bashkëpunimin në nivel komisariati dhe drejtore arsimore.
- Puna e policisë për të luftuar krimin dhe vjedhjet në komunitet, në lagje e rrugë është vlerësuar pozitivisht vetëm nga 10% e të anketuarve, dhe negativisht nga 30% e të anketuarve. Edhe shifra e konsiderueshme prej 46% si disi e kënaqur duhet të shërbejë si shtysë për menaxhuesit e policisë për të nxjerrë rekomandime në këtë drejtim. Përgjithësisht, këto figura krimi në dukje të vogla shpesh nuk evidentohen si krime statistikore, gjë që e shndërron krimin “e vogël” jashtë çdo vëmendjeje të autoriteteve policore.
 - Perceptim më optimist vlerësohet puna e policisë kundër krimit të organizuar në mënyrë të veçantë në disa zona si Durrës, Shkodër, Lezhë, Elbasan, Tiranë, etj. Ndërsa bie në sy shifra shumë e lartë e të pakënaqurve në Vlorë, Korçë dhe Gjirokastër.
 - Puna parandaluese në komunitet e policisë nuk vlerësohet si pozitive afërsisht nga gjysma e të anketuarve (pyetja 9). Po kështu edhe në pyetjet 10 dhe 11, 30% e të anketuarve janë të pakënaqur me punën e policisë për zbatimin e ligjit në nivel komunitar si kundër edhe për zgjidhjen e problemeve në komunitet. (në Lushnjë, Gjirokastër, Vlorë dhe Korçë shifrat shkojnë deri 45-55% të të pakënaqurve) Në një vlerësim përgjithësues, duket ndjeshëm se puna në komunitet lë shumë për të dëshiruar. Qëndrimi aktiv parandalues i policisë është larg të qenit një praktikë pune.

Ky anketim shpresojmë të diskutohet nga strukturat e policisë në nivel qendror dhe vendor duke përcaktuar detyrat përkatëse, si në rang kombëtar ashtu edhe në nivel drejtorie të policisë së qarkut.

Kryekomisar Albert Dervishi
Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit
Analizës Studimeve Strategjike

Vizioni i Policisë së Shtetit

- “Së bashku për një komunitet më të sigurt”.
- Synimi strategjik afatgjatë i organizatës së Policisë së Shtetit është krijimi i një mjedisi sa më të sigurt për shoqërinë shqiptare, i cili do të sjellë përmirësim në cilësinë e jetës së qytetarëve, duke e bërë Shqipërinë një vend të dëshirueshëm, për të punuar e jetuar.
- Krijimi i këtij vizioni, është i lidhur me zbatimin e filozofisë së Policitit në Komunitet, si dhe zhvendosjes më pas drejt Sigurisë Publike.

Partneriteti

- Për realizimin e këtij partneriteti, Policia e Shtetit bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe sidomos me OJF-të, me të cilat e konsideron veten partnere.

- Edhe me IDN-në, në këtë bashkëpunim, ashtu si edhe me mjaft organizata të tjera, në bazë është partneriteti.
- Qëllimi është reformimi, demokratizimi dhe konsolidimi i organizatës policore, si një shërbim në dobi të publikut.

Konkluzione të përgjithshme

- Domosdoshmëria për të rritur bashkëpunimin e Policisë së Shtetit me publikun.
- Përputhje e prioriteteve të policisë me kërkesat e publikut.
- Mbështetje për punën e policisë për bashkëpunimin në shkolla dhe thellimin e tij në të ardhmen.
- Kërkohet efektivitet i punës së policisë, për evidentimin e goditjen e vjedhjeve “të vogla”.
- Vlerësim pozitiv të punës së policisë në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar.
- Puna parandaluese e policisë duhet të gjejë forma të reja për zgjidhjen e problemeve të komunitetit.
- Rritje e mbështetjes dhe opinionit pozitiv për policinë, mbas anketimit të parë, kryer në pranverën e vitit 2005.

Treguesit e punës së Policisë së Shtetit 2006

- Deri tani janë kryer 8750 krime, zbuluar 6846, ose 78.2%. Rritje e zbulimit 8%.
- Janë arrestuar bandat më të rrezikshme kriminale. Në total rrëth 150 grupe kriminale të arrestuar.
- Kanë ndodhur 85 vrasje, zbuluar 73, ose 86%. 46 vrasje më pak se në vitin 2005.
- Janë kapur 1649 persona në kërkim, ose 664 më tepër se në vitin 2005, nga të cilët 130 për vrasje.
- Sekuestruar rrëth 120 kg heroinë, 4 kg kokainë, 6.753 kg marijuanë/hashish, etj.

- Asgjësuar 74.052 bimë narkotike. Bashkëpunimi me pushtetin vendor.
- Luftë kundër korruptionit dhe trafiqeve.
- Janë kryer 171 veprime proceduriale nga Interpol Tirana, nga 112 vitin e kaluar.

Prioritetet e Policisë së Shtetit

- Lufta kundër krimit të organizuar dhe atij serioz.
- Menaxhimi i Integruar i Kufijeve.
- Ndërtimi i Partneritetit.
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve ndaj publikut.
- Policim i udhëhequr nga inteligjenca.
- Reduktim i mëtejshëm i krimit dhe i sjelljes antishoqërore.
- Siguria rrugore.
- Menaxhim i organizatës policore, me të gjitha burimet e saj.

Refleksione

- Bazuar në prioritetet e policisë dhe disa anketime të kryera nga OJF të ndryshme.
- Me synim studimin e opinionit publik dhe përcaktimin e masave për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj komunitetit.
- Me urdhër shërbimi, çdo fund viti, do të realizohet anketim nga organizata policore.
- Anketimi, përveç analizave të punës, do të jetë bazë për vlerësimin dhe përcaktimin e prioriteteve vjetore të policisë, në përpunhje me Strategjinë 10-vjeçare të Policisë së Shtetit.
- Anketimi që do të bëjmë, nuk zbeh, ndalon apo mbyll mundësitë që çdo OJF, etj., të zhvillojë në të ardhmen anketime të tjera.

Metodologjia që do të përdoret

- Për herë të parë, bëhet një anketim i plotë, nga vetë organizata policore.
- Do të anketohen 2000 persona.
- Përfshihen tri brezat e shoqërisë, Grupet e Interesit, shkollat, etj.
- Përkatësia gjinore: 50% femra, 50% meshkuj.
- Shtrirja në të gjithë vendin: 70% në qytet, 30% në zonat rurale.
- Janë përgatitur 25 pyetje intervistuese, nga 11 pyetje të anketimit të kryer në bashkëpunim me IDN-në.
- Rezultatet për drejtuesit e policisë, do të prezantohen në muajin janar.

Seminari Kombëtar: Parandalimi i Krimit – Sfidë e Shoqërisë

Qëllimi i këtij seminari ishte diskutimi i përgjegjësive të përbashkëta të aktorëve pjesëmarrës në këtë aktivitet, përcaktimi i drejtimeve kryesore të bashkëpunimit në hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe planeve konkrete me qëllim parandalimin dhe luftën ndaj krimit si dhe rritjen e parametrave të rendit dhe sigurisë publike në vendin tonë.

Në këtë aktivitet morën pjesë zoti Gjergj Lezhja, zëvendësministër i Brendshëm, zoti Jemin Gjana, ministër i Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, zoti Florian Mima, zëvendësministër i Financave, zonja Marjeta Zaçe, zëvendësministre e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, zoti Bajram Ibraj, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, përfaqësues të misioneve PAMECA, ICITAP, OSBE, përfaqësues nga zyra e presidentit, anëtarë të Komisionit parlamentar të Sigurisë Kombëtare, prefektët e qarqeve, drejtorët e drejtorive të policisë në qarqe, përfaqësues të prokurorive dhe gjykatave, të drejtorive arsimore rajonale, të shoqërisë civile, medias, etj.

Parandalimi i krimit përbën një nga çështjet dhe detyrimet më të rëndësishme për një shoqëri demokratike dhe të civilizuar. Organet e specializuara që kanë detyrimin ligjor për parandalimin e krimit nuk mund të jenë të

suksesshme në përmbushjen e këtij detyrimi pa angazhimin dhe përfshirjen e gjithë institucioneve të tjera shtetërore dhe të zgjedhura si dhe shoqërisë në përgjithësi. Hartimi dhe zbatimi i strategjive dhe politikave për parandalimin e krimit, kërkon mbi të gjitha një bashkëpunim dhe bashkërendim të të gjitha strukturave të shtetit dhe të shoqërisë, në mënyrë të veçantë të policisë dhe organeve të tjera të mbrojtjes së ligjit, me organet e pushtetit vendor dhe institucionet e ndryshme shtetërore dhe civile.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, IDN-ja, ka iniciuar hartimin e një projektligji për krijimin e *Komiteteve për parandalimin e krimit* që në nivel vendor drejtohen nga prefekti dhe ku përfshihen drejtori i Policisë së Qarkut, kryetari i Këshillit të Qarkut, kryetarët dhe përfaqësues të bashkive, prokurori i rrëthit, Drejtortë Arsimore, Dhoma e Tregtisë dhe aktorë të tjerë vendorë. Bashkëpunimi i gjithë institucioneve në planifikimin dhe marrjen e masave konkrete për parandalimin e krimit është qëllimi kryesor i këtyre komiteteve.

Gjatë dy muajve të fundit në bashkëpunim me prefektët janë organizuar takime në 10 qarqe. Këto takime janë mbështetur edhe në Ligjin për Prefektin (neni 10 dhe 21) dhe kanë pasur formatin e komiteteve vendore të parandalimit të krimit. Në të gjitha takimet e realizuara, vullneti i të gjithë aktorëve publikë dhe jo publikë ka qenë mjaft mbështetës. Mbështetja që prefektët e qarqeve i kanë dhënë nismës së IDN-së dhe iniciativa konkrete e tyre për institucionalizimin e **Komitetit të Parandalimit të Krimtit** si dhe pozicioni i tyre ligjor për të nxitur, koordinuar dhe monitoruar procesin e parandalimit të krimtit në nivel vendor, është mjaft inkurajuese.

Sotiraq Hroni

Për një klimë më të shëndetshme sigurie dhe investim institucional për parandalimin e krimit

Seminari kombëtar “Parandalim i Krimit – Sfidë e Shoqërisë” erdhi pas institucionalizimit me vullnetin e plotë të aktorëve vendorë pjesëmarrës edhe në këtë takim, të Komiteteve Vendore të Parandalimit të Krimit, aktivitete që kanë përfshirë të 12 Prefekturat e Qarqeve në të gjithë vendin. Ai është edhe rezultat i një pune koordinuese dhe sensibilizuese për një kohë jo të shkurtër, me zyrat e autoriteteve më të larta të vendit dhe komisionet respektive të Kuvendit të Shqipërisë.

Aktiviteti erdhi në kohën e duhur dhe në përputhje të plotë me prioritetet e qeverisë për të siguruar vendosjen e ligjit dhe rritjen e sigurisë publike në të gjithë vendin si një nga sfidat prioritare të shoqërisë për të merituar një vend të respektueshëm në integrimet euroatlantike. Ky seminar kombëtar pati objektiv rritjen e përgjegjshmërisë së institucioneve në nivel qendror dhe vendor për mirëkoordinim, për marrje dhe ndarje përgjegjësisht institucionale për një klimë më të shëndetshme sigurie dhe investim për parandalimin e krimit.

Nisma e kahershme e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me Drejtoren e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Ministrinë e Brendshme për projektligjin për “Krijimin dhe Funksionimin e Komiteteve

Bashkërenduese për Parandalimin e Krimit” në nivel kombëtar dhe vendor, vjen njëkohësisht pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, e cila mund të përkthehet si moment përmbyllës i etapës së gjatë të tranzicionit jo të lehtë të vendit tonë në demokraci.

Vendi ynë dhe shoqëria jonë, në vend apo krahas komiteteve ekzistuese, të ketë edhe këtë strukturë koordinuese kombëtare dhe vendore për parandalimin e krimit në çfarëdolloj forme që ai është apo mund të shfaqet, sot apo në të ardhmen, pra, kundër drogës, kundër kultivimit të bimëve narkotike cannabis sativa, kundër trafiqeve përfshirë ato të qenieve njerëzore apo parave të pista, kundër gjakmarrjes apo hakmarrjes, kundër dhunës ndaj fëmijëve, dhunës ndaj gruas, krimit në familje, vjedhjes së banesave, vetëvrasjeve e çdo figurë tjetër krimi. Do të ishte një luks ekzistenca e komiteteve të veçanta për çdo figurë krimi, sikundër natyrshëm, do të shoqërohej me një simbolikë negative për të gjithë vendin. Për më tepër shumë figura të krimit të lartpërmendura kanë një shtrirje kohore apo territoriale të kufizuar.

Nga ana tjetër, strukturat e posaçme për parandalimin e krimtit, siç mund të janë këto komitete, janë detyrim i një shoqërie të civilizuar dhe demokratike për të rritur përgjegjshmërinë e çdo institucioni dhe për të vendosur partneritete jashtë institucionale në drejtim të investimit mbarëshoqëror dhe institucional për parandalimin e krimtit.

Investimi institucional apo shoqëror drejt parandalimit të krimtit nuk është një punë e lehtë, dhe as afatshkurtër, ajo është një sipërmarrje për të eliminuar shkaqet apo burimet e dukurive kriminale, që shpesh kanë natyrë ekonomike, sociale, arsimore e kulturore, të së shkuarës, por edhe të tranzacionit. Fuqizimi i shtetit ligjor dhe zbatimit i ligjit ka ardhur koha të shoqërohet edhe me një punë edukative e ndërgjegjësuese qytetare për respektimin e ligjit dhe të jetës komunitare.

Projektligi në fjalë, përveç të tjera shembullit e vetme ligjore për implementimin e Strategjisë Kombëtare të Policimit në Komunitet, dokument ky bashkëkohor i policimit që me sa duket pritet për t'u miratuar nga Qeveria Shqiptare.

Gjergj Lezhja
Zëvendësministër i Brendshëm

Janë të pakta ato subjekte që ngjallin aq interes sa lufta kundër krimtit të organizuar dhe korruptionit, të cilësuara pothuajse unanimisht, me të drejtë, si një ndër shqetësimet madhore të qytetarëve, pengesë kryesore e zhvillimit ekonomik të vendit dhe integrimit tonë në Komunitetin Evropian. Ndaj gjej rastin të falënderoj organizatorët për organizimin e këtij seminari, i cili jam i bindur se do të hedhë një hap konkret në atë për të cilën në të gjithë jemi të angazhuar: parandalimin e krimtit dhe luftën ndaj të gjitha llojeve të shfaqjes së tij.

“Është më mirë të parandalosh se të kurosh”. Këtë maksimë të njojur të mjekësisë do doja ta perifrazoja në rastin tonë me: “Është mirë të parandalosh, duke luftuar dhe bashkëpunuar”.

Lufta kundër krimtit mbetet një problem shqetësues për shoqërinë tonë. E dinim një gjë të tillë që kur populli na besoi qeverisjen me votën e tij. Por ishim e jemi akoma më shumë të vendosur për të goditur me ashpërsinë e ligjit të gjithë elementët kriminalë që paratë e fituara nga kamionët e drogës kanë shndërruar në tulla e “bojë të pastër” pallatesh. Të gjithë ata që trafikun e qenieve njerëzore dhe emigracionin ilegal e kanë shndërruar në agjenci udhëtimi me emra ekzotikë. Të gjithë ata që kujtuan se bregdetin e kanë parajsën e tyre, e mundësishët të shoqëruar me llogari shumëzeroshe në kontot bankare.

Me keqardhje dua të them se ka ende nga ata përpilen të bëjnë “akrobaci” me punën e forcave të rendit. Ka ende nga ata që prangosjen e milionerëve trafikantë e konsiderojnë si dëmtim të ekonomisë së brishtë shqiptare, ka ende nga ata që kërkojnë nga të zgjedhurit vendorë të mbyllin sytë para

parcelave të mbjella me kanabis. Po ashtu ka ende nga ata që vazhdojnë ta shohin krimin dhe korruptionin sipas ngjyrave. A është blu apo i kuq?

Jo me vonë se dje, një gazetare më pyeti në lidhje me të arrestuarit e Velipojës, se të kujt partie ishin të zgjedhur. Besoj se deri tani ne i jemi përgjigjur me fakte konkrete kësaj pyetjeje. Shkelësit e ligjit nuk i përkasin asnjë partie, të paktën për ne. Nuk do t'i marrim në mbrojtje siç mund të bëjë ndonjë tjetër, përkundrazi. Ndaj siç e thashë më sipër, për ne si institucion, organizimi i aktiviteteve të tilla është shumë i rëndësishëm për atë çka të gjithë ne kemi marrë përsipër. Ministria e Brendshme ka qenë dhe është e gatshme të bashkëpunojë me të gjithë aktorët që kanë role protagonistësh në luftën kundër krimít; organet e tjera të mbrojtjes së ligjit, pushtetit vendor, organizmat e huaja dhe institucioneve të ndryshme shtetërore apo civile.

Lufta kundër krimít është dhe mbetet një objektiv parësor i quverisë dhe natyrisht i Ministrisë së Brendshme. Grupe të strukturuara kriminale kanë marrë goditje vdekjeprurëse dhe e njëjtë gjë mund të thuhet edhe për trafikantët e qenieve njerëzore e ato të drogës. Lidhur me këtë, do doja të thosha se vetëm muajt e fundit janë sekuestruar 82 kilogram heroinë që përbën trefishin e të njëjtës sasi të sekuestruar një vit më parë dhe janë vënë nën pranga 277 persona ose dy herë më shumë se një vit më parë. Operacione të suksesshme të policisë kanë ndërprerë aktivitetin e një sërë kryetarësh e anëtarësh të bandave famëkeqe kriminale, ndërkohë që forca e ligjit po merr një kontur të ri: atë që ligji është një dhe i barabartë për të gjithë.

Arritje ka patur, por për ne, ashtu dhe besoj për të gjithë ju, ato nuk janë të mjafta sepse nga ne kërkohet gjithnjë e më shumë. Sidoqoftë, kjo jo vetëm nuk na bën të stepemi, por na motivon akoma më shumë.

Besoj se tashmë vihet re nga të gjithë se një erë e re po fryn për rendin në Shqipëri. Duke filluar nga shefi më i lartë e deri te polici më i thjeshtë, të gjithë besoj se po impenjohen në maksimum për të realizuar detyrat e tyre. Tani mbrojtësi i rendit dhe qetësisë publike nuk heziton më të ndalojë kriminelin nga frika se të nesërmen do ta shohë atë sërisht duke lëvizur lirisht. Shefi i tij nuk ka më frikë se i ikën vendi i punës po të arrestojë ndonjë eksponent të krimit që i tund para fytyrës jo vetëm miqësinë, por edhe kapardisen restoranteve e buzuqeve me pushtetarë të lartë e politikanë. Tani, ne si institucion vlerësojmë punën dhe arritjet e në bazë të tyre bëhet edhe vlerësimi për çdo punonjës. Të paktën për këto tetë muaj besoj se kemi dhënë prova për këtë çka thashë pak më sipër.

Puna e Ministrisë së Brendshme është e përqendruar, gjithashtu, edhe në disa nga fenomenet me të errëta të realitetit shqiptar si hakmarrja, gjakmarrja apo krimi në familje. Për parandalimin, dhe siç dëshiroj, eleminimin e plotë të tyre, është i domosdoshëm bashkëpunimi i ngushtë i yni dhe bashkërendimi i përpjekjeve të të gjithëve.

Pa dashur të zgjatem, desha edhe njëherë t'ju siguroj se dyert e Ministrisë së Brendshme do të jenë të hapura për të gjithë ata që kërkojnë të “investojnë” në parandalimin e krimit. Gjithashtu, ne do të mbështesim çdo iniciativë që i shërben këtij qëllimi, ashtu si seminari i sotëm, të cilat i uroj punë të mbarë.

Bajram Ibraj

Drejtore i përgjithshëm i Policisë së Shtetit

Zhvillimi i këtij seminari shumë të rëndësishëm më jep privilegjin të informoj pjesëmarrësit për punën e Policisë së Shtetit në luftën ndaj krimit dhe veçanërisht për parandalimin e tij, si dhe të shpreh disa konsiderata për veprimtarinë e përbashkët që duhet të zhvillojnë institucionet qeveritare dhe organizmat jo qeveritare në këtë drejtim.

Jemi të ndërgjegjshëm se parandalimi i krimit në një koncept më të gjerë ose parandalimi jo vetëm penal është një veprimtari që kapërcen kuadrin e kompetencave dhe përgjegjësive të Policisë së Shtetit, pasi ajo është e ndërlidhur dhe e ndërvarur edhe nga faktorë jashtëpolicorë. Të tillë faktorë mund të përmendim: punësimin, shkallën e mirëqenies, nivelin arsimor të popullatës, problemet sociale, zhvillimin e kulturës dhe edukatës qytetare, e kështu me radhë. Në këtë pikëpamje, parandalimi i krimit mund dhe duhet të përfshijë pothuajse të gjitha institucionet e administratës publike, veçanërisht bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së agjencive të zbatimit të ligjit me organet e drejtësisë.

Megjithatë duke qenë ligjërisht përgjegjës për rendin dhe qetësinë në vend, si dhe për parandalimin dhe goditjen e krimit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe strukturat vendore të saj kanë marrë masat e nevojshme që në të gjithë aktivitetin e tyre, si në planin taktik dhe atë strategjik, të ndërmarrin veprime konkrete për parandalimin e krimit.

Në këtë kuadër, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në iniciativë të përbashkët me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim, ka përgatitur projektligjin për *krijimin e Komitetit Kombëtar për Parandalimin e Krimit*, i cili synon që duke

u mbështetur në eksperientat më të mira perëndimore të krijojen struktura dhe të hartohen strategji të përshtatshme parandaluese.

Në strategjitet tona parandaluese udhëhiqemi nga parimi se është më mirë të parandalosh krimin sesa ta zbulosh e godasësh, pasi parandalimi i krimit është më pak i kushtueshëm se zbulimi i tij dhe se parandalimi i krimit është më i dobishëm se reagimi ndaj tij. Një shoqëri demokratike në raport me krimin kërkohet të jetë më shumë aktive sesa reaktive, më shumë parandaluese sesa reaguese. Prandaj, ne jemi të vendosur për të konsoliduar përfundimisht urat e bashkëpunimit me të gjithë aktorët e interesuar në përpjekjet e përbashkëta për rritjen e parametrave të sigurisë publike në vend.

Pa pretenduar se çdo tregues i punës tonë është në standardet e kërkua apo se kemi rifiuar tërësisht besimin, përkrahjen dhe ndihmën e publikut, progresi që kemi bërë dhe marrëdhëniet tona me komunitetin tregojnë se tashmë jemi duke ecur në rrugë të mbarë. Reformat e zhvilluara dhe masat e marra kanë krijuar bazën e nevojshme që ne të ecim në kahun e duhur. Miratimi së shpejti nga Qeveria i Dokumentit të Strategjisë së Policimit në Komunitet krijon një mundësi tjetër që Policia e Shtetit të renditet në krah të simotrave evropiane për nga standardet e procedurat e luftës kundër krimtit.

Kështu, nëpërmjet projekteve pilot të iniciuara së bashku me IDN-në në fazën eksperimentale të kësaj strategjie, janë hedhur urat e bashkëpunimit polici-pushtet vendor në të gjithë vendin, janë ngritur grupet konsultative polici-komunitet, si dhe janë implementuar projekte të parandalimit të krimtit në shkolla, etj. Falë disa projekteve të realizuara nga donatorë të huaj janë krijuar kushtet për një policim realisht demokratik sipas trinomit Polici-Shkollë-Shërbime Sociale, duke bërë

realitet filozofinë e policimit në komunitet në disa komisariate policie, etj.

Krahas arritjeve me partnerët e përmendur më sipër, Policia e Shtetit nuk ka reshtur së bëri hapa të rëndësishëm në drejtim të afrimit me publikun dhe përmirësimit të imazhit të saj. Përveç zyrave të marrëdhënieve me publikun që janë funksionale në çdo drejtori policie qarku dhe që janë në shërbim të qytetarëve, të gjithë strukturat e Policisë së Shtetit tashmë janë të orientuara drejt afrimit me publikun dhe kryerjes së shërbimeve ndaj tij.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në vazhdimësi ka stimuluar fuqizimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve polici-publik, njëkohësisht ka qenë dhe është e papajtueshme me çdo veprim që shkel të drejtat dhe liritë e shtetasve apo me çdo sjellje që mund të cenojë imazhin e policisë në publik nëpërmjet kryerjes së veprimeve korruptive, sjelljeve abuzive, të padenja, etj.

Ne, gjithashtu, vlerësojmë bashkëpunimin me institucionet arsimore, e në mënyrë të veçantë me shkollat, me organizatat joftimprurëse dhe me biznesin. Ky bashkëpunim nuk duhet të konsistojë vetëm në çështjen apo nevojat e ditës, por në radhë të parë për zgjidhjen e problemeve thelbësore dhe afatgjata për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike në fushën e mbrojtjes së jetës, shëndetit, pronës e bizneseve. Në këtë kuadër, do të vlerësoja rritjen e interesit të biznesit për probleme të sigurisë dhe kërkesën e tyre për bashkëpunim institucional me policinë. Po kështu e rëndësishme është nisma e institacioneve arsimore për të zhvilluar orë mësimore ekstrakurrikulare për fenomenet negative që çojnë në rrugën e krimtit, duke filluar nga ndryshimet e programeve për trajtimin e problemeve të grumbullimit të armëve, të drogës, të prostitucionit, për metodat e format e rekrutimit në grupe kriminale, për zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor, etj.

në bashkëpunim me punonjës policie të zonës apo drejtimeve të veçanta të luftës ndaj krimtit.

Në këtë bashkëpunim duhet të marrin pjesë e të ftohen të gjithë aktorët si: organet e pushtetit vendor, institucionet arsimore, organizata të ndryshme shoqërore e jo fitimprurësse, por dhe përfaqësuesit e komuniteteve fetare apo grupe të ndryshme të interesit. Për ne do të ishin të mirëpritura idetë dhe veprimet, të cilat do të kishin në themel bashkëpunimin për të rritur parametrat në fushën e sigurisë, duke i siguruar se mbështetja dhe interesi i strukturave policore në këtë drejtim do të ishte maksimal.

Mbas 15 vjetësh eksperiencë, tashmë nuk ka asnjë dyshim dhe është i gjithë pranuar koncepti se në shoqëritë demokratike nuk ka mënyrë tjetër të policuari, veçse atij që në bashkëpunim dhe në partneritet me publikun të realizojmë një shërbim bashkëkohor, duke synuar në parandalimin e shkeljeve të ligjt dhe të kryerjes së krimtit.

Politikat e brendshme të personelit policor, probleme të arsimimit e të trajnimit si dhe demokratizimi i mëtejshëm i vetë policisë, etj. kanë peshë të konsiderueshme në drejtim të modernizimit të policisë dhe aplikimit të praktikave të policimit në komunitet e fitimit të besimit të publikut. Policia duhet të jetë pasqyrë e ekzigjencave dhe diversitetit të komunitetit, të cilit i shërben, kjo parë si në aspektin e moshës, gjinisë, kulturave, përkatësisë etnike, etj.

Në kuadër të forcimit të punës parandaluese kundër krimtit janë krijuar *Grupet konsultative polici-komunitet*, të cilat natyrshëm janë përfshirë në zgjidhjen e problemeve të rendit dhe sigurisë në vend, sidomos duke kontribuar konkretisht në interes të një jetese të përbashkët dhe të sigurt.

Sic dihet komuniteti i biznesit është promotor i jetës ekonomike dhe sociale të vendit dhe hapësirat e bashkëpunimit me këtë komunitet duhet të jenë të larmishme,

duke kontribuar në ushtrimin e lirë dhe të sigurt të bizneseve. Por nëpërmjet këtij bashkëpunimi ne kemi zhvilluar edhe fushata të përbashkëta në funksion të parandalimit të krimit. Në këtë aspekt, ka dhënë ndihmesën e vet edhe Marrëveshja e Bashkëpunimit që Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ka me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë.

Vitet e fundit, duke i dhënë rëndësinë që i takon parandalimit të krimit në moshat e reja nëpërmjet edukimit dhe këshillimit të tyre, përfaqësues të shoqërisë civile në bashkëpunim me organet policore në qendër dhe në bazë, kanë iniciuar dhe realizuar projekte të parandalimit të krimit në shkolla. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe hartimi dhe zbatimi i memorandumeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme, ku do të veçnim Memorandumin me Parlamentin Rinor Shqiptar “Për përmirësimin dhe rritjen e sigurisë publike në institucionet arsimore dhe ambientet e tjera rimore”.

Kjo praktikë bashkëkohore duhet të shtrihet dhe thellohet më tej, pasi përveç kontributeve sociale që jepen duke shpëtuar nga rruga e krimit adoleshentë e të rinj, është dhe një formë efikase për edukimin ligjor të kësaj moshe si dhe për formimin e imazheve të drejta për punonjësit e zbatimit të ligjit. Mendoj se edhe me të gjitha nivelet e qeverisjes vendore mund të realizohet institucionalizimi i këtij bashkëpunimi, ashtu siç kemi vepruar për problemet e parandalimit të kultivimit të bimëve narkotike.

Si rezultat edhe i kësaj pune të kryer, progresi i policisë në drejtim të rritjes së parametrave të rendit dhe sigurisë publike në vend është i dukshëm. Treguesit e rendit në përgjithësi dhe shifrat e kriminalitetit në gjashtëmujorin e parë të këtij viti janë nga më të mirat ndër vite.

Në planet tona të së ardhmes për parandalimin e krimtit, disa nga objektivat tona madhore janë:

- Evidentimi dhe eliminimi i faktorëve ndihmës që stimulojnë e zhvillojnë kriminalitetin.
- Zhvillimi i analizave periodike të gjendjes së kriminalitetit në tërësi dhe të veprave penale që kanë të bëjnë me gjakmarrjen, drogën, trafiqet, etj., në veçanti, përcaktimi i masave për t'i parandaluar ato.
- Hartimi në vazhdimësi i strategjive dhe i planeve të veprimit me objekt konkret të përcaktuar, për parandalimin e formave të krimít.
- Përcaktimi i rolit të medias në parandalimin e krimít, vendosja e urave të bashkëpunimit me to.
- Marrja në vazhdimësi e masave për rritjen e nivelit profesional të strukturave të specializuara të Policisë së Shtetit.

Të nderuar pjesëmarrës!

Më lejoni të shpjegohem më qartë dhe në mënyrë më të drejtpërdrejtë në këtë kumtesë që po mbaj sot “Parandalimi i krimít eshtë detyrë dhe sfidë e përbashkët e gjithë shoqërisë shqiptare” dhe që në fillim dëshiroj të theksoj që përveç të tjerave, parandalimi i krimít fillon edhe me evidentimin e saktë të veprave penale. Këtë çështje unë si drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit e kam trajtuar dhe zgjidhur me nënshkrimin e urdhrit të shërbimit nr. 6186, datë 29.12.2002 “Për evidentimin e saktë të veprave penale”. Qëllimi i këtij urdhri ishte të shmangete mangësitë e të metat e konstatuara nga strukturat e policisë për mosevidentimin e mosraportimin e veprave penale të kallëzuara apo të ankuara në strukturat tona. Por ç'ndodhi më pas, pavarësisht se strukturat e Policisë së Shtetit e goditën këtë fenomen dhe për ta kuptuar këtë po ju argumentoj se nga 4975 vepra penale të evidentuara për vitin 2002 në vitin 2005, pra pas 3 vjetësh janë evidentuar 8250, pra

3275 vepra penale me shumë, pra evidentim i veprave penale jo rritje e kriminalitetit, ndërkoq që zbulimi i tyre rezulton në vitin 2002, 88% ndërsa në vitin 2005, 71% .

Për krimin e vrasjes

Vrasjet në vite:

• 1998	<i>ndodhur</i>	573
• 1999	<i>ndodhur</i>	496
• 2000	<i>ndodhur</i>	275
• 2001	<i>ndodhur</i>	208
• 2002	<i>ndodhur</i>	179
• 2003	<i>ndodhur</i>	144
• 2004	<i>ndodhur</i>	121
• 2005	<i>ndodhur</i>	130
• deri në maj 2006	<i>ndodhur</i>	36

Për gjakmarrje

Në vite:

• 1998	<i>ndodhur</i>	45
• 1999	<i>ndodhur</i>	41
• 2000	<i>ndodhur</i>	18
• 2001	<i>ndodhur</i>	19
• 2002	<i>ndodhur</i>	13
• 2003	<i>ndodhur</i>	12
• 2004	<i>ndodhur</i>	11
• 2005	<i>ndodhur</i>	5
• Deri në maj 2006	<i>ndodhur</i>	2

Për konfliktet

Periudha 2004 - mars 2006:

• Konflikte të regjistruara	8870 raste total
-----------------------------	------------------

• <i>Në zonat rurale</i>	<i>6785 raste</i>
• <i>Në zonat urbane</i>	<i>2085 raste</i>
• <i>Zgjidhur nga PSH</i>	<i>6989 raste ose 78,7%</i>
• <i>Përfunduar në krim</i>	<i>407 raste ose 0,5%</i>

Për drogën

Për vitin 2004: Regjistruar 336 raste, goditur 275 persona

Për vitin 2005: Regjistruar 641 raste, goditur 387 persona

Në këto vite, fatkeqësisht, të gjithë kemi parë e dëgjuar të bëhet edhe politikë me këto shifra duke akuzuar policinë se është rritur kriminaliteti, e me gjithë shpjegimet tona, drejtues të institucioneve të ndryshme, parti politike e politikanë të veçantë dhe veçanërisht media elektronike dhe e shkruar duke përqafuar “lajmin e keq si lajmin më të mirë”, kanë dëmtuar imazhin e Policisë së Shtetit në publik se ajo s’ka punuar apo ka punuar dobët prandaj janë rritur shifrat e kriminalitetit. Nëpërmjet këtij urdhri, qysh në vitin 2002 ne planifikuam detyrat tona që të evidentojmë çdo vepër e kundërvajtje penale, me synim që të arrinim sa më shpejt si polici të simotra evropiane, që në një të ardhme të shpejtë të arrihej që të njoftonin edhe fëmijët apo bashkëshortet në polici për keqtrajtime apo edhe për vepra penale, pra të parandalonim krimin në familje, por më vjen keq ta them në këtë auditor se megjithëse kanë kaluar rreth 4 vjet këtë angazhim të Policisë së Shtetit nuk arritën “ta kuptojnë” institucionë, parti politike, OJQ, media e deri edhe shoqëria civile, ky do të ishte veprimi më i vogël nëse s’do të arrinin deri aty sa të akuzonin policinë për këto tregues “në rritje” të krimit. Evidentimi i çdo vepre penale është njëra anë, por më e rëndësishme se sa kjo është forca goditëse që jep institucionin i Policisë së Shtetit, edhe

këtë më lejoni ta argumentoj me shifra të tjera, po të shikoni me vëmendje statistikat e policisë do të konstatoni se numri i rasteve të goditura dhe i autorëve të arrestuar për trafikun e drogës, trafiqet e paligjshme e për krimin ekonomiko-financiar është në rritje, kjo tregon forcën goditëse, jo rritjen e krimit të organizuar sepse të gjithë e njohin periudhën para gjysmës së vitit 2002 kur trafiqet lulëzonin dhe nga Rinasit në Vlorë, mjetet që dërgonin klandestinë lëviznin si mjete të shërbimit publik dhe shifrat ishin më të vogla në numër, mbasë për disa figura krimi s'kishte fare tregues sepse mungonin edhe nenet përkatëse në Kodin Penal. Po të marrim treguesin e vrasjeve të ndodhura 1 janar - 26 qershor 2006 numri është 39 vrasje të evidentuara, 31 të zbuluara ose 79% kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2005, evidentohen 48 vrasje të evidentuara, 43 të zbuluara ose 90%, pra 9 vrasje më pak.

Të nderuar pjesëmarrës dhe përfaqësues të medias elektronike dhe të shkruar!

Këto argumete i përmenda më me forcë sot për të shpjeguar përfundimisht se shifrat e kriminalitetit duhen lexuar e interpretuar siç janë dhe ju lutemi jepini fund abuzimit me trajtimin e kronikës së zezë si lajmi i parë në median elektronike dhe si lajmi i zi në faqen e parë të gazetave të përditshme. Shqipëria më 12 shtator nënshkroi marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me BE-në, dhe pa dyshim treguesit e arritur nga Policia e Shtetit me vullnetin e mbështetjen e Qeverisë dhe të Ministrisë së Brendshme, ishin ndër treguesit më të arrirë dhe ne jemi krenarë për punën që bëmë dhe vlerësimin e drejtuesve më të lartë të shtetit. Ne i shërbyem vendit tonë në një moment vërtet historik, por për mendimin tim, nuk mjafton vetëm kjo dhe vetëm nga policia. Njerëzit janë të lodhur nga problemet e tyre sociale, ekonomike dhe

pasqyrime të tilla kanë bërë që deri tani të shqetësoheshin edhe më shumë njerëzit tanë, madje grave apo të moshuarve dhe sidomos të sëmurëve jua shtojnë dhimbjet dhe shqetësimet. Por më e rëndësishme se kjo është miredukimi i brezit të ri, besoj se edhe ju ndani të njëjtin qëndrim me mua se kronika e zezë e pasqyruar pa vend, i bën ata që të imitojnë dhe jo të edukohen. Ne, punonjësit e Policisë së Shtetit jemi mësuar të punojmë më shumë dhe në kushte më të vështira se të tjerët, madje të vazhdojmë të jemi i vetmi institucion në Shqipëri që punon 48 orë në javë dhe që paguhet vetëm për 40 orë pune në javë, të mos marrim edhe orët suplementare dhe për disa vite të mos bëjmë as një të tretën e lejes së zakonshme, të garantojmë rendin e sigurinë publike dhe të përballojmë me sukses zgjedhjet politike edhe kur partitë politike krijojnë probleme serioze midis tyre, nuk na miratojnë numrin e duhur të punonjësve për sigurimin e qendrave të votimit dhe detyrohemë të planifikojmë edhe shoferët e punonjësit e logistikës për të bërë detyrën e policit, dhe nuk na jepin asnje qindarkë nga fondet e vëna në dispozicion për zgjedhjet me gjithë shpenzimet e shumta që kemi bërë në shërbime të zgjatura, të sakrifikojmë edhe kur kemi rruga të ulëta edhe kur jemi pa shtëpi edhe kur na akuzojnë pa të drejtë, dhe gjithmonë do ta bëjmë punën tonë, por këtë kërkesë e drejtoj si drejtor i përgjithshëm i policisë, si qytetar i këtij vendi dhe si prind dhe dëshiroj të ftoj të gjithë aktorët dhe faktorët e shoqërisë shqiptare që ta vlerësojnë këtë kërkesë jo tonën dhe jo për ne, por si kërkesë për të gjithë, për shoqërinë dhe në shërbim të të gjithëve. Ne jemi në shërbimin Tuaj, por së bashku duhet së paku të parandalojmë krimin, të kërkojmë më të mirën, të vlerësojmë pozitiven, të kritikojmë negativen dhe të kontribuojmë secili në funksionin që ka dhe me mundësitet që i krijohen për të ndërtuar një të ardhme më të mirë.

Të nderuar pjesëmarrës!

Arritjet që apo përmenda, si dhe planet e shumta që kemi për të ardhmen, janë një garanci dhe na shtojnë besimin përritjen më tej të niveleve të bashkëpunimit me komunitetin dhe institucionet e tjera ligjzbatuese në drejtim të parandalimit të krimít, si një nga sfidat e së ardhmes.

Në përfundim, dëshiroj të shpreh një falënderim të veçantë për Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim përkontributin e veçantë që ka dhënë në implementimin e filozofisë së Policimit në Komunitet brenda strukturave të Policisë së Shtetit dhe në partneritet me aktorët e tjerë, si dhe përkushtet e shkëlqyera për zhvillimin e këtij aktiviteti të rëndësishëm.

Joseph Hauer
ICITAP

Statistikat e Krimtit në Shqipëri, Strategji për Menaxhimin e Burimeve dhe zhvillimin e Strategjive Parandaluese

Do të doja të theksoja komentet e mia rreth rëndësisë së Statistikave të Krimtit në Menaxhimin e Burimeve, brenda Sistemit të Drejtësisë Kriminale, si dhe rëndësinë e përdorimit të tyre në zhvillimin e strategjive për parandalimin në fushat e mëposhtme: (1) Pse statistikat e krimtit janë të rëndësishme; (2) Çfarë është e rëndësishme për statistikat e krimtit që të jenë domethënëse; dhe e fundit, por sigurisht pika më e rëndësishme (3) Çfarë duhet bërë.

Pse statistikat e krimtit janë të rëndësishme

Të gjithë anëtarët e Sistemit të Drejtësisë Kriminale në Shqipëri kanë përgjegjësi të rëndësishme dhe ligjore për të menaxhuar burimet nën juridikcionin e tyre, në mënyrë të tillë që të sigurojnë që shpërndarja e shërbimeve të jetë eficiente dhe efektive. Statistikat e krimtit shërbejnë si një mjet i rëndësishëm menaxhimi për të dhënë bazën për shpërndarjen e parandalimit të krimtit, zbulimit dhe kuptimit të burimeve për Institucionet e Drejtësisë Kriminale si dhe për shërbimet sociale dhe programet edukative,

Një tjetër vlerë e rëndësishme, por shpesh jo e theksuar nga institutet shtetërore të drejtësisë kriminale, është fakti që statistikat e krimtit shërbejnë, gjithashtu, si një barometër për

nivelin e ruajtjes së konfidencës së policisë, prokurorisë, gjykatave, dhe njësive të riedukimit, nga viktimat në aftësinë e sistemit për t'i ndihmuar ata. Kërkimet kanë treguar që një tregues parësor i besimit të publikut në Sistemin e Drejtësisë Kriminale, është përqindja e hapësirës, e ndryshimit mes krimit të raportuar (krimi i matur nga policia dhe prokurorët) si dhe krimi i paraportuar (Krimi i raportuar në anketimet kombëtare për krimin).

Statistika për krimin është një mjet i rëndësishëm për policinë në identifikimin e krimit me metodën e operacionit, çdo orë të ditës, ditë të javës, si dhe vendndodhjen e ngjarjes. Ky informacion, kur mblidhet dhe analizohet në kohë, bëhet i vlefshëm për personelin operacional dhe administrativ dhe shërben për të mbështetur strategjinë e kapjes dhe të parandalimit.

Bërja e njojur e statistikave të krimit

Që statistikat e krimit të bëhen të njoitura është e rëndësishme që statistika dhe të dhënat të jenë të sakta dhe të ketë një përkufizim konsistent të asaj çfarë konsiderohet një krim dhe si vlerësohet nga të gjitha institucionet e drejtësisë kriminale, d.m.th policia, prokuroria, gjykatat dhe institucionet e riedukimit. Statistikat e krimit duhet të prezantohen, gjithashtu, pas analizimit, në një mënyrë që t'i shërbejnë si përdoruesve të drejtësisë kriminale, ashtu edhe partnerëve të tjera të interesuar, siç janë: OFJ-të, policitë bashkiake apo private, avokatët e komunitetit, etj.

Çfarë duhet bërë

Është e nevojshme që të formohet një këshill koordinues ose një organizatë nga drejtuesit brenda policisë, prokurorisë,

gjykatave, qendrave të korrektimit, OJF-ve dhe edukimit të mesëm. Ky ent duhet të ketë mandatin e mëposhtëm:

- (1) Të identifikojë cilat statistika të krimit maten dhe si ndihmojnë për të mbështetur vendndodhjen e burimeve; identifikimin e drejtimeve kriminale; mbështetjen e strategjive të parandalimit dhe masa të nivelistët të performancës nga institucionet e drejtësisë kriminale.
- (2) Të vlerësojë dhe të rekomandojë se si mund të përmirësohet teknologjia dhe/ose t'i promovojë për mbledhjen dhe propagandimin e statistikave të krimit dhe analizave të krimit për punonjësit e sistemit të drejtësisë kriminale, OJF-ve dhe publikut.
- (3) Të koordinojë që llojet e statistikave të krimit dhe të dhënat e krimit të jenë të plota për një menaxhim më të mirë dhe në kohë të informacionit në vendndodhjen dhe financimin e burimeve të drejtësisë kriminale; të bëjë popullatën më të vetëdijshme për rolin e tyre në parandalimin dhe ndalimin e akteve kriminale; si mund të ndahen burimet mes anëtarëve të këtij këshilli koordinativ për të përmirësuar sigurinë publike dhe për të zvogëluar krimin.

Nasip Naço
Prokuror i rrethit Durrës

Prokuroria dhe detyrimi ligjor për parandalimin e krimit

Zhvillimi i këtij seminari bëhet në një kohë kur është intensifikuar ndjeshëm lufta ndaj krimit dhe çdo ditë e më shumë po forcohet te qytetarët dhe tek organizmat ndërkombëtarë besimi te shteti dhe tek institucionet e specializuara që luftojnë krimin.

Megjithëse rezultatet e luftës kundër krimit janë të dukshme e të prekshme, është në interes të shoqërisë dhe të strukturave të specializuara të shtetit marrja e masave të nevojshme dhe të domosdoshëm për parandalimin e krimit.

Ndryshimet e vrullshme që ndodhën në shoqërinë shqiptare pas viteve '90, si hapja e shoqërisë, lëvizja e lirë e shtetasve brenda vendit, emigracioni i shoqëruar edhe me zhvillimet e mëdha ekonomike, sollën jo vetëm rritje të ndjeshme të kriminalitetit në përgjithësi, por edhe shfaqjen e disa figurave të reja krimi me pasoja të mëdha për individët dhe shoqërinë tonë.

Kategoria më e prekur dhe më e përfshirë nga këto fenomene është natyrisht brezi i ri.

Në këtë kontekst është e rëndësishme që këto fenomene negative që janë kthyer plagë për shoqërinë tonë të parandalohen dhe kjo duhet të jetë detyrë e të gjitha institucioneve shtetërore që të angazhohen në marrjen e masave të gjithanshme juridiko-penale dhe sociale.

Në këtë frymë është miratuar edhe ligji për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë ku në nenin 5 parashikohet: *“Prokuroria bashkëpunon me institucionet shtetërore si dhe me subjekte të tjera publike dhe private për veprimtari për edukimin e shoqërisë, me synim njohjen e ligjit dhe parandalimin e kriminalitetit.”*

Pavarësisht se ky ligj ka disa vite që është miratuar nuk ka patur vlerësimin dhe zbatimin e duhur në praktikën e përditshme.

Në këtë kuadër e vlerësojmë nismën e ndërmarrë nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në disa prefektura për të organizuar takime me qëllim koordinimin dhe bashkëpunimin midis prokurorisë, policisë, organeve të qeverisjes vendore dhe institucioneve qendrore në nivel vendor për të hartuar plane vjetore për parandalimin e krimtit dhe problemeve të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike. Për më tepër kjo nismë përkon me intensifikimin e luftës kundër krimtit.

Nisur nga këto takime që u zhvilluan në prefekturën e Durrësit nga ana jonë si prokurori në bashkëpunim me Drejtoren Arsimore rajonale janë organizuar disa takime me nxënës të shkollave të mesme të qytetit të Durrësit ku janë trajtuar tema të ndryshme.

Në këto takime nga ana e prokurorëve është synuar në njohjen e të rinjve me legjislacionin aktual penal e shoqëruar kjo me ndërgjegjësimin e të rinjve me pasojat negative që sjellin fenomenet, krimet më të përhapura sot në brezin e tyre, siç janë pasojat negative që sjell e shkakton droga duke e larguar nga shkolla e edukimi, dhe shndërruar këtë brez në kontigjent të mundshëm për krimin.

Përveç sa më sipër, pikërisht në këtë kuadër duhet të organizohen edhe takime me përfaqësues të biznesit për t'u trajtuar problemet dhe fenomenet e reja juridiko-penale që

kanë lindur në fushën e tatim-taksave, doganave, etj. Një rëndësi e veçantë është treguar në drejtim të statistikave duke konsideruar se njohja e tyre është një element i rëndësishëm në hartimin e planeve dhe politikave parandaluese.

Prof. dr. Elfrida ZEFI
Prefekte e Qarkut Korçë

Parandalimi i Krimtit - Plani i Punës për tremujorin prill – qershor 2006

Qarku Korçë

Ky plan u përgatit në mbledhjen e datës 10.03.2006 dhe zbatimi i tij do të monitorohet nga prefekti i qarkut. Në takimin e radhës, që do të thirret nga prefekti, do të diskutohet efektiviteti dhe niveli i realizimit të këtij plani, si dhe do të përcaktohen drejtimet e bashkëpunimit për periudhën në vazhdim.

Qëllimi i këtij plani pune është:

Bashkëpunimi i të gjitha Institucioneve Vendore dhe Qendrore në nivel vendor, pjesëtarë të Organit Këshillues të Prefektit për organizimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve, me qëllim parandalimin e krimtit dhe rritjen e parametrave të sigurisë në qark.

- Organet e Pushtetit Vendor si: këshilli i qarkut, bashkitë, komunat, kryetarët e bashkive dhe komunave brenda këtij tremujori do të mundësojnë hapjen e të paktën një zyre për punonjësit e policisë së zonës, duke synuar që brenda këtij viti këto zyra të jenë hapur në të gjitha rajonet administrative të qyteteve si dhe në të gjitha komunat.
- Kryetarët e njësive administrative dhe të komunave si dhe kryepleqtë, në bashkëpunim me drejtues dhe punonjës të policisë organizojnë të paktën nga një takim të hapur

konsultativ me komunitetin e zonës së tyre për të diskutuar problemet e ndryshme të rendit, sipas specifikave të secilës zonë duke u përqendruar në parandalimin e mbjelljes së bimëve narkotike.

- Ftojnë në mbledhjet e radhës të këshillit të qarkut, këshillave bashkiake dhe të komunave, drejtuesit dhe/ose punonjësit e policisë për të diskutuar mbi probleme të rendit dhe sigurisë publike, si dhe për t'u konsultuar përményrën e zgjidhjes së tyre.
- Organet e Pushtetit Vendor dhe strukturat e policisë do të ruajnë kontakte të vazhdueshme, duke komunikuar me shkrim për të gjitha problemet dhe shqetësimet.

Ky komunikim me shkrim do të shërbejë edhe për shkëmbimin e informacionit të nevojshëm në lidhje me rendin, sigurinë publike, si dhe parandalimin e krimit në zonat përkatëse.

Në përfundim të këtij tremujori do të bëhet një vlerësim me shkrim të punës dhe bashkëpunimit me Policinë e Shtetit sipas kësaj skeme:

- Këshilli i qarkut bën vlerësimin e punës dhe bashkëpunimit me drejtorin e Drejtorisë së Policisë dhe e paraqet atë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- Këshilli Bashkiak vlerëson punën dhe bashkëpunimin me shefin e Komisariatit të Policisë dhe ia paraqet atë drejtorit të DPQ-së.
- Këshillat e Komunave bëjnë vlerësimin për punonjësit e policisë së zonës dhe ia paraqesin atë shefit të Komisariatit.

Drejtoria e Policisë së Qarkut dhe Komisariatet e Policisë:

1. Do të praktikojnë rregullisht komunikimin institucional me shkrim me Organet e Pushtetit Vendor. Ky komunikim

- do të synojë shkëmbimin e informacioneve me qëllim ndarjen e përgjegjësive dhe bashkëpunimin për zgjidhjen e problemeve që shqetësojnë komunitetin.
2. Në bashkëpunim me të gjitha nivelet e Pushtetit Vendor, shërbimi i rendit dhe sigurisë publike, në të gjitha komisariatet, do të organizojë takime mujore me përfaqësues të komunitetit dhe grupeve të ndryshme të interesit, për të diskutuar dhe konsultuar në lidhje me probleme të ndryshme të rendit që shqetësojnë komunitetin në zonën përkatëse.
 3. Në bashkëpunim me Drejtoren Arsimore dhe drejtoritë e shkollave të mesme dhe 9-vjeçare, si dhe parlamentin dhe qeveritë e nxënësve do të planifikohen aktivitete konkrete në kuadër të një plani afatgjatë. Këto aktivitete do të jenë në mbështetje edhe të Memorandumit të nënshkruar mes Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Parlamentit Rinor më 28 dhjetor 2005. Aktivitetet do të përqendrohen në çështje si: parandalimi i krimtit në format e tij të ndryshme si: trafiqet, lëndët narkotike, probleme të qarkullimit dhe sigurisë në rrugë, si edhe çështje të tjera që do të konsiderohen të rëndësishme.
 4. Drejtori i DPQ-së organizon një herë në tre muaj takim me OFJ të ndryshme që kanë aktivitet në zonën e qarkut. Bashkëpunimi me këto organizata duhet t'i shërbejë përvetësimit të metodave bashkëkohore të policimit, në kuadër të parandalimit të krimtit si dhe të rritjes së nivelit cilësor të shërbimeve që ofron Policia e Shtetit.
 5. Shefat e komisariateve do të organizojnë një takim të paktën një herë në tre muaj me përfaqësues të Dhomës së Tregtisë dhe Biznesit Lokal. Po ashtu inspektorët e rendit dhe të krimeve do të organizojnë takime mujore me grupe biznesmenësh të zonave përkatëse të policimit dhe do t'i

paraqesin eprorit një raport në lidhje me problemet e diskutuara.

6. Çdo gjashtë muaj drejtori i DPQ-së organizon një takim me Dhomën e Tregtisë për të bërë vlerësimin e bashkëpunimit. Në kuadër të bashkëpunimit, të kërkohet nga bizneset lokalë mbështetje financiare konform ligjeve në fuqi, për realizimin e miniprojekteve në zbatim të programit për policimin në komunitet dhe parandalimin e krimtit.
7. Në rang drejtorie do të përgatitet një spot televiziv me qëllim sensibilizimin e popullatës për parandalimin e krimtit. Ky spot do t'u jepet për transmetim të gjitha mediave lokale. Po ashtu nëpërmjet njoftimeve për shtyp, do të njoftohet opinioni publik për masat e marra dhe punën e bërë nga policia në bashkëpunim me Pushtetin Vendor dhe institucionet e tjera, në lidhje me parandalimin e krimtit.
8. Një herë në muaj drejtori i DPQ-së ose shefat e komisariateve do të dalin në konferencë për shtyp për të prezantuar punën e policisë, si dhe për t'u përgjigjur pyetjeve dhe interesimit të gazetarëve. Zyrat e marrëdhënieve me publikun do të përgatisin dhe publikojnë statistikat e sallës operative në lidhje me telefonatat e qytetarëve. Kjo praktikë synon të rrisë numrin e telefonatave nga ana e komunitetit.
9. Drejtoria Arsimore do të punojë në këto drejtime:
 1. Në nxitjen e organizimit të aktiviteteve ekstrakurrikulare të karaktereve të ndryshme, si: sportive, kulturore, etj., me qëllim sensibilizimin dhe edukimin e të rinjve me respektin për ligjin dhe ndjenjën e përgjegjësisë komunitare.
 2. Në bashkëpunimin me organet e policisë për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, me qëllim parandalimin e fenomeneve antisociale dhe kimeve

specifike të moshës dhe ambienteve publike të frekuentuara nga të rinjtë.

3. Në pjesëmarrjen e punonjësit/specialistikët të policisë së rendit dhe kimeve në mbledhjet e stafit pedagogjik sa herë konsiderohet e nevojshme.
4. Në organizimin brenda kurrikulës të orëve të veçanta mësimore me pjesëmarrjen dhe në bashkëpunim me specialistë të policisë për tema të ndryshme që kanë të bëjnë me respektimin e ligjit dhe parandalimin e krimit.
5. Në bashkëpunimin me strukturat e policisë së rendit për të krijuar ambiente të sigurta për nxënësit, duke kërkuar monitorimin e ambienteve të shkollave me orare dhe raste të caktuara që synojnë parandalimin e kimeve të ndryshme.
10. Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Parësor nëpërmjet Qendrës së Shërbimeve Miqësore për të rinjtë "Juvenilia", e cila funksionon në qytetin e Korçës, si pjesë e një projekti të Ministrisë së Shëndetësisë, Drejtorisë së Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe zyrës së UNICEF-it në Tiranë, ngritur në kuadrin e një programi 5-vjeçar për zhvillimin dhe për kujdesjen e shëndetit të të rinjve dhe parandalimit të HIV/AIDS në Shqipëri. Të ofrohen shërbime shëndetësore dhe këshillimore, duke u bërë një vend i përshtatshëm, ku të rinjtë mund të shkojnë të marrin shërbime konfidenciale, pa pasur frikë se do të gjykohen. Qëllimi i Qendrës është përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, duke iu përgjigjur nevojave shëndetësore dhe psikologjike të të rinjve. Të sigurohet prezenca e një punonjësi social në aktivitete të ndryshme të organizuara nga grupet e të rinjve.
11. Biznesi
 1. Do të ftohen në takimet e Dhomës së Tregtisë, drejtuesit e organeve të policisë me qëllim diskutimin dhe

konsultimin, për zgjidhjen e problemeve të ndryshme në lidhje me sigurinë e bizneseve, si dhe rendin e qetësinë publike.

2. Do të merret një takim në tre muaj me përfaqësues të Pushtetit Vendor për të bashkëpunuar në projekte të përbashkëta që kanë të bëjnë me rritjen e sigurisë.
3. Dhoma e Tregtisë do të përfshihet në financimin apo bashkëfinancimin e projekteve ose aktivitetave, fushatave të ndryshme sensibilizuese, me qëllim përmirësimin e treguesve të rendit dhe qetësisë publike, si dhe parandalimin e krimtit.

12. Prokuroria bashkëpunon me të gjitha organet dhe institucionet, duke ofruar ekspertizën dhe informacionin e nevojshëm në lidhje me fenomenin e kriminalitetit. Përfaqësues të specializuar të prokurorisë do të marrin pjesë në aktivitetet e ndryshme që do të organizohen nga policia në bashkëpunim me institucionet arsimore.

Komiteti i Parandalimit të Krimtit dhe Rritjes së Parametrave të Sigurisë

Rajoni Korçë

1. Elfrida ZEFI	Prefekte e Qarkut Korçë
2. Shemsi PRENCI	Drejtor i Policisë së Qarkut
3. Ilia NASI	Shefi i Komisariatit të Policisë
4. Hasan GJERGJI	Shefi i Komisariatit të Policisë Pogradec
5. Elton HALILI	Shefi i Komisariatit të Policisë Devoll
6. Artan AHMETAJ	Shefi i Komisariatit të Policisë Ersekë
7. Ilir HOXHAJ	Kryetar i Këshillit të Qarkut Korçë
8. Robert DAMO	Kryetar i Bashkisë Korçë
9. Valter MIZA	Kryetar i Bashkisë Devoll
10. Artan SHKËMBI	Kryetar i Bashkisë Pogradec

- | | |
|---|--|
| 11. Adriatik BRAÇE | Kryetar i Bashkisë Ersekë |
| 12. Koço BELLO | Sekretar i Përgjithshëm i Prefekturës |
| 13. Përfaqësues i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Korçë | |
| 14. Andrea MANO | Drejtor i Drejtorisë Arsimore |
| 15. Violeta TICI | Përfaqësuese e Parlamentit Rinor |
| 16. Gjergji PENDAVINJI | Rektor i Universitetit "Fan Noli" |
| 17. Asim DISHNICA | Drejtor i Qendrës Studentore |
| 18. Klara ÇELA | OJF-Gruaja Korçare |
| 19. Merita KROI | Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Parësor |
| 20. Orjada TARE | Zyra e CSDS-së Korçë |

Takimet e Komiteteve Vendore për Parandalimin e Krimit të organizuara nga IDN-ja në bashkëpunim me prefektët e qarqeve

Mbështetur në ligjin për prefektin (neni 10 dhe 21) Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim ka propozuar dhe ka organizuar në bashkëpunim me prefektët e qarqeve takime të organit këshillues pranë prefektit në formën e Komitetit Vendor për parandalimin e krimit. Në këto takime kanë marrë pjesë drejtuesit e strukturave vendore të Policisë së Shtetit, kryetarët dhe përfaqësues të Këshillit të Qarkut, kryetarët ose përfaqësues të bashkive të qarkut, prokurorisë së rrëthit, përfaqësues të shkollave, organeve të nxënësve, Drejtorisë Arsimore, Dhomës së Tregtisë, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjera vendorë.

Qëllim i këtyre takimeve ka qenë:

Së pari, diskutimi dhe hartimi i një plani vjetor të përbashkët për parandalimin e krimit dhe sigurimin e rendit dhe qetësisë publike. Roli drejtues dhe koordinues i institucionit të prefektit në këtë proces mbetet shumë i rëndësishëm.

Së dyti, por jo nga rëndësia, këto takime kanë pasur qëllim promovimin e komiteteve për parandalimin e krimit si një mbështetje për projektligjin që po rishqyrtohet dhe pritet të fillojë procedurat e miratimit nga strukturat përkatëse të qeverisë.

Në këto takime, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim ka ofruar eksperiencën e grumbulluar në 5 vitet e bashkëpunimit me strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit dhe organeve të Pushtetit Vendor.

FIER, shkurt 2006

Në takimin e parë të organizuar në Fier, prefekti i qarkut z. Shahin Bejto theksoi rëndësinë që ka vendosja e partneriteteve midis institucioneve me qëllim parandalimin e krimtit.

Nga pikat kryesore të planit të punës që u diskutua dhe miratua në këtë takim ishin:

- Thellimi i përvjoes pozitive në bashkëpunimin mes policisë dhe Pushtetit Vendor në fushatën sensibilizuese për parandalimin e mbjelljes së bimëve narkotike. Përfaqësues të Pushtetit Vendor u shprehën të gatshëm për të qenë më aktivë dhe për të marrë përgjegjësitet e veta në lidhje me parandalimin e këtij krimi.
- Përfaqësues të Parlamentit Rinor dhe të Arsimit në këtë rajon kërkuau mbështetjen dhe bashkëpunimin e policisë dhe organeve të tjera në hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta me qëllim parandalimin e krimtit. Edukimi i brezit të ri me respektin për ligjin mbetet thelbësor në kuadër të përpjekjeve për parandalimin e krimtit. Në planin tremujor të bashkëpunimit u vendos organizimi i një sërë aktivitetesh në bashkëpunim me strukturat e policisë së qarkut.
- Kryetari i Bashkisë Fier, zoti Baftjar Zeqo u angazhua që të krijojë mundësinë e hapjes së zyrave për inspektorët e policisë së rendit në çdo njësi administrative të qytetit të Fierit.

SHKODËR, mars 2006

Prefekti i qarkut Shkodër, zoti Gjovalin Kolombi theksoi në këtë takim se problemet me të cilat përballet shoqëria janë të shumta. Shumë nga këto probleme janë burim krimi dhe puna për parandalimin e krimit duhet të fillojë me zgjidhjen e këtyre problemeve. Ai garantoi se edhe politikat e qeverisjes qendrore do të janë në mbështetje të çdo nisme dhe bashkëpunimi në favor të marrjes së masave për parandalimin e krimit dhe rritjen e cilësisë së jetës në Qarkun Shkodër. Ai tha, gjithashtu, se personalisht do të jetë më aktiv në mënyrë që brenda kompetencave të institucionit të prefektit të ushtrøjë presion pozitiv maksimal në mënyrë që bashkëpunimi mes strukturave të Pushtetit Vendor dhe Qendorr të jetë sa më i efektshëm.

Të pranishmit diskutuan në detaj planin e punës dhe u vendos që prioritet për periudhën tre mujore të janë:

- Përmirësimi i bashkëpunimit dhe koordinimi i veprimitarive në fushatën për parandalimin e mbjelljes së bimëve narkotike duke shfrytëzuar dhe përmirësuar përvojën e funksionimit të Grupeve Konsultative Polici-Komunitet.
- Drejtori i policisë së qarkut z. Ahmet Prençi kërkoi nga IDN-ja realizimin e një trajnimi të të gjithë inspektorëve të rendit për funksionimin e Grupeve Konsultative Polici-Komunitet duke u fokusuar në punën dhe efektin parandalues të këtyre strukturave (trajnimi u realizua një javë pas këtij takimi).
- Nënkyrytarja e Bashkisë së Shkodrës premtoi hapjen e zyrave për inspektorët e rendit në gjashtë rajonet administrative të qytetit.
- Kryetari i Këshillit të Qarkut premtoi se do të thellohet bashkëpunimi me policinë në të gjitha bashkitë dhe komunat duke institucionalizuar pjesëmarrjen e

përfaqësuesve të sektorëve të ndryshëm të policisë sipas problematikave, në mbledhjet e organeve të Pushtetit Vendor.

- U përcaktuan detyra konkrete për degën vendore të KESH-it për marrjen e masave në bashkëpunim me të gjitha strukturat e tjera qoftë të policisë, por edhe të Pushtetit Vendor, etj., me qëllim rritjen e arkëtimeve për energjinë e konsumuar dhe njëkohësisht shhangjen e konflikteve të ndryshme të lidhura me mungesën ose mospagesën e energjisë.
- Shefat e komisariateve morën përsipër organizimin e takimeve me përfaqësues të biznesit me qëllim diskutimin dhe gjetjen e mënyrave për të krijuar një klimë gjithmonë e më të sigurt për bizneset me qëllim tërheqjen dhe rritjen e investimeve në qarkun e Shkodrës.
- Një nga problemet më të dhimbshme që përballet Shkodra është gjakmarrja. Në planin e përbashkët, puna për parandalimin e këtij fenomeni të krimit do të zëré një vend të veçantë. U vendos që takimi i radhës do të përqendrohet pikërisht në këtë çështje. Pjesëmarrësit përkrahëndin mendimin se ekzistanca e një strukturë të vetme siç propozohet në projektligj, që do të përfshijë të gjithë gamën e problemeve si dhe gjithë aktorët vendorë, do të jetë shumë më efikase se çdo strukturë, komitet apo nismë për çështje të momentit.

TIRANË, mars 2006

Në takimin e organizuar në Tiranë u diskutuan çështje nga më të ndryshmet duke u fokusuar në shumëllojshmërinë e dukurive kriminale në këtë qark. Në këtë takim përvëç të tjerave u fol edhe për përgjegjësinë që ka Pushteti Vendor në ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike dhe se kjo strukturë

mund dhe duhet të bëjë më tepër në këtë drejtim. Drejtori i IDN-së bëri prezantimin e pikave kryesore të planit të aktiviteteve duke kërkuar që pjesëmarrësit të evidentojnë ato çështje që janë më të ndjeshme sipas specifikës së secilës zonë. Drejtori i Policisë së Tiranës, zoti Albert Dervishi mbështeti këtë plan pune duke thënë se ky plan është në të njëjtën linjë me strategjinë dhe planet konkrete të policimit në komunitet dhe parandalimin e krimit që prej kohësh janë pjesë e punës së përditshme të efektivave të policisë. Takimin e përhëndeti edhe zv/shefi i misionit PAMECA, zoti Doug Adams, i cili u shpreh për mbështetjen që ky mision i jep nismës së IDN-së për organizimin e këtyre takimeve. Prefekti do të kërkojë dhe monitorojë zbatimin e pikave dhe detyrave konkrete për çdo anëtar të Komitetit Vendor të Parandalimit të Krimit. Pas këtij takimi prefekti Ruzhdi Keçi u dërgoi një udhëzim të gjitha komisariateve të kryeqytetit për të marrë iniciativën në realizmin e takimeve koordinuese mbi bazë komisariati.

KUKËS, mars 2006

Nën drejtimin e prefektit të qarkut, zotit Qemal Cenaliaj, për herë të parë mblidhen në një sallë për të diskutuar çështjet e sigurisë dhe parandalimit të krimit të gjithë aktorët vendorë. U diskutua rreth rëndësisë që ka bashkëpunimi i gjithë aktorëve vendorë në kuadër të parandalimit të krimit duke theksuar se përgjegjësia nuk duhet të jetë vetëm e Policisë së Shtetit. Shumë nga problemet që bëhen burim kriminaliteti mund dhe duhet të zgjidhen nga aktorë të tjera vendorë, duke filluar nga organet e qeverisjes vendore deri tek arsimi dhe shoqëria civile. Prokurori i rrethit deklaroi se nëse prokuroria do të kishte bërë punë parandaluese do të kishim një numër shumë më të vogël të rinjsh të dënuar për krim, si: përdorimi apo trafikimi i lëndëve narkotike, etj.

Pas një afati tremujor, prefekti do të organizojë takimin e radhës me qëllim vlerësimin e rezultateve si dhe rifreskimin e planit të punës për periudhën pasardhëse.

BERAT, prill 2006

Disa nga çështjet kryesore të diskutuara në takimin e Beratit ishin:

- Rëndësia e zhvillimit të programeve për sigurinë në rrugë, nëpërmjet një bashkëpunimi më aktiv mes policisë dhe shkollave të qytetit.
- Zhvillimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare nëpërmjet një bashkëpunimi mes institucioneve arsimore, ekspertëve të policisë dhe të prokurorisë e gjykatës.
- Riaktivizimin e Grupeve Konsultative Polici-Komunitet, mbështetur në përvojat e krijuara në tre vitet e fundit në bashkëpunim me IDN-në.
- Vazhdimësia dhe thellimi i nismave të tillë që synojnë bashkëpunimin dhe bashkërendimin e të gjitha institucioneve me qëllim parandalimin e krimit dhe rritjen e parametrave të sigurisë në qark.
- Përfundimi i hapjes së zyrave të inspektorëve të rendit në të gjitha komunat dhe rajonet administrative të bashkive të qarkut.

Në këtë takim morën pjesë edhe deputetët e zonës dhe kryetari i gjykatës. Falë angazhimit aktiv të prefektit të Beratit, zotit Roland Bejko, takimi në këtë prefekturë miratoi listën e përbërë nga 28 anëtarë të përhershëm të Komitetit Vendor të Parandalimit të Krimtit, i cili do të mblidhet çdo tre muaj për të diskutuar arritjet dhe problemet e evidentuara për periudhën paraardhëse.

ELBASAN, prill 2006

Në takimin e Elbasanit u diskutua rreth problemeve kryesore shqetësuese për sa i përket rendit, si p.sh. përdorimi i lëndëve narkotike në shkolla, trafiqet e ndryshme, siguria në rrugë, vjedhjet e banesave, zbulimi i kimeve të vjetra, etj.

- Në kuadër të rritjes së bashkëpunimit dhe marrjes së përgjegjësive, kryetari i bashkisë premtoi që brenda dy muajve do të përfundojë hapja e zyrave për inspektorët e rendit në të gjitha rajonet administrative.
- Prokurori i rrethit mori përsipër përgatitjen e një plani aktivitetesh me qëllim parandalimin e krimit. Ky plan do të realizohet në bashkëpunim me të gjitha institucionet dhe do të jetë përqendruar në bashkëpunimin me shkollat e mesme të qytetit.
- Po ashtu drejtuesit e institucioneve arsimore do të bashkërendojnë për hartimin e një plani të përbashkët për të gjitha shkollat me qëllim rritjen e efektivitetit në zbatimin e tyre.

KORÇË, prill 2006

Takimi i realizuar me më tepër përkushtim dhe profesionalizëm ishte ai i organizuar nga prefektja e Korçës, prof. Elfrida Zefi. Problemet e trafiqeve të ndryshme si dhe përgjegjësive të përbashkëta për parandalimin e këtyre fenomeneve ishin në qendër të këtij takimi. “Është kënaqësi të mirëpres të gjithë pjesëmarrësit në këtë aktivitet si dhe të falënderoj aktorët e ndryshëm të përfshirë në luftën kundër trafiqeve të ndryshme për gjithçka të mirë të arritur deri tanë, duke ju kërkuar përkushtim për implementimin e planit që do të prezantojmë në këtë takim, duke ndarë së bashku

praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra, me synim përmirësimin e punës për parandalimin e krimit në rajonin e Korçës.” – u shpreh prefektja Zefi.

Pjesëmarrësit në këtë takim (rreth 80) përfshirë përfaqësues të shoqatave të ndryshme, prezantuan punën e bërë në këtë qark në drejtëm të parandalimit të krimit dhe diskutuan dhe miratuan planin e punës të prezantuar nga prefektja e qarkut. Ashtu si dhe në të gjitha takimet e tjera u përcaktua se pas një periudhe tremujore do të organizohet takimi i radhës, i cili do të thirret nga prefektja dhe do të fokusohet në diskutimin e çështjeve konkrete.

DURRËS, prill 2006

Prefekti i qarkut z. Klodian Pajuni pasi prezantoi qëllimin e takimit theksoi nevojën për evidentimin e të gjitha figurave të krimit duke pasur parasysh se lëvizjet demografike kanë ndikuar në lindjen e një sërë krimesh të reja për Qarkun e Durrësit. Prokurori i rrethit tha se institucioni i prokurorisë në bashkëpunim me gjykatën do të botojnë një raport vjetor rreth situatës së kriminalitetit ku do të pasqyrohen edhe masat e marra si dhe dënimet e dhëna për këto kime. Me anë të këtij botimi që do të shpërndahet dhe do të diskutohet me nxënës të shkollave të mesme, synohet sensibilizimi i të rinjve me qëllim parandalimin e krimit. Me këtë rast drejtori i IDN-së solli në vëmendje të pjesëmarrësve ekzistencën e një marrëveshjeje bashkëpunimi të firmosur dy vjet më parë mes Drejtorisë Arsimore të rrethit dhe Drejtorisë së Policisë, duke theksuar se është e rëndësishme që këto marrëveshje, por edhe planet e ndryshme të punës, të ndiqen në vazhdimësi me qëllim arritjen e rezultateve të synuara.

GJIROKASTËR, maj 2006

Nevoja për bashkëpunim në luftën kundër mbjelljes së bimëve narkotike ishte në qendër të takimit të organizuar nga prefekti i Qarkut, zoti Spiro Ksera. Duke marrë shkas edhe nga diskutimet rreth gjendjes në komunën e Lazaratit, si një nga zonat më të përfolura për kultivimin e bimëve narkotike, drejtori i IDN-së, zoti Hroni nxiti një debat më të hapur duke vënë theksin mbi rëndësinë e marrjes së masave konkrete. Në vazhdim u diskutua rreth strategjive të policisë për parandalimin e krimit dhe përmirësimin e marrëdhënieve polici-komunitet. Nxitja dhe krijimi i kushteve për kontakte të vazhdueshme të inspektorëve të rendit me komunitetin do të ishte shumë rezultative për parandalimin e krimeve të ndryshme që shqetësojnë komunitetin. Ngritja dhe funksionimi i Grupeve Konsultative Polici-Komunitet do të ndikojë në krijimin e marrëdhënieve më të ngushta dhe të personalizuara të punonjësve të policisë dhe qytetarëve duke rritur bashkëpunimin dhe ndjenjën e përgjegjësisë komunitare dhe rrjedhimisht besimin për të denonuar krime të ndryshme.

Ecuria e punës për përgatitjen dhe miratimin e projektligjit: “Për krijimin e Komiteteve për Parandalimin e Krimit”

Në janar 2003 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me MRP-në dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ngriti një grup ekspertësh për përgatitjen e një projektligji për parandalimin e krimit. Pas një sërë aktivitetesh në prill 2003 në një tryezë të rrumbullakët u bë prezantimi i këtij projektligji. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin: zëvendësministrat e Drejtësisë, Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Arsimit, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit si dhe përfaqësues të misioneve PAMECA dhe ICITAP. Të gjithë e përshëndetën dhe siguruan për mbështetjen e kësaj nisme duke e vlerësuar si të domosdoshme dhe mjaft pozitive për vendin tonë. Menjëherë pas kësaj u caktua një grup i posaçëm që në bashkëpunim me drejtorinë juridike të MRP-së do të punonin për realizimin e variantit përfundimtar të këtij projektligji. Pas një periudhe prej një vit zvarritjesh burokratike projektligji u dërgua në ministritë e linjës për të bërë relacionet përkatëse. Pas përgjigjeve të tyre, specialistët e MRP-së punuan për të reflektuar vërejtjet në një projektligj përfundimtar. Gjatë gjithë kësaj kohe pranë Konsorciumit Ndërkombëtar në një grup pune për reformat ligjore në

fushën e sigurisë është diskutuar dhe vazhdon të diskutohet mbi këtë projektligj.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim ndërkohe ka organizuar një sërë takimesh sensibilizuese në nivel vendor si në Shkodër e Fier, ku të gjithë aktorët kanë mbështetur këtë projektligj. Megjithëse në fillim të vitit 2005 menduan se më në fund ky projektligj ishte i gatshëm për të kaluar në Këshillin e Ministrave, për arsyen nga më të ndryshmet përfshirë mungesën e strategjive dhe një vizioni të qartë, projektligji vazhdon të mbetet pezull. Së fundmi, u premtua që ky projektligj do të rinisë procesin e rishqyrtimit nga ekspertët ligjorë të zyrës së kryeministrat dhe Ministritë së Brendshme dhe pritet që së shpejti të fillojnë procedurat normale për miratim.

Komisioni Parlamentar i Sigurisë Kombëtare thirri në një seancë dëgjimore përfaqësues të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim me qëllim prezantimin e aspekteve të punës së kësaj organizate në sektorin e sigurisë dhe kryesisht për nismën ligjore për krijimin e komiteteve të parandalimit të krimit. Z. Hroni iu përgjigj interesimit të anëtarëve të komisionit duke bërë një prezantim të hapave të deritanishëm në mbështetje të projektligjit për krijimin e komiteteve për parandalimin e krimit duke sqaruar se këto struktura do të unifikojnë në një organizëm të specializuar përpjekjet e shtetit dhe shoqërisë për të reduktuar dhe parandaluar krimin në Shqipëri. Nëpërmjet këtij projektligji synohet përfshirja e të gjitha institucioneve dhe organeve shtetërore dhe të zgjedhura përfshirë shoqërinë civile, biznesin, grupet e interesit, komuniteteve të ndryshme, etj. në një strukturë që do të synojë hartimin e politikave dhe të strategjive konkrete më qëllim parandalimin e krimit. Në fokus të punës së këtyre komiteteve do të jenë figurat kryesore të krimit sipas statistikave vendore, ku nuk përashtohen dukuri apo kime të tilla si gjakmarrja, mbjellja e bimëve narkotike, trafiqet, krimi në familje, etj., si dhe krimi në përgjithësi.

Bordet e Parandalimit të Krimit

Shefat e Komisariateve të Policisë së Tiranës kanë organizuar takime për ngritjen e **Bordeve të Parandalimit të Krimit**. Këto takime u organizuan në kuadër të një plani të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë si dhe në zbatim të një udhëzimi të prefektit të Tiranës i dalë pas një takimi në rang qarku (21 mars 2006) ku dhe u hartua një plan pune për bashkëpunimin e policisë me organet e Pushtetit Vendor, institucione të ndryshme vendore e qendrore në nivel vendor, arsimin, komunitetin e biznesit, etj., për luftën ndaj krimtit dhe parandalimin e tij. Ngritja e Bordeve të Parandalimit të Krimit në çdo komisariat është edhe në vazhdim të një nisme në rang kombëtar që ka përfshirë aktivitete në të gjitha prefekturat ku dhe është bërë prezantimi i projektligjit “Për krijimin e Komiteteve për Parandalimin e Krimit”.

Këto aktivitete, përfshirë edhe ngritjen e strukturave për institucionalizimin e përpjekjeve dhe bashkëpunimit për parandalimin e krimtit u zhvilluan në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim, IDN-në.

Qëllimi i këtyre takimeve ishte diskutimi i problematikave specifike të zonës, konsultimi për mënyrën e zgjidhjes së këtyre problemeve si dhe rritja e bashkëpunimit në kuadër të parandalimit të krimtit. Mbetet e rëndësishme marrja dhe ndarja e përgjegjësive për çdo institucion, sensibilizimi i

komunitetit për të bashkëpunuar dhe për pjesëmarrjen në veprimitari parandaluese.

Takimet janë organizuar nën koordinimin e prefektit të qarkut Tiranë, zotit Ruzhdi Keçi, dhe pjesëmarrësit kanë qenë drejtues dhe përfaqësues të organeve të Pushtetit Vendor, (kryetarë të njësive bashkiake dhe komunave të zonës së komisariatit) përfaqësues të prokurorisë, drejtues dhe mësues të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare, qeveritë dhe organet e tjera të nxënësve, bordet e prindërve, përfaqësues të biznesit, komunitetit, shoqërisë civile si dhe aktorë të tjerë vendorë.

Në kuadër të rritjes së cilësisë së shërbimeve që ofron policia e shtetit dhe institucionet e tjera vendore, shefi i komisariatit të policisë do të organizojë takime periodike të **Bordit të Parandalimit të Krimtit**. Ky bord përbëhet nga kryetarët e njësive bashkiake dhe kryetarët e komunave të zonës së komisariatit, drejtuesit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, përfaqësues të komunitetit të biznesit, etj. Në takimet e Bordit ftohen edhe kryepleqtë e lagjeve dhe fshatrave si dhe përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit si dhe të komunitetit. Bordi funksionon si organ konsultativ i shefit të komisariatit dhe ka për qëllim diskutimin rrith problemeve të rendit dhe krimtit në zonë si dhe hartimin e planeve konkrete të bashkëpunimit për zgjidhjen e tyre. Aktivitetet e planifikuara do të synojnë rritjen e efektivitetit të punës parandaluese të policisë në bashkëpunim me të gjitha organet dhe institucionet, komunitetin si dhe aktorët e tjerë vendorë.

Duhet theksuar se për herë të parë përfaqësues të prokurorisë kanë marrë pjesë në takime të përbashkëta për parandalimin e krimtit duke shprehur edhe vullnetin e përfshirjes në aktivitete parandaluese.

Prefekti i Tiranës, zoti Ruzhdi Keçi në vazhdim të kësaj nisme dhe me qëllim diskutimin e përvojave të krijuara në ngritjen e këtyre Bordeve thirri në një takim pune shefat e

komisariateve të policisë si dhe drejtues të Drejtorisë Arsimore. Në këtë takim u diskutua mbi përvojat e krijuara në drejtim të bashkëpunimit për parandalimin e krimit si dhe vendosjen e këtij bashkëpunimi mbi baza institucionale. Krijimi i Bordeve të Parandalimit të Krimtit, si një organ konsultativ i shefit të komisariatit që ka për qëllim diskutimin rrëth problemeve të rendit dhe krimtit në zonë si dhe hartimin e planeve konkrete të bashkëpunimit për zgjidhjen e tyre, është një përvojë e filluar tashmë në 4 komisariatet e Tiranës. Pjesëmarrësit në takim shprehën mendimet e tyre rrëth mënyrës se si kjo strukturë të mund të jetë sa më efikase. Këto Borde përbëhen nga kryetarët e njësive bashkiakë dhe kryetarët e komunave të zonës së komisariatit, drejtuesit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, përfaqësues të komunitetit, të biznesit, etj. Në takimet e Bordit ftohen edhe kryepleqtë e lagjeve dhe fshatrave si dhe përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit si dhe të komunitetit.

Aktivitetet e planifikuara do të synojnë rritjen e efektivitetit të punës parandaluese të policisë në bashkëpunim me të gjitha organet dhe institucionet, komunitetin si dhe aktorët e tjera vendorë.

“Është e nevojshme, – u shpreh zoti Keçi, – që parandalimin e krimtit ta konsiderojmë si një nga drejtimet kryesore të punës tonë.”

Drejtoresha e Arsimit, zonja Ariana Bekteshi kërkoi nga shefat e komisariateve një bashkërendim më të mirë të punës me qëllim evidentimin dhe skedimin e të gjitha rasteve dhe problemeve që mund të gjenerojnë krim në ambientet e shkollave si dhe në grup-moshat përkatëse. Ajo theksoi se braktisja e shkollës është një fenomen mjaft shqetësues për zgjidhjen e të cilit do të duhet një bashkëpunim i vazhdueshëm dhe sa më gjithëpërfshirës. Përveç shkollës dhe policisë një rol të rëndësishëm duhet të luajë edhe Pushteti Vendor

nëpërmjet punonjësve socialë, ndërlidhësave të komunitetit si dhe strukturave të tjera.

Nëndrejtori i Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë, Edmond Rizai i pranishëm në këtë takim, u shpreh se Policia e Shtetit gjithmonë e më tepër po orientohet drejt metodave të reja të policimit. Krijimi i këtyre bordeve si dhe përvoja të tjera në drejtim të policimit në komunitet, u shpreh ai, ndikojnë pozitivisht jo vetëm në rritjen e besimit te publiku, por edhe në ndryshimin e mentalitetit për vetë punonjësit e policisë. Policia e Shtetit po shkon drejt funksionimit si një organizatë që ofron shërbime bazuar në “kërkësen dhe ofertën”. Ai u tregua i gatshëm të mbështesë organizimin e Bordeve të Parandalimit të Krimtit.

Llogaridhënia Publike e Policisë së Shtetit

Në tetor 2006, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim organizoi një tryezë të rrumbullakët diskutimi me temë: “Llogaridhënia Publike e Policisë së Shtetit dhe raportet e bashkëpunimit me organet e Pushtetit Vendor” Qëllimi i kësaj tryze është diskutimi mbi nevojën e hapjes të shërbimit policor ndaj komunitetit, nëpërmjet procesit të llogaridhënieve publike dhe raporteve të bashkëpunimit me institucionet dhe qytetarët në nivel vendor; roli i këtyre praktikave në performancën dhe cilësinë e shërbimeve në këndvështrimin e projektitligjit për Policinë e Shtetit. Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin drejtues dhe ekspertë të lartë të Policisë së Shtetit, anëtarë të komisionit parlamentar të sigurisë publike, përfaqësues të misioneve poliore të huaja dhe përfaqësues të zyrës së kryeministrat dhe të ministrit të Brendshëm.

Në takim u diskutua rreth përvojave të deritanishme të krijuara nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim në organizimin e takimeve llogaridhënëse të drejtuesve të strukturave vendore të policisë.

Përvojat në drejtim të rritjes së bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit dhe organeve të Pushtetit Vendor si dhe nevoja përvendosjen mbi baza institucionale të këtij bashkëpunimi pëtreaguar ndaj shqetësimeve dhe nevojave të komunitetit për

rend dhe siguri publike ishin një tjetër pikë ku u përqendruan diskutimet e pjesëmarrësve në këtë tryezë. Duke qenë gjithmonë e më të vetëdijshëm se rendi dhe siguria publike nuk janë detyrë vetëm e policisë, por e të gjithë institucioneve të tjera shtetërore si dhe organeve të Pushtetit Vendor, si dhe në këndvështrimin e filozofisë së policimit në komunitet, kjo tryezë synoi edhe debatin mbi decentralizimin e shërbimit policor. Ligji aktual i Policisë së Shtetit është më i përparuar në këto drejtime krahasuar me projektligjin e ri, i cili nuk shprehet për bashkëpunimin e policisë me Pushtetin Vendor. Sikundër ligji aktual është shumë herë më i qartë edhe për raportet e policisë me publikun.

IDN-ja është e mendimit se llogaridhënia publike e drejtuesve vendorë të policisë ndaj qytetarëve duhet institucionalizuar si praktikë në projektligjin e ri, mbështetur edhe në përvojën e deritanishme të takimeve llogaridhënëse zhvilluar vitet e fundit në shumë drejtori qarqesh e komisariate policie. Kjo është forma më me vlerë e raporteve polici-komunitet, e cila krahas impaktit të drejtpërdrejtë te qytetarët, ndikon edhe në civilizimin e mentalitetit policor si shërbim publik.

Kjo tryezë u organizua nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim me qëllim diskutimin mbi nevojën e hapjes së shërbimit policor ndaj komunitetit nëpërmjet procesit të llogaridhënieve publike, rritjen e performancës dhe cilësisë së shërbimeve në këndvështrimin e projektligjit për Policinë e Shtetit.

Një tjetër temë diskutimi është rritja e bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit dhe organeve të Pushtetit Vendor si dhe nevoja për vendosjen mbi baza institucionale të këtij bashkëpunimi për të reaguar ndaj shqetësimeve dhe nevojave të komunitetit për rend dhe siguri publike.

Zëvendësdrejtori i përgjithshëm, z. Ahmet Haxhia e quajti një procedurë demokratike diskutimin e projektligjit nga

aktorë të shoqërisë civile dhe sensibiliteti për takimet llogaridhënëse dhe forcimin e raporteve të bashkëpunimit me publikun e vlerësoi si çështje të rëndësishme të punës së policisë.

Ndërsa, Petro Koçi, nënkyryetari i Komisionit Parlamentar të sigurisë kombëtare, e quajti të rëndësishme forcimin e bashkëpunimit të policisë me Pushtetin Vendor të zgjedhur. Zoti Koçi dhe shumë diskutantë të tjerë ngritën nevojën që ndryshimet ligjore të mbështeten në përvojën dhe nevojat e realitetit shqiptar për të përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve në raport me sigurinë publike.

Takime të llogaridhënieve publike të organizuara nga drejtues të strukturave vendore të Policisë së Shtetit

Takimi i parë llogaridhënës publik është organizuar nga drejtuesit e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Durrës. Në këtë takim ishin të ftuar dhe morën pjesë drejtues të Pushtetit Vendor si edhe anëtarë të këshillave të bashkisë e të qarkut, drejtues të institucioneve të ndryshme publike, përfaqësues të komuniteteve të ndryshme si ai i biznesit, etj., nxënës e drejtues të shkollave të mesme të qytetit, banorë të ndryshëm që patën mundësinë dhe dëshirën të jenë të pranishëm, etj. Mbajtja e takimit dhe ftesa të interesuarve iu bë nëpërmjet televizionit lokal.

Përvoja e këtij takimi të parë llogaridhënës ka qenë një shtysë dhe model që ka nxitur praktikimin e takimeve të tilla edhe nga drejtues të tjera të strukturave vendore të Policisë së Shtetit. Kështu janë organizuar takime llogaridhënëse edhe në Drejtoritë e Policisë të Qarqeve Berat, Lezhë, Kukës, Gjirokastër, Vlorë, Komisariati Laç, Komisariati i policisë nr. 3, Tiranë. Në këto takime drejtuesit e policisë vendore janë përballur me kërkesa, kritikat dhe sugjerimet e komunitetit duke i nxitur ata të jenë më të përgjegjshëm. E rëndësishme është se këto takime janë pritur me mjaft interes nga publiku dhe pjesëmarrja ka qenë e madhe. Megjithatë ky interesim

është shoqëruar shpesh edhe me mosbesim ose i parë me skepticizëm jo vetëm nga qytetarët, por edhe nga drejtues të Pushtetit Vendor, etj. Kjo është ndoshta shprehje e njëfarë “krize besimi” që rëndon akoma mbi policinë dhe strukturat e saj që megjithëse nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me rezultatet konkrete të punës së policisë, prapëseprapë duhet të përbëjë preokupim kryesor për drejtuesit e policisë të çfarëdo rangu.

Në Konferencën Kombëtare: “Besimi Publik, Sfidë për Policinë” të organizuar në shtator 2003, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, drejtues Bajram Ibraj përmendi takimin e parë llogaridhënës si një shembull pozitiv të DPQ-së, Durrës dhe kërkoi që kjo eksperiencë të pasurohet dhe të shtrihet në të gjithë vendin.

Po në këtë konferencë, kryekomisar Besnik Shehu do të deklaronte se “Risjellja e formave të llogaridhënies në aktualitetin e sotëm është një sukses mbi atmosferën nihiliste në vitet e tranzicionit për çdo gjë të së kaluarës dhe se përshtatja e tyre me realitetin demokratik të policisë dhe shoqërisë në përgjithësi është një hap i rëndësishëm në kuadër të reformimit të plotë të Policisë së Shtetit drejt aplikimit të suksesshëm të policimit në komunitet, i cili “i jep jetë një nevoje të munguar”.

Drejtori i Policisë të Qarkut Gjirokastër në takimin e organizuar u shpreh se përfshirja e policisë në një proces të llogaridhënies publike nuk është thjesht një slogan, por tregon fillimin e një mënyre të re të konceptimit të punës dhe përgjegjësive ligjore të drejtuesve dhe punonjësve të policisë. Çdo punonjës policie, – tha ai, – duhet të ndiejë përgjegjësi për kryerjen e detyrës dhe të përgjigjet për të edhe përparrë komunitetit që policon.

Në takimin llogaridhënës të DPQ-së, Lezhë mori pjesë edhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, drejtues Bajram Ibraj. Në fjalën e tij ai tha se takimi zhvillohet në kuadër të filozofisë së punës së policisë si një shërbim publik

dhe që duhet të shoqërohet me hapa gjithmonë e më të plotë drejt rritjes së komunikimit me qytetarët dhe zbatimin e ligjit për parandalimin sa më efektiv të krimit me pjesëmarrjen e publikut. "Pjesëmarrja ime sot në këtë takim, - tha drejtori Ibraj, - është pjesë e përgjegjësisë për të rritur shërbimet ndaj qytetarëve, biznesit, për të rritur shkallën e bashkërendimit me institucionet e tjera vendore në shërbim të rendit dhe qetësisë." Ai theksoi se: "Policia e Shtetit ka detyrimet e saj institucionale dhe qytetare edhe në përpjekjet e shtetit dhe shoqërisë shqiptare për integrimin evropian dhe euroatlantik të vendit."

Drejtori i DPQ-së, Durrës, kryekomisar Tonin Vocaj bëri të mundur organizimin e një takimi të dytë llogaridhënës gjashtë muaj pas takimit të parë. Ky takim, duke pasur edhe privilegjin e një përvoje të kaluar, pati rëndësi për sa i përket impaktit në opinionin publik. Një pjesë e mirë e formalitetit të pashmangshëm të takimit të parë, u eleminua në këtë takim duke krijuar bindjen publike për seriozitetin dhe përkushtimin real të policisë për reformim dhe hapje ndaj komunitetit. Në këtë takim kryekomisar Tonin Vocaj mori një sërë angazhimesh në kuadër të rritjes së shkallës së bashkëpunimit me komunitetin. Ai tha se "... dhënia llogari para qytetarëve dhe Pushtetit Vendor konsiderohet nga ana jonë si një detyrim moral për t'i thënë hapur publikut se ç'ka bërë policia gjatë vitit. Në këtë kuadër dëshiroj të shpreh mendimin se është më rezultative dhe e domosdoshme zbritja në nivele më të ulëta të kësaj llogaridhënie. Në të ardhmen ne do të punojmë që punonjësit e policisë së zonave të japin llogari në shkallë komune, lagjeje, etj."

Ministri i Rendit Publik në Konferencën III Kombëtare (2004) "Besimi Publik, Sfidë për Policinë" u shpreh se: "Ka ardhur koha që të konceptojmë dhe të implementojmë një plan veprimi për të rritur besimin publik te policia, i cili mund

të konsistonte në shtrirjen e modelit të llogaridhënisë në shkallë të gjërë, në rrafsh vendor, jo thjesht si një komunikim formalist, si një angari mediatike, por si një dialog dhe këshillim të përbashkët me publikun, si një dëgjim të vëmendshëm dhe lexim serioz të shqetësimeve e kërkesave të tij.”

Në të njëjtin aktivitet drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit premtoi se: “Brenda këtij viti ne do të rikonsiderojmë me aktet e nevojshme normative rregullimin e llogaridhënisë publike të shërbimeve policore sipas natyrës së tyre para organeve të qeverisjes vendore dhe komunitetit. Shembujt pozitivë në këtë drejtim duhet të përqafohen nga të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit.”

Llogaridhënia e Policisë

Kur flitet për llogaridhënien e policisë shumica mendojnë se kemi të bëjmë me vlerësimin e personelit të policisë nga vetë policia duke nxjerrë përgjegjësitë për veprimittaritë e tyre. Megjithatë është shumë më komplekse se kaq sepse në fund të fundit policia ka detyrimin të jetë e përgjegjshme ndaj komunitetit, të cilit i shërben.

Është e qartë se punonjësi i policisë përgjigjet përpara strukturave dhe eprorëve të vet për kryerjen e detyrave të ngarkuara si dhe për zbatimin e ligjit. Pa kërkuar të anashkalojmë atë çfarë është e dukshme duhet të përcaktojmë disa standarde sipas të cilave të mund të matim performancën e një strukture policore, (drejtori, komisariat, sektor, etj.) si dhe oficerëve dhe punonjësve të policisë.

Në radhë të parë duhet t'ju përgjigjemi disa pyetjeve si p.sh:

- Çfarë është thelbësore në punën e policisë: ndalimi dhe arrestimi i shkelësve të ligjit dhe kriminelëve apo parandalimi i këtyre kimeve?

- Është më e rëndësishme se sa shpejt arrin policia në vendngjarje apo se çfarë masash merr pasi arrin atje?

Gjithmonë e më shumë po bëhet e qartë se perceptimi i funksionit të policisë vetëm si luftë ndaj krimít ka disa probleme:

Së pari, a kemi statistika të sakta të krimit duke pasur parasysh se shumë kime mbeten të paraportuara?

Së dyti, sa mund të ndikojë vetë policia në ndryshimin e këtyre statistikave?

Së treti, a janë këto statistika njësia nëpërmjet të cilës qytetari i thjeshtë mund të vlerësojë ose vlerëson punën e policisë?

Është e vështirë të mendojmë se qytetarët në takimet e tyre të përditshme do të diskutojnë rreth kriminalitetit dhe se si duhet të punojë policia për të përmirësuar statistikat e krimit. Është e vërtetë që shumica e qytetarëve janë në gjendje të kuptojnë vështirësitë e policisë në punën e saj të përditshme, por në të vërtetë shumica e njerëzve krijojnë përshtypjet e tyre për policinë mbështetur në ngjarje dhe elementë që ndoshta nuk kanë të bëjnë fare me krimet serioze, si p.sh. mënyra se si sillet punonjësi i policisë kur qytetari shkel një rregull të qarkullimit rrugor, ose mënyra se si reagon policia ndaj një shqetësimi qoftë edhe banal apo të parëndësishëm.

Gjithmonë e më shumë shërbimet policore perëndimore, po drejtohen drejt zbatimit të policimit në komunitet. Ky lloj policimi vë theksin te pjesëmarrja e komunitetit. Edhe Policia e Shtetit në Shqipëri po aplikon gjithmonë e më shumë këtë mënyrë policimi. Dokumente të rëndësishme si “Strategjia e Policimit në Komunitet” dhe “Strategjia 10-vjeçare e Policisë së Shtetit” janë dëshmi e ristrukturimit dhe profilizimit të shërbimeve të policisë në frysmin e praktikave bashkëkohore të policimit në komunitet.

Policimi në komunitet vë theksin edhe në ndryshimin e mentalitetit të vetë komunitetit për të mos qenë thjesht konsumatorë të shërbimeve të ofruara nga policia, por edhe pjesëmarrës aktivë duke ndihmuar në parandalimin e krimit, rritjen e parametrave të sigurisë, rendit dhe qetësisë publike.

Duke i dhënë mundësinë qytetarëve të jatin kontributin dhe mendimin e vet për mënyrën e policimit, ata do të mund

të vënë përpara përgjegjësisë çdo punonjës policie që është pasiv në zbatimin e ligjit, abuzon apo korruptohet. Në të njëjtën kohë oficerët e policimit në komunitet do të mund të kenë rezultate më të larta në parandalimin e krimit si dhe rastet e vetëgjyqësisë.

Krijimi i kontakteve personale mes qytetarëve dhe punonjësve të policisë eleminon anonimatin që lejon krimin dhe violencën të jetë prezente në jetën e përditshme. Prezenca e përditshme e punonjësit të policisë në terren i krijon atij mundësinë të njohë dhe të dallojë mes qytetarëve të rregullt si dhe atyre me precedentë ose të pirur për të thyer ligjin. Kjo prezencë krijon mundësinë që çdo qytetar të njohë policin e zonës së vet dhe të ketë mundësinë të kontaktojë direkt me të sa herë të ketë nevojë, qoftë edhe për të shprehur pakënaqësinë ose dhe kritikat që mund të ketë ndaj punës apo sjelljes së policisë. Në këtë mënyrë, vetë policia do të mund të reflektojë në kohë dhe të marrë masa për përmirësimin e aspekteve të caktuara të punës së vet.

Mënyrat për të rifituar kontrollin (besimin) mbi komunitetin si dhe për të forcuar mekanizmat e kontrollit, përgjegjshmërisë dhe të llogaridhënisë së policisë janë të ndryshme. Shumë drejtues kanë nxitur ose inkurajuar krijimin e mekanizmave civilë, nëpërmjet të cilave vetë komuniteti do të mund të adresojë ankesat në mënyrë të pavarur. Kjo mund të jetë një mënyrë e suksesshme për përmirësimin e imazhit publik të policisë si dhe rritjen e besimit të komunitetit duke u dhënë sigurinë se policia është një organizëm në shërbim të tyre dhe jo kundër interesave dhe dëshirave të tyre. Megjithatë përvojat në këtë fushë tregojnë se këto borde, organizata civile, shpeshherë nuk kanë në përbërje të tyre njërež të zakonshëm, të thjeshtë dhe në këtë mënyrë nuk bëjnë gjë tjetër veçse vështirësojnë kontaktet duke shtuar një hallkë burokratike mes policisë dhe komunitetit.

Nga ana tjeter kemi sistemin normal, standard të drejtimit të ankesave ndaj rasteve të dhunës, korruptionit ose abuzimit me ligjin të kryera nga punonjësit e policisë (kryesisht SHKB-ja). Edhe ky sistem, nëpërmjet mënyrës si funksionon, është e paevitueshme që më tepër të përpinqet të ngarkojë institucionin e policisë me sa më pak përgjegjësi sesa të marrë masa ndëshkuuese ndaj punonjësve të policisë ndaj të cilëve rëndon një akuzë nëpërmjet ankesave të qytetarëve.

Ndoshta mënyra ose zgjidhja më e mirë për çdo krim, përfshirë këtu edhe brutalitetin, korruptionin apo abuzimin me ligjin nga ana e punonjësve të policisë, do të ishte parandalimi. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se për shkak të stresit dhe ngarkesës së madhe që ka një punonjës policie gjatë punës së tij të përditshme, ai mund edhe të kryejë veprime, të cilat e komprometojnë duke e detyruar të abuzojë apo të përdorë mjete e mënyra jashtë kompetencave duke shkelur ndoshta edhe ligjin dhe të drejtat e qytetarëve.

Sfida qëndron pikërisht në marjen e masave parandaluese paraprake dhe sa më efektive në mënyrë që të evitohet përsëritja, përkeqësimi apo “mahisja” e problemeve të këtij lloji.

Strukturat dhe procedurat e brendshme të kontrollit dhe vënies së punonjësve të policisë përpara përgjegjësisë, sidomos për probleme që kanë të bëjnë me vlerësimin e performancës së punës apo dhe mënyrave se si trajtohen ankesat e qytetarëve, janë shumë të rëndësishme dhe nuk bëhet fjalë që ato të eliminohen. Këto procedura e vënë punonjësin e policisë përpara përgjegjësisë duke e pasur të qartë se do të jetë i detyruar të japë llogari për çdo veprim të kryer në përbushjen e detyrave të tij. Për këtë qëllim nevojitet hartimi dhe zbatimi i politikave, procedurave dhe mënyrave për vlerësimin e performancës si dhe përcaktimi i saktë i detyrave të punonjësve të policisë, të cilat do të ndihmojnë ata për të qenë sa më të përgjegjshëm.

Por, në një analizë përbledhëse, çelësi i suksesit mbetet bashkëpunimi i ngushtë polici-komunitet në mënyrë që të identifikohen dhe ndëshkohen ata punonjës policie që abuzojnë me ligjin si dhe të vlerësohen ata punonjës që kanë me të vërtetë rezultate të mira në punën e tyre. Pra, për një sistem sa më të efektshëm të kontrollit dhe vënies së punonjësve të policisë përpara përgjegjësisë, janë të domosdoshme si strukturat e kontrollit të brendshëm, ashtu edhe kontributi i strukturave qytetare të ngritura për këtë qëllim.

Bordet e Avokatisë Qytetare ndaj Policisë

Mbështetur në përvojat perëndimore të funksionimit të agjencive/strukturave qytetare të kontrollit/mbikëqyrjes së policisë nëpërmjet trajtimit të pavarur të ankesave të qytetarëve ndaj punonjësve të policisë, së fundmi edhe në Shqipëri (qytetet “pilot” Tiranë dhe Durrës) janë krijuar dhe funksionojnë Bordet e Avokatisë Qytetare ndaj Policisë.

Këto borde janë ngritur në kuadër të një projekti të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me CAO (Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve) dhe ACAC (Koalicioni Shqiptar kundër Korruptionit). Bordet e Avokatisë Qytetare ndaj Policisë janë struktura qytetare të përbëra nga arsimtarë të njojur në komunitet, juristë, përfaqësues të medias, përfaqësues të OJF-së, ish-oficerë të policisë, aktivistë të komunitetit, përfaqësues të pushtetit lokal, etj.

Kjo iniciativë e IDN-së, e para e këtij lloji në Shqipëri, është një eksperiencë shumëvjeçare e bashkëpunimit të policisë me borde të ngjashme në të gjitha shtetet e Amerikës së Veriut (SHBA). Me Bordin e Pittsburgh-ut, IDN-ja ka një partneritet në shkëmbimin e eksperiencave, ku bashkëpunëtorë të IDN-së kanë marrë eksperiencë dhe përfaqësues të Bordit të Pittsburgh-ut kanë ardhur në Shqipëri për të shkëmbyer eksperiencat e tyre.

IDN-ja mendon ta shtrijë këtë partneritet në fushën e bashkëpunimit me Policinë e Shtetit duke krijuar “Bordet e Avokatisë Qytetare ndaj Policisë” që do të jenë struktura ndërmjetëse midis qytetarëve, të cilët druhën të trokasin në dyert e policisë për shkak të humbjes së besimit të tyre, dhe policisë, për rritjen e përgjegjshmërisë dhe funksionimin sa më të mirë të këtij institucioni pranë komunitetit.

Projekti do të funksionojë nëpërmjet mbledhjes së ankesave për rastet e korruptionit dhe abuzimit me ligjin në polici nëpërmjet numrave të telefonit në Durrës dhe në Tiranë ku qytetarët mund të telefonojnë në zyrat përkatëse të IDN-së dhe ACAC-së në Tiranë dhe të CAO-s në Durrës ku mund të shkojnë personalisht dhe të deklarojnë ankesën e tyre. Këto informacione bëhen publike për qytetarët nëpërmjet spoteve publicare.

Rastet e korruptionit pasivitetit apo të abuzimit me ligjin do të mblidhen, investigohen, shqyrtohen nga “Bordi i Avokatisë Qytetare ndaj Policisë”, i cili pasi të shqyrtojë rastet, do të japë sugjerimet dhe rekomandimet përkatëse të bëra publike drejtuar shefit të komisariatit përgjegjës ose drejtorit të policisë së qarkut, për të cilin këto rekomandime nuk janë detyruese.

Gjithashtu, Bordi, kur e sheh të nevojshme dhe kur është e mundur, do të përdorë dhe takimet ballafaquese midis qytetarëve ankues dhe policëve të implikuar (ose shefit përkatës kur polici nuk mund të marrë pjesë). Bordi ka si qëllim të tij të ndihmojë qytetarët në zgjidhjen e problemeve të tyre në lidhje me rastet e sjelljes jo të mirë të policëve që mund të çojë në korruption, pasivitet apo abuzim me ligjin.

Qëllim tjetër i Bordit është edhe që këto probleme të mund të zgjidhen me marrëveshje midis dy palëve. Nga ana e saj, Policia e Shtetit duhet të lehtësojë procedurat e investigimit të Bordit për rastet e korruptionit, pasivitetit dhe të abuzimit

me ligjin, t'i marrë parasysh dhe të reagojë ndaj rekomandimeve të Bordit, por duke theksuar se këto rekomandime nuk janë të detyrueshme për Policinë e Shtetit.

Mbikëqyrja civile dhe llogaridhënia e policisë

Mbikëqyrja/kontrolli qytetar është një aspekt i rëndësishëm i përgjegjshmërisë dhe llogaridhënie së policisë.

Një shërbim policor i përgjegjshëm do të thotë që çdo punonjës i policisë të trajtojë të gjithë qytetarët me respekt, duke zbatuar vetëm ligjin dhe asnjëherë të mos përdorë më shumë forcë nga sa është e domosdoshme duke pasur parasysh në të njëjtën kohë se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

Vetë organizata e policisë ose dhe çdo institucion tjetër i zbatimit të ligjit duhet të marrin masa me qëllim garantimin e një shërbimi të përgjegjshëm ndaj qytetarëve. Kjo arrihet nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave dhe procedurave të efektshme me qëllim arritjen e standardeve sa më të larta të profesionalizmit të punonjësve të policisë. Në këto politika duhet specifikuar qartë p.sh. edhe rastet kur si mund të përdoret forca dhe në të njëjtën kohë të specifikoohen edhe procedurat e hetimit për çdo rast të përdorimit të forcës. Pra, policia duhet të ketë politika të qarta që parandalojnë abuzimin e punonjësve të saj me ligjin dhe në të njëjtën kohë procedura specifike për hetimin e incidenteve apo ankesave të ndryshme. Institucionet e zbatimit të ligjit, kryesisht policia, duhet të marrin masa me qëllim marrjen e të gjitha ankesave të ardhura nga qytetarët ndaj punonjësve të policisë duke zhvilluar një hetim të shpejtë dhe të drejtë.

Mbikëqyrja dhe kontrolli qytetar jep kontributin e vet në rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënie së policisë duke ofruar një këndvështrim të pavarur ndaj ankesave të qytetarëve si dhe mënyrës se si i heton dhe çfarë zgjidhje jep policia.

Me mbikëqyrje dhe kontroll qytetar ndaj policisë kuptohet tërësia e procedurave dhe mjeteve nëpërmjet të cilave bëhet e mundur kontributi i vetë komunitetit në trajtimin dhe investigimin e ankesave ndaj punonjësve të policisë.

A mund të funksionojë mbikëqyrja/kontrolli qytetar ndaj policisë dhe a mund të jetë kjo një mënyrë e efektshme?

Efektiviteti i mbikëqyrjes/kontrollit qytetar ose civil ndaj policisë mund të matet në mënyra të ndryshme. Për këtë është e rëndësishme të identifikojmë disa nga qëllimet e kontrollit civil, të cilat janë:

1. Të sigurojë një hetim të kujdesshëm dhe të drejtë të ankesave të qytetarëve.
2. Të shqyrtojë një numër më të madh ankesash në krahasim me strukturat e kontrollit të vetë policisë.
3. Të parandalojë rastet e abuzimit me ligjin, pasivitetit apo korruptionin e mundshëm nga ana e punonjësve të policisë.
4. Të krijojë përvoja pozitive të qytetarëve në lidhje me trajtimin korrekt të ankesave të tyre.
5. Të ndikojë në rritjen e besimit të publikut te policia.
6. Të ndihmojë në rritjen e profesionalizmit në polici.

Për të pasur një pamje më të qartë rrëth kësaj mënyre qytetare/civile dhe të pavarur të kontrollit ndaj policisë të përpinqemi t'ju përgjigjemi pyetjeve të mëposhtme:

A mundet që një organizëm (agjenci / bord) qytetar i këtij tipi të shqyrtojë një numër më të madh ankesash në krahasim me strukturat e kontrollit të brendshëm të vetë policisë?

Në të vërtetë, jo. Shumica e ankesave të qytetarëve ndaj policisë janë të vështira për t'u mbështetur. Ankesat më të zakonshme kanë të bëjnë me sjelljen jo të përshtatshme, përdorimin e forcës (por pa sjellë dëmtime fizike) ose dhe pasivitetin e punonjësve të policisë. Në përgjithësi nuk ka dëshmitarë të pavarur dhe po ashtu në rastet kur nuk kemi dëmtime fizike si pasojë e dhunës (që pretendon qytetari se është ushtruar ndaj tij) nuk ka si të ketë dhe një raport të mjekut ligjor. Pra, nuk është e lehtë që të gjitha ankesat e qytetarëve të marrin zgjidhje. Sa më serioze dhe të rënda të janë shkeljet për të cilat ankohen qytetarët, aq më e lehtë është që ato të mbrohen dhe të marrin një përgjigje pozitive. Megjithatë, duhet pasur parasysh se faktet e mësipërme janë normale për natyrën e ankesave në përgjithësi dhe nuk do të thotë se sistemi i trajtimit të ankesave nuk mund të funksionojë ose që këto agjenci/struktura civile e kanë të pamundur të përbushin misionin e tyre.

Në të njëjtën kohë, fakti që këto struktura nuk mund të shqyrtojnë më shumë ankesa se sa shërbimet dhe strukturat policore të kontrollit të brendshëm nuk do të thotë që kontrolli civil është i panevojshëm ose i padobishëm. Duhet të kemi parasysh se këto struktura kanë më tepër objektiva sesa thjesht të hetojnë ankesat e qytetarëve. Së pari, një nga synimet e Bordeve është edhe rritja e besimit të qytetarëve dhe nxitja e tyre për të denoncuar të gjitha rastet e korruptionit, abuzimit me ligjin, etj., nga ana e punonjësve të papërgjegjshëm të policisë. Së dyti, bordet kanë edhe një sërë qëllimesh të tjera, të cilat janë radhitur më sipër.

A ndikon funksionimi i këtyre bordeve në rritjen e profesionalizmit të policisë?

Në përgjithësi kjo varet nga mënyra e funksionimit të bordeve. Nëse bordi e kufizon veprimtarinë e vet vetëm në

hetimin e ankesave, atëherë rezultati më i mundshëm është thjesht rritja e numrit të ankesave si dhe shtimi i masave disiplinore të marra ndaj punonjësve të policisë. Por, me gjithatë, ashtu siç u përmend edhe më sipër, këto borde nuk mund të trajtojnë një numër më të madh ankesash sa vetë shërbimi i policisë.

Ajo çfarë duhet theksuar në rolin e këtyre bordeve është ndikimi në hartimin, rishikimin dhe zbatimin e politikave më të mira menaxhue se dhe operacionale nga policia, nëpërmjet rekomandimeve që u dërgohen drejtuesve të policisë në përfundim të shqyrtimit të ankesave të qytetarëve. Hartimi i politikave duke marrë edhe mendimin apo vërejtjet e një organizate qytetare, të pavarur nga policia, ndikon në rritjen e cilësisë së shërbimeve të policisë dhe natyrisht të profesionalizimit të punonjësve të saj.

Një tjetër funksion i bordeve (mbikëqyrjes qytetare të policisë) është edhe *rritja e besimit të komunitetit te policia* dhe te procesi i shqyrtimit të ankesave. Bordet mund të ndikojnë duke bërë publike raste të ndryshme të diskutueshme rrëth performances së policisë në një zonë dhe për raste të caktuara ose thjesht duke qenë një burim më tepër ku publiku mund të marrë informacion rrëth policisë dhe shërbimeve që ajo ofron. Në këtë mënyrë bordet mund të konceptohen edhe si një mënyrë ose mundësi që ju ofrohet qytetarëve për të qenë sa më pranë policisë. Pra, ky funksion i bordeve mund të ndihmojë edhe në ndryshimin e imazhit të policisë si një institucion i mbyllur gjë që ka qenë historikisht burim i mosbesimit të qytetarëve te policia.

Praktika e funksionimit të bordeve qytetare presuzpozon ose ndikon edhe në reformimin dhe ndryshimin e mentalitetit të vetë policisë përfshirë këtu drejtuesit politikë ose jo. Reformimi i policisë ndryshon nga reformat e tjera, si p.sh në shëndetësi apo arsim, sepse në këtë rast sektori publik është

njëkohësisht ofruesi, por edhe financuesi i shërbimeve të policisë. Reforma në këtë sektor nënkupton pikërisht ndarjen e këtyre roleve në mënyrë që politika të ketë mundësi të vendosë prioritetet dhe objektivat dhe të mbikëqyrë duke rritur kërkesën e llogarisë ndaj policisë.

Politika ka pesë funksione kryesore në këtë drejtim:

- Të sigurojë qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e politikave në sistem;
- Të ruajë integritetin dhe efektivitetin e sistemit;
- Të mbikëqyrë dhe të ushtrojë kontroll mbi shërbimet e policisë;
- Të financojë;
- Të sigurojë drejtim strategjik dhe të mbështesë policinë.

Policia duhet të ketë lirinë e vetëmenaxhimit pa pasur trysninë dhe ndërhyrjen e drejtimit politik.

Përgatitur për botim
ALTIN KASO

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
BESIMI PUBLIK – SFIDË PËR POLICINË 5

Formati: 13x20 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tel: (4) 240116
Tiranë, 2006

Rr. Elbasanit, PO Box 8177, Tirana, Albania
Tel: +355 4 340484, Fax: +355 4 347700
E-mail: info@idmalbania.org,
www.idmalbania.org